



# E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit

*Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut  
Këshilli i Evropës  
F-67075, Strasbourg Cedex*


<http://www.humanrights.coe.int>

Këta udhëzues të të drejtave të njeriut kanë si qëllim të jenë udhëzues mjaft praktikë mbi mënyrën sesi nene të veçanta të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë zbatuar dhe interpretuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Ato janë shkruar duke pasur në mendje profesionistët ligjorë, dhe veçanërisht gjyqtarët, por janë të aksesueshme gjithashtu për lexues të tjerë të interesuar.

*Një udhëzues  
për zbatimin  
e Nenit 5  
të Konventës Evropiane  
për të Drejtat e Njeriut*

Monika Makovei

Manualet e të drejtave të njeriut, Nr. 5



# E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit

*Një udhëzues  
për zbatimin  
e Nenit 5  
të Konventës Evropiane  
për të Drejtat e Njeriut*

Monica Macovei

Manualet e të drejtave të njeriut, Nr.5

## Manualet e botuara tashmë në serinë e “Manualeve të të drejtave të njeriut”

---

- Manuali Nr.1:* **E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.** Një udhëzues për zbatimin e Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2001)
- Manuali Nr.2:* **Liria e Shprehjes.** Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2001)
- Manuali Nr.3:* **E drejta për një proces të drejtë gjyqësor.** Një udhëzues për zbatimin e Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2001)
- Manuali Nr.4:* **E drejta e pronës.** Një udhëzues për zbatimin e Nenit 1 të Protokollit Nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2001)
- Manuali Nr.5:* **E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit.** Një udhëzues për zbatimin e Nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2002)
- Udhëzuesi Nr.6:* **Ndalimi i torturës.** Një udhëzues për zbatimin e Nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (që del së shpejti).

*Përkthimi dhe botimi financohen nga Programi i IV-t i Përbashkët midis Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës i titulluar “Mbështetje për Shkollën e Magjistraturës, Organizimi dhe Trajnimi i Profesioneve të lira të drejtësisë dhe Promovimi i të Drejtave të Njeriut në Shqipëri”*

*Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut  
Këshilli i Evropës  
F-67075 Strasbourg Cedex*

*Opinionet e shprehura në këtë botim janë ato të autorit dhe nuk përfshijnë përgjegjësinë e Këshillit të Evropës. Ato nuk duhet të konsiderohen se iu bëjnë ndonjë interpretim zyrtar në rastin e instrumenteve ligjorë të përmendura në to, të tillë që ti bëjë të detyrueshme këto instrumente për qeveritë e shteteve anëtare, organet statutore të Këshillit të Evropës apo për ndonjë organ tjetër të krijuar në bazë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.*

*Këshilli i Evropës, 2002  
Imazheria digjitale 2002 Fotodisk/Imazhet  
Botimi i parë, Mars 2002  
Shtypur: Gent Grafik  
Pripres: cprstudio.com*

# Përmbajtja

Çfarë thuhet në Konventë.....	5
-------------------------------	---

## Pjesa I: Prezumimi i lirisë; kushti i ligjshmërisë; koncepti i ndalimit me arrest .....

1. Prezumimi në favor të lirisë .....	8
2. Ligjshmëria e ndalimit .....	9
Pajtueshmëria formale me të drejtën kombëtare .....	9
Rëndësia e bazeve ligjore të vazhdueshme .....	10
I pabazuar në praktikën vendase .....	11
Pajtueshmëria me Konventën. Interpretimi i Konventës mbi ligjshmërinë .....	12
Papajtueshmëria me dispozitat e Konventës.....	12
Përdorimi arbitrar i pushtetit .....	13
Aksesibiliteti, parashikueshmëria dhe garancitë e tjera .....	14
3. Çfarë përbën një heqje lirie? .....	17
“Arrestimi” dhe “ndalimi” .....	17
Elementët për të përcaktuar se masa e ndalimit ekziston .....	17
Natyra e izolimit .....	18
Statusi i personit të përfshirë .....	19
Veprimet e ndërmarra nga individë privatë.....	20
Veprimet e ndërmarra jashtë shtetit.....	21

## Pjesa II: Privimi i lirisë si pjesë e procesit penal .....

1. Këndvështrimi i përgjithshëm .....	23
2. Të dyshuarit si shkelës ligji .....	23
Paraqitja përpara autoritetit ligjor kompetent... 24	
Dyshimi i arsyeshëm.....	26
Nevoja për mbajtje në paraburgim.....	28
Justifikimi i paraburgimit.....	29
Risku i largimit .....	29
Risku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë .....	32
Nevoja për parandalimin e krimit .....	33
Nevoja për të ruajtur rendin publik .....	34
Kushtet për pagesën e lirimit me kusht .....	34
Kohëzgjatja e ndalimit para gjykit .....	36
3. Shkelësit e ligjit që kanë marrë dënimin.....	39
4. Ekstradimi .....	40

## Pjesa III: Justifikime të tjera për heqjen e lirisë së një personi .....

1. Urdhri i Gjykatës dhe zbatimi i detyrimit të parashikuar me ligj .....	43
--	----

2. Ndalimi i të miturve .....	44
3. Ndalimi i personave të sëmurë mendërisht, të alkolizuarve, toksikomanëve, rrugaçëve, ose ndalimi për qëllime të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve ngjitëse .....	45

**Pjesa IV: Detyrimi për të dhënë brenda një afati sa më të shkurtër arsyet e arrestimit .....**

1. Kur lindin detyrimet .....	48
2. Natyra e shpjegimit .....	48
3. Qartësia në dhënien e arsyeve për masën e ndalimit .....	49
4. Afati kohor .....	50

**Pjesa V: Detyrimi për të sjellë personat e ndaluar para një autoriteti gjyqësor që ka të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ose të lirimit në pritje të gjykimit .....**

1. Karakteri i autoritetit ligjor kompetent.....	52
--	----

2. Roli i autoritetit ligjor kompetent .....	54
3. Kuadri kohor për mbikqyrje .....	55
4. Rastet e emergjencës .....	58
5. Mbikqyrja e vazhdueshme .....	61

**Pjesa VI: Ndërmarrja e procedurave kundër ligjshmërisë së ndalimit .....**

1. Nevoja për t'iu drejtuar një gjykate .....	62
2. Paraqitja personalisht para një gjykate .....	63
3. Aksesi për këshillim ligjor, për vënien në dijeni të provave të palëve reciprokisht dhe për barazi në mjete .....	63
4. Përcaktimi i ligjshmërisë së një vendimi .....	65
5. Vendimet duhet të merren me shpejtësi .....	66
6. Lidhja me Nenin 5 (3) .....	68

**Pjesa VII: E drejta për kompensim .....**

<b>Pjesa VII: E drejta për kompensim .....</b>	<b>70</b>
--	-----------

## Çfarë thuhet në Konventë ?

### Neni 5 i Konventës: e drejta për lirinë dhe sigurinë e personit

1. Çdo njeri ka të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit. Askush nuk privohet nga liria përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj:
  - a. ndalimi i ligjshëm i një personi pas dënimit nga një gjykatë kompetente;
  - b. arrestimi ose ndalimi i ligjshëm i një personi për mospërbushjen e urdhërit të ligjshëm të një gjykate ose për të garantuar zbatimin e ndonjë detyrimi të parashikuar me ligj;
  - c. arrestimi ose ndalimi i ligjshëm i një personi i bërë me qëllim që ai të sillet para një autoriteti ligjor kompetent në bazë të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një shkelje të ligjit ose kur konsiderohet arsyeshmërisht e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të një shkeljeje ose largimin e tij pas kryerjes së shkeljes;
  - d. ndalimi i një të mituri me urdhër të ligjshëm me qëllim mbikqyrjen edukative ose ndalimin e tij të ligjshëm për ta sjellë atë para autoritetit ligjor;
  - e. ndalimi i ligjshëm i personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, i personave të sëmurë mendërisht, të alkolizuarve ose toksikomanëve ose rrugaçëve;
  - f. arrestimi ose ndalimi i ligjshëm i një personi për

të parandaluar një hyrje të paautorizuar në vend ose të një personi kundër të cilit po ndërmerren veprime për ta dëbuar ose ekstraduar.

2. Çdo njeri që arrestohet informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe për çdo akuzë kundër tij.
3. Çdo njeri që arrestohet ose ndalohet në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.c. të këtij Neni sillet brenda një afati sa më të shkurtër para një gjyqtari ose një nëpunësi tjetër të autorizuar me ligj që të ushtrojë kompetenca gjyqësore dhe ka të drejtën e gjykimi brenda një afati të arsyeshëm ose të lirimimit në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet me garanci për t'u paraqitur në gjyq.
4. Çdo njeri të cilit i është hequr liria me anë të arrestimit ose ndalimit ka të drejtë të ndërmarrë procedura me anë të të cilave do të vendoset me shpëjtësi nga një gjykatë ligjshmëria e ndalimit të tij ose lirimimit të tij nëse ndalimi nuk është i ligjshëm.
5. Çdo njeri që ka qenë viktimë e arrestimit ose e ndalimit në kundërshtim me dispozitat e këtij Neni ka të drejtë të zbatueshme për kompensim.

### Neni 1 i Protokollit Nr.4

Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për arsyen se ai nuk është në gjendje të plotësojë një detyrim kontraktor.

Neni 5 i Konventës Evropiane përfshin një element kyç në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të një individi. Liria personale është një kusht themelor që përgjithësisht çdokush duhet të gëzojë. Privimi nga ajo ka lidhje gjithashtu ka të ngjarë që të ketë një efekt të drejtpërdrejtë e të kundërt përsa i përket gëzimit të shumë të drejtave të tjera, duke radhitur nga e drejta e familjes dhe ajo private, nëpërmjet të drejtës për lirinë e mbledhjes, të shoqërizimit dhe atë të shprehjes, tek e drejta e lirisë së lëvizjes. Gjithashtu, çdo privim nga këto liri do të çojnë padysim personin e ndikuar në një pozitë mjaft të vulnerabël, duke e ekspozuar atë ndaj riskut të nënshtrimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues. Gjyqtarët në mënyrë të vazhdueshme duhet të kenë parasysh se me qëllim që liri të tilla të jenë kuptimplotë, çdo privim nga ato duhet të jetë gjithmonë vetëm në rrethana përjashtuese, të jetë i justifikuar në mënyrë objektive dhe të mos zgjasë më shumë sesa të jetë absolutisht e nevojshme.

E “drejta për lirinë dhe sigurinë” është një e drejtë unike ndërsa kjo shprehje duhet të interpretohet si një e tërë. “Siguria e personit” duhet kuptuar në kontekstin e lirisë fizike dhe nuk mund të interpretohet sikur i referohet çështjeve të ndryshme (si për shembull detyrimi i një shteti për t’i suguruar dikujt mbrojtje personale kundrejt një sulmi nga të tjerë, ose të drejtën për sigurime shoqërore). Garantimi i “sigurisë së personit” shërben për të theksuar një kusht që kanë zhvilluar autoritetet në Strasburg

në interpretimin dhe shpjegimin e së drejtës për lirinë sipas Nenit 5.

Gjykata Evropiane ka theksuar rëndësinë e së drejtës për lirinë dhe sigurinë e personit në shumë çështje. Kështu, në *Kurt kundër Turqisë*<sup>1</sup>, Gjykata u shpreh:

*...që autorët e Konventës ritheksuan rëndësinë e mbrojtjes së individit kundrejt privimit arbitrar nga e drejta e tij/saj duke garantuar një korpus të drejtash substantive që kanë si qëllim të minimizojnë rreziqet e arbitraritetit, duke lejuar që akti i privimit të lirisë të jetë i hapur ndaj hetimit gjyqësor të pavarur dhe duke siguruar përgjegjshmërinë e autoriteteve për atë akt[...]* Ajo që është në rrezik është si respektimi i lirisë personale së një individi, ashtu edhe siguria e tij fizike në një kontekst të tillë që, në mungesë të garancive, mund të rezultojë në një subversion të shtetit ligjor dhe t’i vërë të burgosurit në mënyrë të tillë që të jenë përtej formave më elementare të mbrojtjes ligjore.

Interpretimi i dokumentit të Nenit 5 nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është jetësor për qëllimin e vënies në jetë të kërkesave të këtij Neni. Ashtu si edhe me të gjitha nenet e Konventës Evropiane, Gjykata Evropiane i ka interpretuar të gjitha dispozitat e Nenit 5 në një mënyrë qëllimplotë dhe dinamike, duke interpretuar ato në mënyrë të pashmangshme përtej kuptimit të mëvetësishëm për të përcaktuar çfarë dispozitash të saktuara përfshijnë ato. Interpretimi i dobishëm vazhdon duke u bazuar në faktin që objekti dhe qëllimi i Konventës

1. Kurt kundër Turqisë, gjykimi i 25 Majit 1998, para.123.

Evropiane të përmbushen kur përcaktohet se çfarë kërkojnë Neni 5 dhe dispozitat e tij të tjera. Kjo mënyrë është në pajtim me rregullat e interpretimit të traktatit dhe përbën gjithashtu një pasqyrim të karakterit kushtetues të Konventës Evropiane.

Kështu nuk është me vend që të konsiderohen kufizimet e imponuara nga Neni 5 si ato që duhet të interpretohen ngushtë. Synimi i Konventës është që të sigurojë të drejta të vërteta për individët, që do të thotë se të drejtat duhet të jenë ato me përmbajtje substantive dhe të mos konsiderohen thjesht si garantuese të një të drejte thjesht formale.

Si rrjedhojë, kufizimet mbi të drejtën e lirisë duhet të shihen si përjashtuese dhe të lejohen vetëm kur jepet për to një justifikim bindës;

zbatimi i tyre nuk mund të fillojë me ndonjë supozim se çdo gjë që propozojnë autoritetet publike është domosdoshmërisht gjëja e duhur.

Interpretimi dinamik përfshin edhe vullnetin për të rishqyrtuar interpretimin e dhënë tashmë për një dispozitë të veçantë duke marrë në konsideratë rrethanat që ndryshojnë. Rëndësia e interpretimit të bërë nga Gjykata Evropiane për tekstet ligjore nuk mund të nënvlerësohet. Me qëllim që të arrihet një përmbushje e plotë me detyrimet sipas Neni 5 (si dhe në bazë të të gjithë Konventës) gjyqtarët duhet të shqyrtojnë precedentin dinamik të Gjykatës Evropiane.

Pjesët që vijojnë do t'i drejtohen parimeve themelore dhe rregullave të konstatuara në Nenin 5 të Konventës Evropiane në bazë të interpretimit të tyre dhe zbatimit në situata konkrete nga Gjykata në Strasburg.



# Pjesa I: Prezumimi i lirisë; kushti i ligjshmërisë; koncepti i ndalimit me arrest

## 1. Prezumimi në favor të lirisë

Paragrafi 1 i Nenit 5 të Konventës Evropiane tregon që ka një prezumim që çdokush duhet të gëzojë lirinë e tij dhe se, si rrjedhojë, një personi mund t'i privohet kjo liri në rrethana përjashtuese. Kështu, prezumimi nis me një deklaratë joprofesionale mbi të drejtën “çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit” dhe kjo vijon me strukturën se “askujt nuk mund t'i hiqet liria përveç rasteve të mëposhtme dhe në përputhje me procedurë të parashikuara nga ligji”.

Gjithashtu, prezumimi në favor të lirisë theksohet nga kushti parësor sipas Nenit 5 për të siguruar që liria ashtu si duhet të humbet jo më shumë sesa është e nevojshme, dhe të jetë në gjendje që të rikuperohet menjëherë kur një humbje e tillë nuk justifikohet. E para është e qartë në detyrimet ku shkelës të dyshuar të ligjit “do të kenë të drejtën e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme” dhe e dyta konstatohet në parashikimin që çdokujt që i është hequr liria “do të ketë të drejtën për të nisur një ndjekje penale me anë të të cilës do të vendoset mbi ligjshmërinë e ndalimit të tij në mënyrë të shpejtë nga një gjykatë dhe mbi lirimin e tij nëse ndalimi nuk është i

ligjshëm”. Kështu ka një barrë prove të qartë mbi ata që i kanë hequr lirinë dikujt për të vendosur jo vetëm që kompetenca mbi atë që ka ndodhur i takon njërit prej motiveve të specifikuar në Nenin 5, por gjithashtu se ushtrimi i kësaj kompetence është e zbatueshme në situatën e caktuar në të cilën u vu në përdorim.

Kjo barrë domosdoshmërisht kërkom një analizë kritike nga ata që mund të ushtrojnë kompetenca të tilla që mund të çojë në heqje të lirisë për të siguruar që, kur ata vërtet i përdorin ato, të mbikqyren në mënyrë të vazhdueshme kufizimet e vëna nga Neni 5. Megjithatë, fakti për një analizë e tillë të sigurohet që edhe ndërmerret, edhe është efektive, varet jashtëzakonisht nga një perspektivë skeptike që zbatohet nga ana e gjyqtarëve kur kryejnë një funksion të rëndësishëm mbikëyres që i caktohet atyre nga Neni 5 (3) dhe (4). Në çdo rast, kur kontestohet një heqje lirie, është thelbësore për një gjyqtar që të nisë punën nga presupozimi se personi në fjalë duhet të lihet i lirë. Në bazë të këtij presupozimi gjyqtari jo vetëm që duhet të presë dhe të kërkojë arsyet që duhen parashtruar për këtë heqje lirie, por edhe duhet t'i kalojë ato nëpërmjet një hetimi të hollësisht për të shqyrtuar nëse ato aktualisht e justifikojnë veprimin që është ndërmarrë. Çdo gjë që tregon të kundërtën do të rezultonte në devijim nga shteti ligjor dhe në dorëzim drejt trajtimit arbitrar.

Papranueshmëria e çdo tendence në këtë drejtim mund të shihet në konkluzionin e nxjerrë nga Gjykata Evropiane se masa e ndalimit

të vazhdueshme të një personi nuk mund të justifikohet në çështjen *Mansur kundër Turqisë*<sup>2</sup>, kur gjykata vendase në mënyrë të përsëritur autorizoi vazhdimin e masës së ndalimi duke përdorur forma fjalësh të vazhdueshme identike dhe në fakt stereotipe, shpesh pa përpunim të mëtjeshëm. Në shqyrtimin e kësaj metode pune gjyqtari vendas thjesht po zbatonte vendimin e ligjvënësve dhe dështoi në ushtrimin e një gjykimi të pavarur e kritik. Kjo nuk mund të jetë asnjëherë në pajtim me kushtin e justifikimit të heqjes së lirisë.

## 2. Ligjshmëria e ndalimit

Paragrafi 1i Nenit 5 kërkon që çdo heqje lirie të jetë “në përputhje me një procedurë të parashikuar nga ligji”. Më tej, çdo nën-paragraf të parashikuar për çështjet kur heqja e lirisë lejohet supozon që masa të jetë “e ligjshme”. Kërkesa e ligjshmërisë është interpretuar në kuadrin që i referohet si procedurës, ashtu edhe thelbit. Për më tepër, ligjshmëria nënkuptohet që çdo ndalim duhet të jenë në përputhje me të drejtën kombëtare dhe më Konventën Evropiane dhe nuk duhet të jetë arbitrar.

2. 8 Qershor 1995.
3. Duke pranuar se i takon kryesisht autoriteteve të Shtetit Palë – dhe veçanërisht gjykatave – interpretimi dhe aplikimi i ligjit, Gjykata rezervon kompetencën për të rishikuar nëse ky rast ka qënë në përputhje me ligjin; dhe në disa çështje që merren në shqyrtim në kapitujt e mëposhtëm ka arritur në një konkluzion të ndryshëm nga ai i autoriteteve.
4. 21 Shkurt 1990.

## Pajtueshmëria formale me të drejtën kombëtare

Është sigurisht thelbësor fakti i kontrollit së pari për të shqyrtuar nëse kushtet e të drejtës kombëtare përkatëse janë përmbushur kur dikujt i është hequr liria e tij ose e saj. Kjo mund të jetë çështje e përcaktimit nëse një procedurë thelbësore është ndjekur siç duhet, ose e vlerësimit nëse ekziston një dispozitë ligjore që justifikon ndërmarrjen e veprimit. Kjo e fundit mund të çështje e interpretimit të qëllimit të një dispozitë të veçantë por gjithashtu mund të jetë edhe çështje e përcaktimit që lloji i situatës faktike për të cilën zbatohet një dispozitë aktualisht ekziston. Ekzistojnë një sërë shembujsh ku Gjykata Evropiane ka konstatuar se përsëra ato nuk janë kryer dhe si rrjedhim nuk duhen marrë parasysh<sup>3</sup>. Kështu në çështjen *Van der Leer kundër Vendeve të Ullta*<sup>4</sup> një grua u çua në një spital psikiatrik por gjyqtari që kishte lëshuar urdhrin kishte dështuar në mbikqyrjen e kushtit legjislativ që ajo të dëgjohej në gjyq. Në fakt, siç vërejtë Gjykata, gjyqtari nuk kishte marrë as mundimin që të shpjegonte pse e kishte anashkaluar opinionin e psikiatrit që merrej me çështjen e gruas, për të cilën opinionin i mjekut ishte i rëndësishëm për t’u dëgjuar në gjyq. Duke u bazuar në zbatimin e Konventës Evropiane, nuk është me vend kufizimi i gruas në baza meritore të ishte i përshtatshëm dhe i pajtueshëm në këtë kuadër me motivet e autorizuar nga Neni

5; sa herë që nuk është përmbushur një kusht procedural përpara se të hiqet liria e një personi, arrestimi ose ndalimi i tij do të konsiderohet si i papranueshëm.

Po kështu në *Lukanov kundër Bullgarisë*<sup>5</sup>, njërit nga ish-kryeministrat e vendit i ishte hequr liria në lidhje me dhënien e disa fondeve publike për vendet në zhvillim. Megjithëse heqja e lirisë në lidhje me veprat penale është mjaftueshmërisht në përputhje me Konventën, këtu nuk u arrit të përcaktohej se aktiviteti që rezultoi në heqjen e lirisë ishte aktualisht i paligjshëm, përveç veprës penale. Si rrjedhim, ky aktivitet i akuzuar i kërkuesit nuk mund të përbënte bazat për heqjen e lirisë sipas ligjit Bullgar. Gjithashtu, megjithëse ndalimi penal zbatohet kur kërkohet të pëftohen të ardhura nga dhënia e fondeve të tilla (që duket se nuk ka të ngjarë), nuk kishte fakte ose informacion që mund të tregonte ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm që kryeministri në fakt e kishte kryer veprimin për përfitime të tilla. Si rrjedhim, humbja e lirisë ishte totalisht pa ndonjë bazë ligjore dhe përbënte një shkelje të pakundërshtueshme të Nenit 5.

Po kështu edhe në çështjen *Steel kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>6</sup> në lidhje me disa aplikantë që ishin arrestuar kur shpërndanin fletëpalosje dhe mbanin flamurë gjatë një proteste në lidhje me shitjen e armëve. Megjithëse arrestimi ishte i justifikueshëm në rastet e prishjes së qetësisë, sjellja e tyre nuk përbënte asnjë justifikim për policinë që të frikësohej se një gjë e tillë mund të ndodhte; nuk ekzistonin prova që ata kishte

ndaluar në mënyrë të konsiderueshme ose që ishin përpjekur të ndalonin personat që ndiqnin konferencën ose që kishin ndërmarrë veprime të tilla që mund të rezultonin në provokimin e akteve të dhunshme. Gjykata Evropiane deklaroi se arrestimi dhe masa e ndalimit të mëpasshme e këtyre aplikantëve duke u bazuar në prishjen e qetësisë publike ishin të paligjshme.<sup>7</sup>

## Rëndësia e bazave ligjore të vazhdueshme

Kushti i ekzistencës së një bazë ligjore për çdo lloj heqje lirie shtrihet për të gjithë periudhën që ajo zgjat. Ka një sërë shembujsh ku janë konstatuar shkelje në heqjen e lirisë për shkak të bazës ligjore, panvarësisht se si fillim ka qenë e ligjshme, por në një pikë të caktuar nuk ka ekzistuar më. Kështu në *Quinn kundër Francës*<sup>8</sup> ishte urdhëruar lirimi i një personi nga një gjykatë, i cili është mbajtur nën masën e ndalimit gjatë të gjithë kohës në bazë të ligjit Francez. Megjithatë, për rreth njëmbëdhjetë orë pas një urdhri të tillë, kërkuesi kishte vazhduar të ishte nën arrest pa u njoftuar për ndonjë urdhër ose lëvizje që do të ishte ndërmarrë për tëq nisur ekzekutimin e masës në fjalë. Duket se zyra e prokurorit në këtë rast duhej të vinte në lëvizje procedurat e ekstradimit kundër tij që më pas do të kishin shmangur detyrimin për të qenë në pajtim me urdhrin e liritimit. Gjykata Evropiane njohe faktin se mund të kishte pasur disa vonesa

5. 20 Mars 1997.
6. 23 Shtator 1998.
7. Gjithashtu shih *Raninen kundër Finlandës*, 16 Dhjetor 1997, ku arrestimi i një personi i cili kishte refuzuar të kryente shërbimin kombëtar binte në kundërshtim me ligjin finlandez, sepse ai nuk ishte pyetur më parë nëse do të këmbëngulte në refuzimin e tij.

8. 22 Mars 1995.
9. 6 Prill 2000.
10. 27 Nëntor 1997.
11. Shih gjithashtu Engel dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulta, 8 Qershor 1976, ku maksimumi i lejuar i periudhës së arrestit provizor prej njëzetekatër orësh e tejkalonte atë me një periudhë ndalimi midis njëzetedy dhe tridhjetë orësh.
12. 28 Mars 2000.
13. Faktorë të tjerë që përkufizojnë termin ligjshmëri do të konsiderohen në vijim. Një shkelje e Nenit 5(1) për këto arsye në lidhje me të njëjtën praktikë u konstatua në çështjen Kawka kundër Polonisë, 9 Janar 2001. Përpara vendimeve në këto çështje praktika ka përfunduar dhe është zëvendësuar nga njëra prej çështjeve referuese ku urdhëri i ndalimit i është bërë gjykatës gjatë fazës hetimore për të marrë një vendim sa më të shpejtë mbi faktin nëse ndalimi i personit në fjalë duhet të vazhdojë apo jo. Kjo gjë përbush kushtet e Konventës përsa i përket ligjshmërisë dhe mbikqyrjes gjyqësore.
14. 31 Korrik 2000.

në përputhjen me një urdhër të tillë, por deklaroi se intervali përkatës ishte qartësisht shumë i gjatë për t'u përbushur me kërkesat e Nenit 5.

Në *Labitakundër Italisë* u konstatuan një shkelje e Nenit 5 kur vonesa prej 10 orësh në lirim nga burgu iu atribua mungesës së nëpunësit të regjistrimit që pengoi verifikimin e faktit nëse ekzistonin arsye të tjera për të mbajtur kërkuesin në masë ndalimi<sup>9</sup>. Në *K-F kundër Gjermanisë*<sup>10</sup>, kërkuesi u mbajt nën arrest dyzëtë minuta më shumë sesë afati autoritetet kompetencën për të mbajtur në paraburgim një person deri në dymbëdhjetë orë më qëllim që të gjendej identiteti i tij ose i saj). Qeveria gjermane pretendoi se kjo gjë u kërkua me qëllim që të regjistroheshin të dhënat personale të kërkuesit. Gjykata Evropiane vëzhgoi se ky regjistrim i detajeve personale bënte pjesë në masat për të pasur nën kontroll identitetin e personit dhe si rrjedhim duhej të kryhej brenda afatit të ndalimit të përcaktuar me ligj për këtë qëllim. Në këto rrethana ndalimi i kërkuesit duhej të konsiderohej si i paligjshëm dhe Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 5 në këtë rast<sup>11</sup>.

## I pabazuar në praktikën vendase

Gjykata Evropiane ka konstatuar shkelje të Nenit 5 në çështjet ku autoritetet vendase janë bazuar në praktikat e qëndrueshme të vendit të tyre, ligjshmëria e të cilave asnjëherë nuk u vu në

diskutim. Kështu në *Baranovski kundër Polonisë*<sup>12</sup> kërkuesi fillimisht ishte arrestuar konform rregullave dhe më pas u zgjat masa e ndalimit për shkak të azukave përmashtim. Megjithatë ndalimi i tij nuk u rishqyrtua pasi prokurori e arkivoi aktakuzën në gjykatë. Duke iu referuar praktikës polake që e vë të ndaluarin “në dispozicion të gjykatës”, ndalimi që u urdhërua më parë në fazën e hetimit të çështjes ishte zgjatur me kohë të pacaktuar; gjykata nuk ishte detyrim që ng ana a saj të merrte vendim mbi faktin nëse duhej të vazhdonte masa e ndalimit apo jo në atë fazë të hetimit. Kjo praktikë pa dyshim dhe sigurisht që ishte kryer për një arsye por mungonte totalisht mbështetja për një masë të tillë si në legjislacion ashtu edhe në juridiksion. Dyshohet fakti nëse ligjshmëria e praktikës ishte vënë ndonjëherë në diskutim duke qënë se nevoja për të vazhduar masën e ndalimit ishte e pamohueshme dhe gati e pajtueshme me Konventën Evropiane dhe ecuria e çështjes ishte një shembull mjaft i mirë për të parë sesi ligjshmëria e drejtimit të një çështjeje mund të rezultojë në neglizhimin apo indiferencën për të vënë në diskutim ligjshmërinë e çështjes në fjalë. Në këtë çështje Gjykata e dënoi praktikën si shkelje të Nenit 5 (1) sepse i mungonte parashikueshmëria dhe qartësia si dhe se kishte dhënë shkas për arbitratizëm<sup>13</sup>. Në *Jecius kundër Lituanisë*<sup>14</sup>, kërkuesi – një i dyshuar për vrasje – kishte vazhduar të mbetej në paraburgim edhe pasi kishte përfunduar afati i ndalimit të autorizuar nga një zëvendësprokuror i përgjithshëm. Në këtë mënyrë dukej se ishin

trajtuar çështjet duke u bazuar në praktikat e përhershme që bien ndesh me kërkesat e Konventës. Gjykata u shpreh se heqja e lirisë ndaj kërkuesit binte ndesh me parimet e sigurisë ligjore dhe mbrojtjes kundrejt arbitrarizmit<sup>15</sup>.

## **Pajtueshmëria me Konventën. Interpretimi i Konventës mbi ligjshmërinë**

Çdo heqje lirie, në vijim të faktit të pajtueshmërisë me të drejtën kombëtare duhet të përmbushë gjithashtu interpretimin mjaft të gjerë të termit “i ligjshëm” në Konventën Evropiane. Ky interpretim lidhet së pari me idenë për të siguruar që vihen në pah kërkesat specifike të Nenit 5 – megjithëse nuk gjenden në të drejtën kombëtare të një vendi. Një heqje liria do të konsiderohet si objektive kur kjo shihet ose si mjet i ndërhyrjes në të drejtat e tjera dhe liritë e garantuara nga Konventa, ose nëpërmjet një ligji që zbatohet në mënyrë arbitrare, ose kur karakteri i saj konsiderohet si i pamjaftueshëm. Në *Kurt kundër Turqisë* Gjykata Evropiane u shpreh se

*... çdo heqje lirie nuk duhet të vihet në zbatim vetëm duke qënë në pajtim me rregullat substantive dhe procedurale të ligjit vendas, por duhet edhe t'i përmbahet qëllimit kryesor të Nenit 5, përkatësisht mbrojtjes së individit kundrejt arbitrarizmit<sup>16</sup>.*

Kur autoritetet vendase nuk arrijnë të japin ndonjë motiv për masën e ndalimit, Gjykata

menjëherë konstaton shkelje të Nenit 5 (1). Në *Denizci dhe të tjerë kundër Qipros*, kërkuesit pretenduan, midis të tjerash, se nuk u dha asnjë arsye për arrestimin e tyre dhe Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 5 (1) duke shqyrtuar se qeveria e akuzuar nuk ndërmorri ndonjë bazë ligjore për arrestimin dhe ndalimin e aplikantëve<sup>17</sup>.

## **Papajtueshmëria me dispozitat e Konventës**

Heqja e lirisë që justifikohet ligjërisht në nivel kombëtar duke përjashtuar motivet e renditura në detaj në Nenin 5 (1) sigurisht që do të konstatohet “të paligjshme” duke qënë se bien në kundërshtim me Nenin 5 (1). Motivët për shembull nuk lejojnë marrjen e masave parandaluese kundrejt kriminelëve të dyshuar kur ndjekja ligjore nuk është objekti i ndalimit<sup>18</sup>. Një heqje e tillë lirie, megjithëse mund të jetë e ligjshme në bazë të legjislationit vendas, bie në kundërshtim me Nenin 5 (1).

Megjithatë, edhe kur heqja e lirisë justifikohet në bazë të motiveve të renditura në Konventë, ajo vë kufizime përse i përket pranueshmërisë të kohëzgjatjes së saj të përgjithshme. Kështu, në çështjen e personave të ndaluar në pritje të gjykimit kjo konstatohet në kushtet e qarta të Nenit 5 (3) ku thuhet gjyqi duhet të mbahet brenda një afati kohor të arsyeshëm; ndërsa në rastet e personave të ndaluar në lidhje me dëbimin, ekstradimi dhe procedurat përkatëse vijojnë në bazë të detyrimit

15. Përfundime të ngjashme të shkeljes së Nenit 5(1) u trajtuan në Grauslys kundër Lituaniës, 10 Tetor 2000.
16. 28 Maj 1998.
17. 23 Maj 2001.
18. ë'fjush kundër Lituaniës.

të qartë që kanë autoritetet përkatëse për të vepruar në mënyrë të arsyeshme.

## Përdorimi arbitrar i pushtetit

Megjithatë, edhe nëse një ligj vendas që autorizon heqjen e lirisë nuk jep shkas për kundërshtimesin e rastet kur është në pajtueshmëri të plotë me standartet e Konventës Evropiane, përdorimi i tij në rrethana të veçanta gjithashtu mund të mos jetë i ligjshëm pasi konsiderohet si arbitrar. Ky përcaktim sigurisht që konsiderohet i përshtatshëm kur një kompetencë përdoret në rrethana të tilla kur heqja e lirisë nuk është vërtet e nevojshme ose ka si qëllim që të përmbushur një objektiv të paligjshëm. Një shembull i të parës (nuk është vërtet e nevojshme) mund të konstatohet në *Witold Litva kundër Polonisë*<sup>19</sup>, kur një person që ishte verbuar në një sy dhe shikimi në syrin tjetër ishte dëmtuar rëndë, ishte dërguar në një qendër kundër alkolizmit – pasi nëpunësit e postës – për të cilët ku ai kishte bërë ankesë se i kishin hapur kutitë e tij dhe ishin boshatisur – kishin njoftuar policinë duke pretenduar se ishte i pirë dhe ishte sjellë në mënyrë fyese. Megjithatë, megjithëse ndalimi i kërkuesit ishte me motivin që përfshihej në Nenin 5 (1) e, - ndalimi i alkolikëve – përdorimi i kompetencave ishte i panevojshëm për shkak të mungesës së ndonjë kërcënimi për publikun apo për veten, për verbërinë e tij dhe rrethanat mjaft të parëndësishme të çështjes. Gjithashtu, ligji parashikonte masa të tjera që

ishin më pak drakoniane në lidhje me personat e intoksikuar – si për shembull dërgimi i tyre në një vend rehabilitimi ose në shtëpitë e tyre – dhe duket se nuk është marrë parasysh fakti sesi do të përdoreshin ato. Kështu, panvarësisht nga baza e saj ligjore formale, heqja e lirisë do të konsiderohej si një përdorim arbitrar i pushtetit, pra i paligjshëm.

Po kështu mund të arrihet një konkluzioni i ngjashëm kur u ndërmor një urdhër ndalimi kundrejt dikujt të njohur nga policia më parë (për të verifikuar identitetin e tij) panvarësisht nga fakti se personi në fjalë nuk e kishte kartën e identitetit në atë kohë. Përdorimi i pushtetit që duket qartë se është i panevojshëm në rrethana të tilla do të dilte në nxjerrjen e konkluzionit se është arbitrar. Ky lloj përdorimi i pushtetit i pajustificuar mund të shihet gjithashtu edhe në *Tsirlis dhe Kouloumpas kundër Greqisë*<sup>20</sup>, ku dy dëshmitarë të Jehovahit ishin burgosur pasi ishin dënuar për mosbindje nga urdhërit për të kryer shërbimin ushtarak dhe se kishin refuzuar të bashkoheshin me njësitë e tyre apo të vishnin uniformën ushtarake. Gjatë gjithë kohës ata i ishin referuar faktit se ishin priftërinj të fesë së tyre dhe si të tillë përjashtoheshin nga detyrimi për kryerjen e shërbimit ushtarak. Zbatueshmëria e një përjashtimi të tillë për priftërinjtë që ishin Dëshmitarë të Jehovahit ishte përcaktuar qartë në precedentin e gjykatës së lartë për çështjet administrative, por Gjykata Evropiane konstatoi se ishte e qartë që kjo gjë nuk ishte marrë në konsideratë nga gjykatat ushtarake që kishin

19. 4 Prill 2000.  
20. 29 Maj 1997.



ndjekur çështjen e aplikantëve. Në këto rrethana procedimet kundër aplikantëve që rezultuan në humbjen e lirisë së tyre, do të konsideroheshin si arbitrare dhe të paligjshme për qëllimet e Nenit 5 (1).

Gjithashtu, përdorimi i pushtetit të ligjshëm vetëm për të arritur një objektivi të paligjshëm nuk është e pranueshme sipas Konventës, panvarësisht nga fakti nëse një përdorim i tillë i dispozitave ligjore kombëtare shqyrtohen nga vetë vendi përkatës për tu bërë të kundërshtueshme. Kështu, në *Bozano kundër Francës*<sup>21</sup>, u konstatua një shkelje kur një person i ndaluar në dukje me qëllimin e deportimit, por që aktualisht u krye si mjet për të shmangur kufizimet mbi ekstradimin. Në këtë çështje kërkesa për ekstradim në Itali u refuzua nga një gjykatë franceze. Megjithatë, gati një muaj pas lirimt nga gjykatat franceze kërkuesi u arrestua dhe u la në pritje të një urdhri për nxjerrje jashtë vendit që në fakt ishte nxjerrë gjatë kohës që ai ishte i arrestuar në procedurat e ekstradimit. Më pas kërkuesi u dërgua në kufirin zvicerian megjithëse kufiri spanjoll ishte shumë më i afërt dhe iu dorëzua policisë në Zvicër. Kur mbërriti në Zvicër përfunduan edhe procedurat e ekstradimit të tij për në Itali dhe kërkuesi u dërgua në një burg italian në pritje të vendimit. Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të Nenit 5 (1) duke deklaruar se i tërë drejtimi i procesit ishte arbitrar. Gjykata vuri theksin në disa faktorë që arriti në këtë konkluzion: vonesa në zbatimin e masës së nxjerrjes jashtë shtetit të kërkuetit duke bërë që ai të mos vinte dot në

përdorim ndonjë mjet ndihmës në dispozicion të tij; fakti që Zvicra dhe Italia ishin të informuar më parë për veprimin e ndërmarrë; pamundësia për të vënë në dijeni kërkuetin mbi urdhrin e dëbimit kur u refuzua aplikimi për leje banimi; përfshihet këtu edhe shpejtësia e kuptimit nga ana e kërkuetit dhe pamundësia e tij për të folur me gruan ose avokatin e tij; mungesa e zgjedhjes së destinacionit për nxjerrjen e tij jashtë shtetit. Të gjitha këto bënë të paevitueshëm që “ekstradimi i fshëhtë” i kërkuetit do të bënte privimin e lirisë së tij arbitrar dhe si rrjedhojë të paligjshëm për qëllimet e Nenit 5 (1). Megjithatë, panvarësisht nga fakti se akumulimi i faktorëve ishte i madh, secili nga ata në mënyrë individuale jepte prova për një mungesë respekti në lidhje me ligjin në kuptimin më elementar dhe ka mundësi që edhe mënyra e trajtimit të secilit prej tyre do të ishte e mjaftueshme për të konstatuar një arbitrarizëm<sup>22</sup>.

### **Aksesibiliteti, parashikueshmëria dhe garancitë e tjera**

Edhe në rastet kur një kompetencë ekziston dhe nuk keqpërdoret, ajo nuk do të konsiderohet nga Gjykata Evropiane se përbën bazën ligjore të nevojshme për privimin e lirisë nëse dispozitës ligjore i mungon cilësia që mund të konsiderohet thelbësore për cilindo ligj që të quhet i pranueshëm për qëllimet Konventës Evropiane. Kjo përfshin ligjin që duhet të jetë i aksesueshëm,

21. 18 Dhjetor 1986.
22. Gjithashtu shih Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 Tetor 1994, në të cilën u dëshmuua se qëllimi i një ndalimi nuk ishte të sillte personin para organeve gjyqësore kompetente si i dyshuar për kryerjen e një veprë të jashtëligjshme sipas Nenit 5(1) (c), por vetëm me qëllimin për ta pyetur për të mbledhur informacione sekrete, për të cilën nuk kishte autorizim nga Konventa. Gjykata arriti në përfundimin se nuk u paraqitën elemente bindëse që të çonin në kundërshtim nga përfundimet e gjykatave vendase se prapa ndalimit nuk ka pasur një qëllim të tillë të fshehtë dhe të padrejtë, por edhe sikur të kishte, arresti do të shpallej i paligjshëm për qëllimet e Konventës. Gjithashtu duhet përmendur se në çështjen *ë Fjush kundër Lituaniës*, mungesa e keqbesimit nga ana e gjykatës vendase ishte një nga çështjet në shqyrtim besuar Gjykatës në konstatimin se një periudhë ndalimi e shpallur që kishte një bazë të qartë ligjore nuk ishte e paligjshme për qëllimet e Konventës. Ngjashëm në çështjen *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 10 Qershor 1996, Gjykata nuk pranoi të konstatonte se një dënim me burgim i dhënë nga një gjykatë ishte arbitrar aty ku

i parashikueshëm dhe i qartë si dhe që përmban garanci të tjera kundrejt rrezikut të arbitraritetit në mënyrën sesi duhet të trajtohen ato që i nënshtrohen një ligji të tillë.

Kushti i aksesibilitetit nuk përmbushet nëse një privim lirie bazohet në një dispozitë ligjore që ka qënë sekret ose i pabotuar. Kushti i aksesibilitetit zbatohet edhe në rregulla shtesë që miratohen për vënien në zbatim të ligjit. Nëse rregulla të tilla nuk janë të disponueshme gjërisht, Gjykata Evropiane mund të konstatojë shkelje të Nenit 5 (1). Një shembull i tillë mund të shihej në *Amuur kundër Francës*<sup>23</sup>, por për faktin se një letër qarkore e pabotuar – i vetmi dokument që fliste në mënyrë specifike për praktikën e mbajtjes së të huajve në zonën e tranzitit – u konsiderua nga vetë Gjykata se ishte shumë e shkurtër dhe që i mungonte garancia e duhur që kërkohej për ta përligjur. Kështu që nuk përbënte ndryshim fakti se letra nuk ishte botuar dhe që si pasojë nuk ishte bërë publike, por se nuk kishte dyshime për faktin se në raste të tjera kjo do të ishte çështja kryesore për tu marrë nën shqyrtim. Në këto raste, cilësia e përmbajtjes do të ishte e pamjaftueshme për parandaluar që të neglizhohet moszbatimi i rregullave dhe që të konstatohet se heqja e lirisë do të jetë e ligjshme.

Siguria ligjor kërkon që cilido rregull që zbatohet duhet të jetë mjaft i saktë që të lejojë një person – duke përfshirë edhe sigurimin e këshillimit përkatës – që të parashikojë deri në njëfarë mase se është e arsyeshme në rrethanat që mund të ndodhë një veprim i caktuar.

Pamundësia për të përmbushur këtë gjë – që mund të shihet edhe si kusht për të formuluar ligjin në mënyrë të tillë që të kufizohet qëllimi për trajtim arbitrar – mund të shihet në çështje të tilla si *Baranovski kundër Polonisë* dhe *Jecius kundër Lituanisë* ku Gjykata Evropiane, panvarësisht nga këndvështrimi i përmendur më sipër, u përgatit për të punuar mbi supozimin se praktikët mbi të cilat bazohet akuza në këto çështje nuk bazohej në ligjin vendas. Megjithatë, Gjykata konstatoi se gjithsesi ato ishin të paligjshme. Në *Baranovski* zbatoheshin të dy teknikat për shkak të mungesës së ndonjë dispozite të saktë që të parashtronte nëse, (e nëse jo) në bazë të cila kushteve masa e ndalimit që ishte nxjerrë në fazën hetimore do të mund të zgjatej përsa të ishte e nevojshme gjatë ndjekjes penale dhe për shkak se një individ është mbajtur në paraburgim në bazë të kësaj praktike të ndjekur si rezultat i lakunës statute për një kohë të pakufizuar e të paparashikuar pa u bazuar në një dispozitë konkrete ligjore ose në ndonjë vendim gjyqësor.

Në *Jecius* u konstatua gjithashtu se mungonte siguria ligjore për shkak se nuk ekzistonin rregulla të qarta për ti dhënë drejtim pozitës së të burgosurve. Ndalimi i një personi për një periudhë të pakufizuar pa autorizim gjyqësor duke u bazuar vetëm në faktin se çështja i është referuar gjyqeve të tjera, u konstatua se binte në kundërshtim me Nenin 5 (1). Megjithatë, siguria ligjore u konsiderua se mungonte kur u bënë përpjekje për të justifikuar periudhën e ndalimit duke iu referuar një dispozitë në

nuk ishte lënë të kuptohej nëse vendimi ishte marrë në keqbesim apo nga ndonjë pakujdesi në aplikimin e legjislacionit përkatës në mënyrë të drejtë. Në çështjen *Perks kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 12 Tetor 1999, Gjykata la të kuptohej se një ushtrim vendimi për masë ndalimi, ose një dështim i marrjes në kujdes të një pjese përkatëse prove mund të bëjë arbitrar një vendim, në rast të kundërt zyrtarisht të ligjshëm.

23. 25 Qershor 1996.



kodin penal. Duke bërë kështu u parashtruan tre shpjegime të ndryshme nga prokurori, avokati i popullit, presidenti i departamentit të çështjeve penale të gjykatës së lartë dhe nga vetë qeveria për mënyrën sesi një dispozitë e tillë do të mundësojë autorizimin për ndalimin në fjalë. Gjykata Evropiane, në përpjekjen për të zgjidhur mosmarrëveshje të tilla të konsiderueshme qartësisht arriti në përfundimin se cilado dispozitë që do të ishte mjaftueshmërisht e paqartë për të shkaktuar konfuzion ndërmjet autoriteteve të Shtetit në fjalë do të jetë e papajtueshme me kushtet e ligjshmërisë<sup>24</sup>.

Kushti i sigurisë së bazave ligjore për heqjen e lirisë mund të jepet edhe nëpërmjet rregullave të ngjashëm, edhe pse nuk janë në të njëjtën vend në hierarkinë ligjore<sup>25</sup> ose duke zhvilluar jurisprudencën për të përcaktuar interpretimin që duhet bërë për një dispozitë të caktuar. Një shembull i të fundit mund të shihet në çështjen e *Steel kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>26</sup> që kishte të bënte me një arrestim për prishje të rendit publik. Gjykata Evropiane konstatoi se koncepti i “prishjes së rendit publik” ishte qartësuar gjatë dy dekadave ku ishin marrë vendime gjyqësore në vendin përkatës, ku ka lidhje vetëm me personat që shkaktojnë dëme, ose duket se ka të ngjarë t’u shkaktojnë dëme personave ose pronave të caktuara, ose që veprojnë në mënyrë të tillë që reagimi i natyrshëm të ishte provokimi i të tjerëve për dhunë. Efekti i këtij interpretimi ishte rrjedhimisht që të kthehej një koncept paksa i pasaktë në një që të rregullohej me udhëzimet e

duhura dhe saktësinë e duhur. Në *Ëloch kundër Polonisë* interpretimi i një dispozite për të cilën nuk kishte juridiksion të zbatueshëm ose një mendim të njëjtë nga ana e studiuesve të ligjit nuk ishte as arbitrar e as i paarsyeshëm. Megjithatë, vendime të tilla nuk bëjnë thirrje për të refuzuar konfrontimin mbi ligjshmërinë e një dispozite në bazë të saktësisë së duhur që do të rezultojë nga çështjet për të cilat do të merren vendime në të ardhmen. Megjithëse do të ishte jashtëzakonisht legjitime që të përdoret pushteti i interpretimit për të bërë një dispozitë të parashikueshme me spektër të gjerë, ndërtimi i ngushtë kërkohet që të mbahet “i ligjshëm” për qëllime të Konventës.

Sigurisht që nevoja për garanci të tilla në situata të veçanta mund të jetë me spektër mjaft të gjerë. Kështu në *Amuur kundër Francës* – ku azilkërkuesit ishin ndaluar për njëzetë ditë – Gjykata nuk u kënaq me faktin asnjë nga dokumentet ligjor që janë të zbatueshme për mbajtjen e të huajve në zona tranziti nuk linte hapësirë për rishikim të kushteve në të cilat ishin mbajtur ata nga gjykatat ose, nëse ishte e nevojshme, nuk vinin afate për autoritetet përsa i përket gjatësisë së kohës në të cilën ishin mbajtur ata. Gjithashtu Gjykata Evropiane vërejti se dokumentet ligjore nuk parashikonin ndihmë ligjore, humanitare dhe sociale dhe ndonjë procedurë e afate kohore për të pasur akses për një ndihmë të tillë me qëllim që azilkërkuesit të mund të ndërmerren hapat e nevojshëm. Kështu u konsiderua se ligjet nuk garantonin mjaftueshëm të drejtën për lirinë e një grupi

24. Gjithashtu shih *Wloch kundër Polonisë*, 19 Tetor 2000, ku Gjykata dyshoi se privimi i lirisë do të kishte që në i ligjshëm nëse do të bazohej në interpretimin për të cilin kishte shumë opinione kontradiktore dhe nuk kishte precedent përfundimtar.
25. *Qarkorja* në çështjen *Amuur kundër Francës* ishte e pamjaftueshme për këtë qëllim jo për shkak të statusit të vendit, por për shkak të mungesës së përpikshmërisë.
26. Edhe pse zyrtarisht nuk u klasifikua si një kundravajtje, u trajtua si e tillë për shkak të natyrës së ndjekjeve penale – duke përfshirë policinë dhe Gjykatën Penale të Shkallës së Parë – dhe kompetencën për të burgosur individët të cilët refuzojnë të lirohen me kusht për të ruajtur rendin publik.

aplikantësh të cilët mund të ishin veçanërisht në rrezik për shkak të mospajzimit të një ndihme të tillë.

Gjithashtu, kushtet mund të jenë mjaft thelbësorë e të vlefshëm. Kështu Gjykata ka theksuar përherë rëndësinë e regjistrimit të të dhënave të sakta e të besueshme përpara i përket heqjes së lirisë. Ky problem është shprehur nga Gjykata në një sërë çështjesh ku ishin paraqitur ankesa për disa persona që ishin arrestuar nga forcat e rendit dhe se nuk kishte asnjë njoftim të disponueshëm se çfarë i ndodhi atyre më pas<sup>27</sup>. Mungesa e të dhënave të marra nga policia në lidhje me personat në fjalë krijoi vështirësi të mëdha dhe kjo sigurisht që i lehtësoi punën autoriteteve që ishin përgjegjës për heqjen e lirisë duke shmatur përgjegjësinë për atë që ndodhi. Regjistrimi i rregullt i të dhënave në lidhje me heqjen e lirisë nga një arrestim fillestar deri në transferimin nga një vend në tjetrin të të ndaluarit përbën një garanci jetësore kundrejt trajtimit arbitrar. Procesi i institucionalizuar i regjistrimit të të dhënave, edhe nuk ka rrezik për abuzime të tilla si zhdukje të tyre, shihet si një kusht themelor kurdo që ndodh një heqje lirie.

### 3. Çfarë përbën një heqje lirie?

#### “Arrestimi” dhe “ndalimi”

Termet *arrestim* dhe *ndalim* përdoren në mënyrë të ndërthurur në gati të gjitha klauzolat

e Nenit 5 dhe ato duhet të konsiderohen si rrjedhojë se kanë kryesisht lidhje me ndonjë masë – përcarëdo lloj qëllimi që përdoren nga ligji vendas me efektin e heqjes së lirisë së një personi. Garancia e dhënë nga kushti i mbikqyrjes ligjore në Nenin 5 konsiderohet nga Gjykata se del në pah menjëherë pasi ka ndodhur një heqje lirie dhe ndonjë mënyrë tjetër do të përfshijë domosdoshmërisht një shkelje të Konventës. Kushti thelbësor është që të përqëndrohemi në atë që arrihet nga proceset dhe jo në mënyrën sesi quhen ato.

### Elementët për të përcaktuar se masa e ndalimit ekziston

Duhet të jetë i qartë fakti se çfarë përbën një heqje lirie – qoftë me anë të arrestimit apo ndalimit – dhe kur fillon, pasi vetëm atëherë bëhen të zbatueshme kushtet e Nenit 5 të Konventës Evropiane. Kjo gjë mund të duket vetë mjaft qartë por ende duhet theksuar fakti se sigurisht që mund të ketë situata kur dikujt i është hequr liria por që nuk është marrë parasysh ende nga personat përgjegjës, veçanërisht nëse nuk është vënë ndonjë izolim fizik. Është veçanërisht e rëndësishme që të identifikohet momenti kur humbet liria në kontekstin e procesit penal me qëllim që të hetohet si vonese përpara se personi i përfshirë të dalë për herë të parë në gjyq, si dhe kohëzgjatjes totale të cilitdo ndalim përpara se të fillojë procesi gjyqësor.

27. Shih Kurt kundër Turqisë; Çakici kundër Turqisë, 8 Korrik 1999, Timurtaş kundër Turqisë, 13 Qershor 2000 dhe Taş kundër Turqisë, 14 Nëntor 2000. Një humbje e tillë sjell me vete një dhunim të të drejtës për jetën e parashikuar në Nenin 2.

Elementë të tillë si lloji i kufizimit të përfshirë si dhe statusi i personit të përfshirë janë thelbësorë në përcaktimin e faktit nëse një masë e caktuar përbën heqje lirie.

## Natyra e izolimit

Gjykata Evropiane sigurisht që do të shqyrtojë natyrën e izolimit. Heqja e lirisë në shumicën e rasteve ka ndodhur kur një person mbahet forcërisht në një rajon policie ose në një qeli burgu, por ka edhe shumë forma të tjera të izolimit që mund të rezultojnë në vënien në përdorim të Nenit 5. Kjo ndodh kur për shembull një oficer policie – edhe nëse përdoret apo jo forca – i bën të qartë personit se ose nuk duhet të largohet nga një vend i caktuar ose është i detyruar të shkojë me të në një vend tjetër. Kjo përfshin edhe ndalimin e një personi në rrugë ose kur i është kërkuar të qëndrojë në një stacion policie ose pasi ka shkuar aty me vullnetin e tij/saj të lirë. E rëndësishme është ekzistenca e detyrimit për një gjë të tillë në mënyrë të tillë që, ashtu siç është bërë e qartë në *De Eilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës*<sup>28</sup>, nuk ka pasojë për faktin që personi mund të jetë dorëzuar me vullnetin e tij ose saj të lirë. Gjithashtu është e qartë që personi të cilit i është hequr liria është i ndërgjegjshëm për këtë veprim; është e mjaftueshme që ai ose ajo të mos jetë e/i lirë për t'u larguar.

Neni 5 është zakonisht i duhuri për t'iu referuar kur shkalla e izolimit në një vend të

caktuar është ekstreme ku personi i përfshirë nuk ka mundësi të lëvizë nga ky vend i caktuar – qoftë në rrugë ose në një vend tjetër të hapur – ose i kërkohet të qëndrojë në mjet të caktuar apo dhomë (jo domosdoshmërisht në qeli burgu). Megjithatë, fakti që një individ ka një shkallë lirie brenda një vendi të caktuar nuk do të nënkuptojë domosdoshmërisht se nuk ka vend për zbatim të Nenit 5. Kjo është konstatuar në *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>29</sup> ku përfshihej një person i cili, megjithëse ishte mbajtur me detyrim në një spital për të meta mendore, ishte vënë në një zonë e cila nuk ishte e mbyllur dhe atij i lejohej të linte zonën e spitalit gjatë ditës dhe gjatë fundjavës pa u shoqëruar. Po kështu në *Guzzardi kundër Italisë*<sup>30</sup>, u deklarua i zbatueshëm për faktin se dikush që ishte i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar jetonte në një zonë të parrethuar prej 2.5km<sup>2</sup> në një ishull të largët me persona të tjerë të tillë. Megjithëse gruaja dhe fëmija i tij mund të jetonin me të kombinimi i kufizimit me izolimin ishin të mjaftueshme në këtë rast që të trajtohej si heqje lirie. Këta faktorë janë më të rëndësishëm se vendi i izolimit kështu që kushti që një person duhet të qëndrojë në banesën e tij përfshinte Nenin 5 nëse – si në *Giulia Manzoni kundër Italisë*<sup>31</sup> – kishte të bënte me gjyq të pezulluar ose – si në *Qipro kundër Turqisë*<sup>32</sup> – pas vendosjes së një forme të rreptë embargoje sipas së cilës personat mund të largoheshin nga banesa e tyre vetëm nëse shoqëroheshin.

Kur ndodh një izolim në një zonë të tillë si për shembull në fshat ose në një lagje ku nuk

28. 18 Qershor 1971.

29. 28 Maj 1985.

30. 6 Nëntor 1976.

31. 1 Korrik 1997.

32. Aplik. Nr. 6780/74 dhe 6950/75 (Raport i Komisionit).

shoqërohet me izolim – siç ndodhi në *Guzzardi kundër Italisë* ka më shumë premisa që të konsiderohet më shumë si ndërhyrje ndaj lirisë së lëvizjes sesa ndaj privimit të lirisë.

Po kështu, kufizimet mbi personat që kërkojnë hyrje në në shtet të caktuar – si kërkesa që ata të qëndrojnë në një zonë të caktuar në aeroport si kundërpeshë ndaj mbajtjes forcërisht në një qëndër të caktuar ndalimi për të huajt – përgjithësisht nuk do të konsiderohet si privim ndaj lirisë duke qënë se ata kanë gjithsesi mundësinë për të shkuar në një shtet tjetër.

Megjithatë, një mundësi e tillë duhet të jetë realiste dhe nuk duhet të ekzistojë nëse nuk do të kishte asnjë shtet tjetër që të pranonte ata, ose kur personi në fjalë kërkon strehim, nuk ka asnjë shtet tjetër që ofron mbrojtjen që ai pretendon se mund të ketë në shtetin ku ai e ka kërkuar një mbrojtje të tillë. Një situatë e tillë u krijua në çështjen e *Amuur kundër Francës* ku alternativa e vetme e mundshme ishte Siria dhe pranimi nuk iu nënshtrua vetëm kushteve të “pengesave të marrëdhënieve diplomatike” por edhe faktit se ishin një shtet që nuk kishte detyrime në bazë të Konventës së Gjenevës mbi Statusin e Refugjatëve e kështu nuk kishte garanci që personat e përfshirë nuk do të ktheheshin në shtetin ku ata kishin frikë se do të persekutoheshin.

## Statusi i personit të përfshirë

Statusi i personit të përfshirë është gjithashtu i rëndësishëm në përcaktimin e faktit nëse ka ndodhur aktualisht privimi nga liria e personit. Kjo ka qënë pikëpamja mbi izolimin në vende të caktuara të personave që kryenin shërbimin në forcat ushtarake nëpërmjet zbatimit të regjimit të zakonshëm disiplinor. Kështu, në *Engel kundër Vendeve të Ulta* Neni 5 u konstatua se nuk ishte i zbatueshëm në formën e “arrestimit” për ushtarët të cilëve, megjithëse u ishte kërkuar që të kryenin detyrënetyre, u izoluan në një ndërtesë të posaçme por të pambyllur brenda ambienteve të ushtrisë gjatë orëve që ata ishin pushim. Ushtarët ishin në gjendje të ngrinin pretendimet e tyre vetëm kur iu nënshtruar një forme më të rreptë “arrestimi” që i izoloi ata në një qeli të mbyllur e si rezultat ata nuk ishin në gjendje që të kryenin detyrat e tyre të përditshme. Prezumimi që vuri theksin në shqyrtimin e çështjes është që duke qënë se shërbimi ushtarak në mënyrë të paevitueshme çon në një shkallë më të ulët të lirisë së personit, kufizimet që duhen të zbatohen përpara se të përfshijë Neni 5 domosdoshmërisht duhet të jenë më të mëdha se ato për civilët.

Vënia e masave më të larta të sigurisë me anë të kufizimeve mbi lirinë e dikujt që është tashmë në burg – si për shembull transferimi nga një burg me siguri të ulët në një ku të burgosurit janë të izoluar rreptësisht – nuk mendohet se mund të konsiderohet si privim i lirisë së personit

për qëllimet e Nenit 5, duke qënë se liria është humbur në këtë fazë si rezultat i dënimit ose ndonjë urdhri tjetër për izolim. Gjykata nuk mori në konsideratë faktin që nuk ka më shumë privim lirie kur një i burgosur izolohet në qeli sesa kur lihet në shoqërinë e zakonshme me të burgosur të tjerë të burgosur. Megjithatë, në *Bollan kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>33</sup> Gjykata pranoi që masat e miratuara në një burg mund të rezultojnë në ndërhyrje ndaj të drejtës për lirinë e personit në rrethana përjashtuese. Ajo pranoi gjithashtu se një i burgosur që u lirua me kusht e kishte rifitur lirinë e tij dhe rimarrja në burg do të përbëntë një privim të lirisë së tij sipas Nenit 5. Ajo bëri të qartë në *Èeeks kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>34</sup> se kjo ishte një fakt një çështje që duhej përcaktuar sipas rasteve të paraqitura por kushtet e vëna mbi personin për të cilin nevojiten një shkallë mbikqyrjeje e raportimi tek autoritetet përkatëse nuk ishin të mjaftueshme për të parandaluar që kërkuesi të konsiderohej i lirë për qëllimet e Nenit 5. Pa dyshim që ishte i rëndësishëm fakti se kërkuesi nuk ishte liruar për një qëllim mjaft specifik – si për shembull të merrte pjesë në një funeral – por mund të bënte një jetë normale duke iu nënshtruar disa kushteve.

## Veprimet e ndërmarra nga individë privatë

Megjithëse shumica e problemeve kanë premisa për të lindur nga veprimet dhe vendimet e gjytarëve dhe nëpunësve publikë për të përbushur kushtet e Nenit 5, sjellja e individëve privatë gjithashtu mund të jetë burim problemesh. Çdo lloj kompetence që i jepet individëve privatë për të arrestuar dikë duhet të kufizohet në bazë të kërkesave të Nenit 5. Një individ privat të cilit i është dhënë kompetenca për të arrestuar dikë që dyshohet se ka kryer një kundravajtje (edhe nëse është në përputhje me zbatueshmërinë e përgjithshme të ligjit ose një shërbim sigurimi privat) duhet të sigurohet që personit që i hiqet liria t'i nënshtrohet ndjekjes penale në të njëjtën mënyrë si është i detyruar që të veprojë një zbatues ligji.

Gjithashtu, nëpunësit publik nuk mund të presin e të lejojnë që privimi i lirisë së personit të kryhet kur nuk është në pajtim me kushtet e Nenit 5. Një pranim i tillë u konstatua se ka ndodhur në *Riera Blume dhe të Tjerë kundër Spanjës*<sup>35</sup> kur familjet e aplikantëve – që mendoheshin se ishin bërë anëtarë të një sektit fetar – i kishin mbajtur ata në një hotel në mënyrë që ata të “çprogramoheshin” nga një psikolog dhe një psikiater. Në këtë çështje specifike veprimi ishte kryer me sygjerimin e një gjykate pas arrestimit të aplikantëve gjatë një hetimi paraprak gjyqësor, por nuk kishte autoritet ligjor as për këtë e as për veprimin e ndërmarrë

- 33. 4 Maj 2000 (vendimi mbi pranueshmërinë).
- 34. 2 Mars 1987.
- 35. 14 Tetor 1999.

të familjeve. Duke qënë se kjo e fundit nuk do të mund të kishte ndodhur pa bashkëpunimin aktiv të autoriteteve, u konstatua se Spanja kishte shkelur Nenin 5. Nuk duhet të tolerohet nga autoritetet publike asnjë veprim privat që çon në heqjen e lirisë së individit në kundërshtim me këtë dispozitë dhe këto autoritete sigurisht që nuk duhet të nxisin asnjëherë entet private që të bëjnë atë që nuk kanë duhet<sup>36</sup>.

## Veprimet e ndërmarra jashtë shtetit

Një Shtet Palë i Konventës Evropiane angazhohet në Nenin 1 të Konventës Evropiane që të sigurojë respektimin e të drejtave dhe lirive të çdokujt që ndodhet brenda juridiksionit të saj; dhe kjo do të thotë që kurdo që ndodhet në pozitën e ushtrimit të pushtetit të vet, panvarësisht nga fakti nëse kjo ndodh brenda kufijve të njohur në mënyrë ndërkombëtare ose të parashikuar nga kushtetuta dhe panvarësisht nga fakti nëse ka bazë ligjore për të vepruar.

Ashtu siç e bëri të qartë Gjykata Evropiane në *Loizidou kundër Turqisë*<sup>37</sup>, juridiksioni për qëllimet e Konventës nuk kufizohet në territorin kombëtar të një Shteti Palë dhe kështu lind përgjegjësia edhe aty ku veprimet dhe përjashtimet e autoriteteve të tij i japin efektet diku tjetër. Në veçanti, si në këtë çështje, kur u ndërmorrën veprime ushtarake nga një Shtet Palë në territorin e një Shteti tjetër, ushtrimi i kontrollit efektiv nga i pari në një zonë të caktuar do të ishte i mjaftueshëm për të

përcaktuar se ka juridiksion dhe si rrjedhim ka detyrim që të sigurojë respektimin e të drejtave dhe lirive të dhëna në Konventë.

Ky përfundim u përforcua në çështjen e *Qipros kundër Turqisë* – që lindi nga të njëjtat ngjarje – për shkak të faktit që operacionet ushtarake dhe pushtimi vijues ndaluan një Shtet Palë të Konventës që të përmbushte detyrimet e veta në bazë të këtij instrumenti në territorin në fjalë. Dështimi për të konsideruar ngjarjet si veprime që kishin ndodhur brenda juridiksionit të Turqisë rezultoi në një boshllëk në sistemin e të mbrojtjes së të drejtave të njeriut që i sigurohej personave që i përkisnin këtij vendi.

Ky këndvështrim kërkues por realist mbi juridiksionin nënkuptonte që kushtet e Nenit 5 duhet të përmbushen gjithnjë kur ndodh një heqje lirie. Kështu do të ishte i zbatueshëm kur zbatuesit e ligjit shkojnë në një shtet tjetër për të kthyer dikë ose që t'i nënshtrohet procesit gjyqësor, ose të kryejë dënimin. Kështu në *Reinette kundër Francës*<sup>38</sup> u konstatua i zbatueshëm Neni 5 kur një person i akuzuar iu dorëzua në Saint Vincent policisë frënge në bordin e një avioni ushtarak. Pas kësaj heqje e lirisë së kërkuesit, megjithëse ndodhi në Saint Vincent, u krye nga autoritetet frënge dhe si rrjedhim brenda juridiksionit të Francës për qëllimet e Neni 5.

Neni 5 është i zbatueshëm njësoj kur dikush kapet ose arrestohet në mënyrë të paligjshme, qoftë për të siguruar që t'i nënshtrohet procesit penal ose për të ribashkuar një fëmijë me një nga prindërit e vet ose për ndonjë arsye tjetër kurdo

36. Gjykata theksoi gjithashtu, në çështjen *Qipro kundër Turqisë*, 10 Maj 2001, se çdo mungesë e interesi ose mospërfillje nga organet e Shtetit Palë përsa i përket individëve privatë të cilët dhunojnë të drejtat e individëve të tjerë brenda juridiksionit të tyre do të mbajë përgjegjësitë përkatëse sipas Konventës. Në atë çështje, sidoqoftë, ankesat mbi një mungesë e interesi apo mospërfillje të tillë nuk qenë të konsiderueshme.
37. 18 Dhjetor 1996.
38. 63 DR 186(1989) (vendimi mbi pranueshmërinë).

që veprime të tillë kryhen nga nëpunësit e Shtetit ose në njëfarë mënyrë i atribuohen Shtetit Palë. Gjithashtu, siç u konstatua në çështjen e *Qipros kundër Turqisë* Neni 5 do të ishte i zbatueshëm për cilëndo heqje lirie që do të kryhej gjatë veprimtarive ushtarake në një shtet tjetër.

Arsye e vetme përse Gjykata nuk konstatoi shkelje të Nenit 5 si rezultat i operacioneve ushtarake kryer nga Turqia të cilat ishin kundërshtuar nga Qipro ishte se nuk u pretendua nga kjo e fundit që ishte ndaluar ndonjë kombës grek-qipriot gjatë periudhës që u mor në shqyrtim.



## Pjesa II: Privimi i lirisë si pjesë e procesit penal

### 1. Këndvështrimi i përgjithshëm

Neni 5 (1) njeh tre situata në të cilat duhet justifikuar heqja e lirisë si pjesë e procesit penal: ndalimin e një personi të dyshuar për përfshirje në kryerjen e një veprë penale (paragrafi c.); burgosjen e dikujt si dënim se ka kryer një veprë penale (paragrafi d.); dhe ndalimin e dikujt në vijim të kërkesës për ekstradimin e tij ose të saj në një shtet tjetër (paragrafi f.).

Megjithëse ajo që përbën një veprë penale i përket kryesisht të drejtës vendase<sup>39</sup>, ky është një koncept që është konstatuar se ka kuptim autonom për qëllimet e Konventës dhe është e kuptueshme që përdorimi i së drejtës penale në disa rrethana mund të shihet si disproporcionale dhe si rrjedhim arbitrare.

Sigurisht që burgosja si dënim shpesh përbën bazën për të konsideruar si të tepërt një ndërhyrje në një të drejtë a liri tjetër të Konventës<sup>40</sup> dhe rrethanat në të cilat është bërë ndalimi i një kriminelit të dyshuar mund të konsiderohet po kështu. Kështu nuk duhet marrë për bazë fakti që një veprë penale për të justifikuar një heqje lirie është domosdoshmërisht i pajtueshëm me kërkesat e Konventës, edhe pse kjo nuk ka të ngjarë që të krijojë probleme në shumicën e çështjeve.

Duhet vënë re gjithashtu se procesi penal për qëllimin e Konventës do të përfshijë ndonjë kundravajtje penale ushtarake të dallueshme ose ndonjë ndjekje penale<sup>41</sup> që rrjedhimisht duhet të jetë konform kërkesave të mëposhtme<sup>42</sup>. Siç është konstatuar tashmë, mund të neglizhohet fakti se një heqje lirie që mund t'i përkasë parimit brenda një prej motiveve të specifikuar në Nenin 5 nuk është arbitrare në lidhje me nevojën për të siguruar vënien e një mase të tillë.

### 2. Të dyshuarit si shkelës ligji

Teksti i Nenit 5 (1) bën të qartë se heqja e lirisë e një të dyshuari si shkelës ligji mund të bëhet si përpara ashtu edhe pas kryerjes së një veprë penale tek e cila mbështeten autoritetet për të justifikuar këtë masë. Megjithatë, siç u pa në *Lukanov kundër Bullgarisë* duhet të jetë kryer një veprë penale sipas ligjit vendas që duke u bazuar në këtë motiv të quhet legjitime heqja e lirisë së dikujt. Kjo nuk do të thotë se ka nevojë për të përcaktuar që një veprë penale është kryer faktikisht, por që marrja e masës që çon në heqjen e lirisë për këtë shkak duhet të deklarohet se i përket qëllimit të veprës penale që është parashikuar tashmë me ligj.

Në vijim të kësaj kërkesë thelbësore, ekzistojnë edhe dy kushte të tjera kyçe.

- I pari është se objektivi i ndalimit të të dyshuarit si shkelës ligji duhet të jetë që të çojë atë përpara një "autoriteti ligjor

39. Në rastin e ekstradimit kjo do të përfshijë ligjin e shtetit kërkuar.
40. Shih, për shembull, kuptimin e bashkangjitur mundësisë së burgimit në çështjen Hertel kundër Zvicrës, 25 Gusht 1998, dhe Sürek kundër Turqisë, 8 Korrik 1999, ku u konstatuan kufizime të veçanta për shkëljen e të drejtës së lirisë së shprehjes.
41. Shih De Jong, Baljet dhe Van Den Brink kundër Vendeve të Ulta, 22 Maj 1984, dhe Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar, 18 Shkurt 1999.
42. Në çështjen Engel dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulta, nuk ishte domethënëse fakti që ndjekjet penale u konsideruan "disiplinare" kur dënimi ishte i mjaftueshëm që ato të konsideroheshin si "penale" për qëllimet e Konventës. Sidoqoftë, ndryshueshmëria në ligjin vendas midis proceseve gjyqësore disiplinare dhe penale pa dyshim kontribuon në dështimin për t'u përputhur me të gjitha kërkesat e Nenit 5(1).



kompetent” dhe

- i dyti është që dyshimi mbi kryerjen e veprës penale duhet të jetë i “arsyeshëm”.

Gjithashtu, në vijim të këtyre kushteve ka edhe një nevojë për të siguruar që kohëzgjatja e përgjithshme e humbjes së lirisë përpara gjykimit për veprën penale të mos tejkalohet dhe që të merret në shqyrtim siç duhet mundësia e lirimit në pritje të gjykimit.

## Paraqitja përpara autoritetit ligjor kompetent

Megjithëse dyshimi i kryerjes së një veprë penale, nevoja për të parandaluar që një e tillë të ndodhë ose largimi i mundshëm i të dyshuarit përbëjnë bazat mbi të cilat mund të shqyrtohet heqja e lirisë së një individi, një masë e tillë do të jetë në pajtim me Nenin 5 (1) (c) vetëm nëse kryhet gjithashtu me objektin e nisjes së ndjekjes penale kundrejt tij ose saj. Kjo është rrjedhoja e një lidhjeje të përhershme të bërë në Konventë midis Nenit 5 (1) (c) dhe 5 (3); e para duke autorizuar heqjen e lirisë, por e fundit duke kërkuar që, kur ky motiv të përdoret për veprime të tilla, personi në fjalë duhet të paraqitet përpara një “gjyqtari ose zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar pushtet ligjor dhe do t’i jepet e drejta e zhvillimit të gjyqit brenda një kohe të arsyeshme ose të lirohet në pritje të gjykimit”. Gjyqtari ose ndonjë autoritet tjetër që i referohet Nenit 5 (3) bën qartësimin e termit “autoriteti

ligjor kompetent” që përdoret në Nenin 5 (1) (c) por që ka si qëllim prezantimin e një personi të tillë të jetë në një fazë të procesit që rezulton në gjyq duke shkaktuar mbajtjen e një procesi penal për objektin që i është hequr liria.

Kjo nuk nënkupton që duhet të zhvillohet domosdoshëmrish një ndjekje penale – qoftë seancë gjyqësore ose edhe hartimi i një akuze formale ose pretendimi – që vijon pas heqjes së lirisë për të qënë në përputhje me Nenin 5 (1) (c). Çështja thelbësore është qëllimin në kohën kur ka ndodhur heqja e lirisë, kështu që fakti nëse është në pajtim me sa më sipër përfundimisht nuk do të ketë rëndësi. Njohja nga Gjykata e faktit se e para është më e rëndësishme se e dyta reflekton një kuptim të faktorëve që mbështeten në ndjekjen penale; panvarësisht nga vërtetësia e dyshimit në kohën kur është marrë kjo masë, fillimi i procedimeve të tilla mund të jenë të panevojshme (p.sh. për shkak se disa prova kyçe nuk janë të disponueshme) ose i padëshirueshëm (p.sh. shëndeti i dobët i të akuzuarit që do të bënte seancën gjyqësore të padrejtë). Kështu si në çështjen *Brogan kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>43</sup>, ashtu edhe në *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* Gjykata refuzoi të nxirrte konkluzionin se kishte shkelje të Nenit 5 (1) (c) thjesht sepse personat që u ishte hequr liria ishin liruar pa u akuzuar ose pa u paraqitur përpara një autoriteti ligjor kompetent. Në këto çështje autoritetet kanë nxjerrë përfundimin se pasi janë marrë në pyetje personat e përfshirë, ishte e pamundur që të vazhdohej të dyshohej për ta dhe si rrjedhojë

43. 29 Nëntor 1989.

nuk mund të ngriheshin akuza kundër tyre në këto rrethana. Megjithatë ky rezultat nuk do të thoshte se objektivi i një ndjekjeje ligjore nuk bazohet edhe në dyshime pasi u njoh fakti se kjo mund të ishte për tu zbatuar pasi është marrë në pyetje personi që është privuar nga liria e tij ose e saj<sup>44</sup>.

Kështu nuk do të jetë e pranueshme për qëllimet e Nenit 5 (1) (c) që heqja e lirisë së një personi të mbështetet në një dispozitë të së drejtës penale nëse nuk ka asnjë qëllim që të vihet në zbatim një ligj i tillë kundrejt të dyshuarit përsa kohë që provohet se është masa e duhur<sup>45</sup>. Po kështu në *Giulia kundër Italisë*<sup>46</sup> ka pasur papajftueshmëri me Nenin 5 (1) (c) kur një personi iu hoq liria e tij dhe u paraqit përpara një gjyqtari kur baza ligjore për një veprim të tillë kishte më shumë një objekt sesa synimin për ta nisur ndjekjen penale kundër atij ose asaj. Në këtë çështje kërkuesi ishte kapur dhe paraqitur përpara një gjyqtari me qëllim që të merrej një urdhër për banim të detyrueshëm për shkak të sjelljes së tij mafioze. Nuk kishte dyshime se një sjellje e tillë do të mund të shkakonte një sërë veprash penale, por kërkesa dhe hartimi i urdhërit – dhe aktualisht arsyeja për të vendosur mbi procedurën – bazoheshin në një dyshim të pavërtetuar; urdhri u bazua në veprat e rënda penale të mëparshme të kryera nga kërkuesi dhe ngrinte më shumë shqetësimet për rrezikun në të ardhmen që mund t'i shkaktonte ai shoqërisë sesa përfshirjen e tij në vepra penale konkrete dhe specifike. Kështu heqja e lirisë së kërkuesit

ishte më shumë një procedurë parandaluese sesa diçka që mund të çonte atë në paraburgim në pritje të gjyqit; fakti që ai ishte paraqitur përpara një gjyqtari nuk ndryshonte faktin se masa nuk i përkiste procesit penal. Në *Giulia*, heqja e lirisë binte gjithashtu në kundërshtim me Nenin 5 (1) (c) sepse nuk u argumentua dot që heqja e lirisë për qëllimin e nxjerrjes së një urdhri për banesë të përkohshme të detyruar u bë bazuar në motifet që lejojnë një masë të tillë kur ajo “konsiderohet mjaft e e domosdoshme për të parandaluar që... [dikusht]...të kryejë një veprë penale”. Kjo ndodh sepse pranimi i një kompetence të tillë që lejon Nenin 5 (1) lidhet gjithashtu edhe me vënien në zbatim të së drejtës penale dhe përdorimi i saj duhet të drejtohet në parandalimin e kryerjes së veprave penale konkrete e specifike<sup>47</sup>. Një objektiv i tillë kërkon sigurisht një shkallë të veçantë trajtimi si përsa i përket faktit që të kryhet ndalimi i një personi me baza ligjore. Vendimi në *Giulia* përbën gjithashtu një pohim të mëtëjshëm se Nenin 5 (1) (c) mund të justifikojë një heqje lirie si masë parandaluese në bazë të Nenit 5 (1) (c) vetëm nëse ka si synim parandalimin e një veprë penale konkrete e specifike.

Gjykimi në *Giulia* u ndoq në *Jecius kundër Lituaniës* që kishte të bënte me një aplikant i cili dyshohej për vrasje, por çështja ishte mbyllur për shkak të mungesës së provave. Më pas ai ishte ndaluar në bazë të një dispozite në kodin e procedurës penale në lidhje me banditizmin, lidhjet kriminale të tij dhe terrorin e ushtruar ndaj një personi me masën e ndalimit parandalues.

44. Në këto çështje suksesi i një akuze do të varej gjerësisht mbi deklaratat e bëra nga të pandehurit dhe, duke qenë se ata kishin refuzuar t'i përgjigjeshin pyetjeve, nuk do të kishte kuptim akuza kundë tyre.
45. Përdorimi i një prokure ndalimi, ku nuk kishte qëllim të tillë, jo vetëm do të ishte jashtë kushteve të Nenit 5(1)(c), por gjithashtu do të ishte në kundërshtim me një masë më të përgjithshme ndalimi mbi aktet arbitrare.
46. 2 Shkurt 1989.
47. Kjo kërkesë është hartuar në mënyrë të tillë që sjellja që justifikon privimin e lirisë ka mundësi të jetë një përpjekje për të kryer veprën penale përkatëse, e cila në shumicën e juridiksioneve përbën në vetvete një veprë penale.

Duke vepruar në bazë të kësaj dispozite zëvendës prokurori i përgjithshëm urdhëroi ndalimin e tij për gjashtëdhjetë ditë dhe u hodh poshtë apeli kundër këtij urdhri nga gjykata. Nuk u ngrit ndonjë akuzë specifike kundër kërkuesit dhe nuk u krye ndonjë hetim në lidhje me këtë masë ndalimi. Një muaj pasi u dha urdhri për ndalimin e tij u rihap çështja e akuzën për vrasje ndaj tij dhe ajo u bë baza për ndalimin e tij aktual. Gjykata nuk hezitoi në konstatimin se ndalimi paraprak si masë parandaluese, duke qenë se nuk kishte lidhje me drejtimin e ndjekjes penale, përbënte shkelje të Nenit 5 (1). Megjithatë, Neni 5 (1) (c) nuk kërkon thjesht që objekti i heqjes së lirisë të jetë baza e ndjekjes penale, nëse është e zbatueshme. Kuadri ligjor gjithashtu duhet të jetë i tillë që paraqitja e një personi përpara një autoriteti ligjor kompetent, nëse nuk është liruar ende, është një pasojë e menjëhershme e masës së marrë. Funksion i autoritetit ligjor kompetent do të jetë që të përcaktojë nëse masa e paraburgimit duhet të vazhdohet dhe nëse po, për sa kohë. Në pjesët e tjera të këtij udhëzuesi do të merren në shqyrtim bazat për vazhdimin e një mase të tillë dhe kohëzgjatjen totale të saj. Megjithatë, është thelbësor që ky proces të jetë pjesë e pandarë e masave për të hequr lirinë e të dyshuarve si shkelës të ligjit. Mungesa e tyre përbëntë arsyen bazë për të konstatuar shkelje të Nenit 5 (1) në *Engel dhe të Tjerë kundër Vendeve të Ullta* ku karakterizimi i veprave penale të kryera nga ushtarët si disiplinore nënkuptonte që nuk kishte patur mbikqyrje nga ana e autoriteteve

ligjore kompetente për heqjen e lirisë së tyre. Si rrjedhojë heqja e lirisë nuk mund të justifikohet në bazë të autorizimit për të arrestuar të dyshuarit për shkelje ligji.

## Dyshimi i arsyeshëm

Stipulimi në Nenin 5 (1) (c) për nevojën për një dyshim të arsyeshëm që personi të cilit i është hequr liria ka kryer veprë penale është për të siguruar që kjo heqje lirie të ndodhë kur të ketë baza të forta dhe si rrjedhojë nuk është arbitrare. Gjykata vuri theksin në faktin se një dyshim duhet të deklarohej si i bazuar në *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* kur ndërshmëria dhe *bona fides* i dyshimit të jenë elementë të domosdoshëm të arsytimit të dyshimit – por që mund të konsiderohet si i arsyeshëm nëse bazohet gjithashtu në faktet ose informacionin që e lidhin në mënyrë objektive personin e dyshuar me krimin e supozuar. Kështu duhet të ekzistojnë provat e veprimit që përfshijnë në mënyrë të drejtpërdrejtë personin në fjalë ose dokumentet apo provat për efekte të ngjashme. Pra, nuk duhet të ndodhë heqje lirie bazuar në ndjenjat, instinktet, thjesht lidhja e bërë ose paragjykimin (qoftë etnike, fetare ose ndonjë tjetër) panvarësisht sesa të besueshme mund të konsiderohen ato si indikatorë të përfshirjes së dikujt në kryerjen e një veprë penale.

Kjo nuk nënkupton se prova duhet të jetë ose e mjaftueshme për të justifikuar një

dënim, ose të ketë prova për të bërë një akuzë; siç është parë tashmë u njoh në çështjen *Brogan kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* fakti se objekti i marrjes në pyetje në fazën e heqjes së lirisë që lejohet sipas Nenit 5 (1) (c) është thjesht për të vazhduar hetimin për një vepër penale të mundshme duke konfirmuar ose jo dyshimin që ekziston që nuk mund të jetë sigurisht përfundimtar në këtë fazë. Megjithatë, duhet të ketë baza për dyshimin mbi të cilin mbështetet çështja.

Fakti i thjeshtë se një person ka kryer ndonjë vepër penale – ose diçka të ngjashme – në të kaluarën nuk do të merret si bazë e mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm, ashtu si qartësoi Gjykata në çështjen e *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>48</sup>. Në këtë çështje kërkuesit kishin marrë dënime të mëparshme për akte terrorizmi, por, megjithëse Gjykata pranoi se kjo mund të përforconte dyshimin që lind si pasojë e akteve të mëparshme, doli se kjo përbënte të vetmen bazë mbi të cilën aplikantëve i ishte hequr liria. Është thelbësore që dyshimi të ketë lidhje me sjelljen aktuale të personit. Thjesht fakti se kishte informacione të besueshme por konfidenciale – siç u pretendua në çështjen *Fox* – nuk do të përbënte baza të mjaftueshme për të pranuar se ekzistonte një dyshim i arsyeshëm. Për gjykatën nuk është në dispozicion shqyrtimi i supozimit mbi ligjshmërinë e heqjes së lirisë.

Dyshimi i arsyeshëm u deklarua se ishte i bazuar në çështjen *K-F kundër Gjermanisë*, ku qeramarrës të caktuar ishin arrestuar pasi kishin

mashtuar në qeramarrjen e tyre, në vijim të pretendimit të pronares se tyre në polici se ata nuk kishin si qëllim që të përmbushinin detyrimet e tyre, ku adresa që ata kishin dhënë ishte thjesht një kuti postare dhe ku njëri prej tyre ishte hetuar më parë për mashtrim. Në *Puzelt kundër Republikës Çeke* Gjykata konstatoi një dyshim të arsyeshëm kur u mbështet në pamundësinë e shitësit të dy dyqaneve për të thyer dy çeqe të depozituar si garanci në negociatat sepse ato nuk ishin paguar.<sup>49</sup>

Në *Lukanov kundër Bullgarisë* Gjykata theksoi se nuk ishte dhënë asnjë fakt ose informacion për të treguar se kërkuesi kishte si qëllim të nxirrte përfitime nga përfshirja e tij në akordimin e fondeve publike vendeve të tjera; referimi i paqartë që iu bë disa “marrëveshjeve” kuptohej që u konsideruan nga Komisioni që nuk vërtetonin ekzistencën e këtij objektivi të papranueshëm. Megjithatë, problemi kryesor në *Lukanov* ishte se shumica e akuzave që ishin paraqitur kundër tij nuk përbënin ndonjë vepër penale sipas ligjit belg. Në këtë çështje mungesa e ndalimit penal ishte e qartë por Gjykata njohu faktin se mund të ketë raste kur ka paqartësi në lidhje me faktin nëse faktet e njohura mund të merreshin në shqyrtim duke u bazuar në një ndalim ose mënyrë sjelljeje të parashikuar nga e drejta penale.

Ka lindur nevoja që të vërtetohet jo vetëm lidhja midis personit që i është hequr liria dhe ngjarjeve të supozuara që përbëjnë vepër penale, por gjithashtu edhe sigurimi i një baze

48. 30 Gusht 1990.

49. 25 Prill 2000.

të majftueshme për të nxjerrë konkluzionin se këto akte i përkasin qëllimit të veprës penale të pretenduar. Kjo ndodh që bëhet problem me veprat e reja penale ose me ato të përdorura rrallë, por një interpretim i veçantë e i pazakontë për një ndalim të caktuar njësoj mund të rezultojë në përfundimin se dyshimi ishte i paarsyeshëm.

Megjithëse testi për dyshimin e arsyeshëm nuk stipulohet në lidhje me veprat penale të parashikuara, kërkesa e përbashkët se heqja e lirisë në këto baza duhet të ndodhë vetëm kur përfshihen vepra specifike dhe konkrete dhe kur një privim i tillë të “konsiderohet në mënyrë të arsyeshme i domosdoshëm” për qëllime parandalimi, do të nënkuptojë pa dyshim që duhet të vërtetohet e njëjta shkallë dyshimi për të shmangur një shkelje të Nenit 5 (1) (c). Kështu do të kishte prova objektive të mjaftueshme në lidhje me sjelljen e personit të dyshuar përsa i përket mundësisë së kryerjes së një vepre penale; nuk ka asnjë qëllim mbështetja në paragjykim apo frika të pabaza për atë që mund të ndodhë.

## Nevoja për mbajtje në paraburgim

Megjithëse nevoja për të nisur një proces penal kundër dikujt të dyshuar se ka kryer një vepër penale, ose nevoja për të parandaluar kryerjen e një vepre të tillë mund të japë justifikimin fillestar për t’i hequr lirinë personit të dyshuar, kjo nuk përbën një bazë të mjaftueshme për vazhdimin e mbajtjes në paraburgim pas

kësaj faze. Vazhdimi i paraburgimit duhet t’i nënshtrohet hetimit të menjëhershëm gjyqësor që jo vetëm duhet të shqyrtojë së pari nëse është një masë e justifikuar, por edhe nëse ende është e përshtatshme për t’u vazhduar. Pyetja e fundit nuk mund të marrë përgjigje thjesht pozitive sepse vazhdon të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm që personi i ndaluar ka kryer ose është përpjekur të kryejë një vepër penale. Gjykata deklaroi se dyshimi i arsyeshëm mund të zhduket menjëherë pas heqjes fillestare të lirisë sepse aty qartësohet që ose nuk është kryer ndonjë vepër penale, ose personi në fjalë është në gjendje të hedhë poshtë çdo dyshim përsa i përket përfshirjes së tij/saj. Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka deklaruar se ekzistenca e një dyshimi është thelbësore por jo e mjaftueshme për të zgjatur masën e ndalimit pas përfundimit të afatit kohor<sup>50</sup>. Kjo ndodh sepse ekziston një e drejtë e qartë për të liruar të dyshuarin në pritje të gjykimit në Nenin 5 (3) dhe kjo mund të mos ndodhë vetëm kur jepen një ose më shumë arsye të mjaftueshme e të duhura për të vazhduar masën e ndalimit panvarësisht nga prezumimi i lirisë.

Arsyet për zgjatjen e afatit të paraburgimit do të jenë të pranueshme vetëm kur ato do të jenë aktualisht të zbatueshme për rrethanat e personit të përfshirë. Kështu nuk mund të ekzistojë asnjëherë një rregull që përjashton personat që kanë kryer një vepër penale të vërtetuar ose që janë akuzuar për vepra të caktuara penale nga lirimi në pritje të gjykimit. Në *Caballero kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ku kërkuesi u arrestua

50. Stogmuller kundër Austrisë, 10 nëntor 1969, Clooth kundër Belgjikës, 12 dhjetor 1991, Contrada kundër Italisë, 24 gusht 1998, eFjush kundër Lituanië (ku dyshimi u konstatua se nuk u mor parasysh nga gjykata) dhe Barfuss kundër Republikës Ceke, 1 gusht 2000.

për tentativë për përdhunim, qeveria pranoi se kishte pasur shkelje të Nenit 5 (3) kur një gjykata refuzoi lirimin me kusht të kërkuesit sipas një ligji që ndalonte – pa përjashtime – që të gjithë personat që ishin akuzuar, ose dënuar për vrasje, njerivrasje dhe përdhunim të mos u jepej lirimi me kusht<sup>51</sup>. Një ligj i tillë ishte i kundërshtueshëm pasi ndalonte që gjykatat të merrnin në shqyrtim rrethanat specifike të dikujt që i ishte hequr liria. Duhet vërejtur se Gjykata ka konstatuar që zgjatja e masës së heqjes së lirisë ka qenë e pajustificuar edhe në çështjet e vrasjeve<sup>52</sup>.

Gjithashtu, mund të konstatohet se arsyet që si fillim dukeshin se justifikonin heqjen e lirisë së një personi do të bëhen më pak bindëse sa më shumë kohë të kalojë dhe është thelbësor fakti që kërkesat për lirim të shqyrtohen me mendjegjerësi. Kur arsye të tilla nuk ekzistojnë – si në fillim, ashtu edhe në një fazë të mëvonshme – por ekziston dyshimi i arsyeshëm në lidhje me kryerjen e veprës penale, personi i dyshuar duhet të lirohet me kusht por që t'i nënshtrohet garancive të hartuara për të siguruar që ai ose ajo të paraqiten në gjyq. Megjithatë, edhe nëse provohen arsyet e justifikimit të vazhdimin të privimit të lirisë të zbatueshme për një individ të caktuar, përsëri lind nevoja për të siguruar që ai ose ajo të paraqitet në gjyq brenda një kohë të arsyeshme dhe kjo domosdoshmërisht që përcakton edhe afatet për të gjithë periudhën në të cilën lejohet të vazhdojë kjo heqje lirie.

## Justifikimi i paraburgimit

Gjykata ka njohur katër arsye si të përshtatshme për të vazhduar masën e paraburgimit kur ende ekziston një dyshim i arsyeshëm që personi ka kryer një vepër penale<sup>53</sup>. Ato janë:

- risku i largimit;
- risku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë;
- nevoja për të ndaluar krimin;
- nevoja për të ruajtur rendin publik.

Është thelbësore që të mos bëhen përpjekje për të vënë në përdorim njërin nga këto arsye për të justifikuar vazhdimin e mbajtjes në paraburgim të një personi përveç kur janë parashtruar fakte të qarta e të dukshme<sup>54</sup> për vërtetësinë e zbatueshmërisë së tyre në situatat specifike të personave të dyshuar. Kur asnjëra nga këto nuk janë të zbatueshme lirimi i personit do të kërkohet në bazë të Nenit 5 (3).

## Risku i largimit

Risku i largimit pa dyshim që ka të bëjë me autoritetet e zbatimit të ligjit, veçanërisht nëse kapja e një personi të dyshuar nuk ka qenë e lehtë, dhe në rastet kur ka individë që sigurisht do të largohen sapo t'u jepet mundësia për një gjë të tillë. Megjithatë, nuk është e mjaftueshme që

51. 8 Shkurt 2000.
52. I.A. kundër Francës, 23 Shtator 1998; Letellier kundër Francës, 26 Qershor 1991.
53. Pika e fortë e çështjes kundër një individi mund të merret parasysh por nuk është në vetvete një bazë e mjaftueshme për vazhdimësinë e ndalimit; shih Kemmache kundër Francën (Nos.1 dhe 2), 27 Nëntor 1991, Mansur kundër Turqisë dhe Yağci dhe Sargin kundër Turqisë, 8 Qershor 1995.
54. Në çështjen Trzaska kundër Polonisë, 11 Korrik 2000, Gjykata refuzoi të pranonte që rreziku i kryerjes së veprave të tjera të jashtëligjshme varej nga refuzimi i lirimimit me kusht kur ky nuk i ishte referuar shprehimisht ndonjë vendimi të organeve vendase.



të mbështetemi në këtë mundësi të përgjithshme – duke përjashtuar mundësinë e mos patjes së ndonjë pengese për t’u larguar<sup>55</sup> – për të vazhduar masën e heqjes së lirisë; gjithnjë do të jetë thelbësore që të shqyrtohen të gjithë faktorët që janë specifike për çështjen specifike me qëllim që të përcaktohet nëse një risk i tillë vërtet ekziston. Këto faktorë që janë të parët për t’u marrë në shqyrtim sigurisht që do të jenë ata që mund të çojnë në largimin e një të dyshuari, panvarësisht nga pasojat që mund të vijnë dhe rreziqet që mund t’u duhet të kalojnë. Ato mjaft mirë mund të përfshijnë natyrën e dënimit që mund t’i vihet dikujt që është dënuar për veprën penale në fjalë por Gjykata vazhdimisht ka bërë të qartë se fakti që një dënim i rëndë mund të parashikohet, nuk përbën në vetvete një justifikim për të vazhduar masën e paraburgimit<sup>56</sup>. Gjithashtu, në *Mansur kundër Turqisë* Gjykata konstatoi se “gjendja e provave” nuk mund të vërtetojë riskun e pretenduar që kërkuesi do të mund të largohet<sup>57</sup>.

Rastet e mëparshme kur një person është larguar pasi është akuzuar për një veprë penale mund të jenë të përshtatshme për t’u marrë për bazë për të supozuar riskun e largimit; ose kur është kërkuar një masë ekstradimi me qëllim që të vazhdojë seanca gjyqësore në një vend të caktuar<sup>58</sup>; ose një mospëlqim i hapur për masën e paraburgimit<sup>59</sup>; apo prova specifike për plane për t’u arratisur<sup>60</sup>; lidhjet e tij ose të saj me një shtet tjetër që mund të lehtësojë planin e largimit ose mungesa e lidhjeve me shtetin ku ka nisur procesi gjyqësor<sup>61</sup>; ose probleme të tjera që mund

të lindin për personin në lidhje me një shtet të caktuar.

Megjithatë, përsa i përket formës së rëndë të dënimit, nuk është e mundur që të pretendohet ndonjë nga këta faktorë duke i vënë theksin riskut të largimit si justifikim në vetvete për të vazhduar masën e heqjes së lirisë së dikujt. Ka lindur nevoja për të vlerësuar sa i rëndësishëm është një faktori i tillë (ose kombinim faktorësh) në rrethana të caktuara të çështjes – kur në shqyrtimin e detajuar të tij disa kanë konstatuar se nuk ekziston, e të tjerë mund të verifikojnë atë dhe të tjerë mund të kundërshtohen nga sjellja aktuale e personit të dyshuar<sup>62</sup> dhe më pas të barazpeshohet kundrejt ndonjërit prej faktorëve ekzistues që mund të tregojnë se personi në fjalë ka mundësi që të arratiset. Duke qënë se risku zvogëlohet me kalimin e kohës, Gjykata do të jetë përkatësisht më e saktë në hetimin e saj sa më shumë zgjat masa e paraburgimit. Në *I.A. kundër Francës* Gjykata nuk u bind nga përciptësia e arsyetimit për riskun e arratisjes që supozohej se kishte vazhduar për më shumë se pesë vjet.

Dikush mund të nxitet që të qëndrojë ose të paktën duhet të konsiderohet si me më pas gjasa për t’u arratisur për shkak të gjendjes familjare<sup>63</sup>, karakterin e tij ose të saj të veçantë, moralin, statusin apo përgjegjësitë e tij<sup>64</sup>, sasinë e pasurisë që do të linte po të largohej, prova të mëparshme për besueshmëri kur është liruar<sup>65</sup> dhe masën e garancive të dhëna për të siguruar që ai ose ajo do të prezantohet në gjyq<sup>66</sup>. Është e nevojshme që të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i riskut

55. Shih Stögmüller kundër Austrisë, ku u konstatua se rreziku i arratisjes nuk vinte nga të qëniti i mundur apo i lehtë për individin kalimi i kufirit..
56. Shih Matznetter kundër Austrisë, 10 Nëntor 1969; Letellier kundër Francës, ë kundër Zvicrës, 26 Janar 1993, Yağci dhe Sargin kundër Turqisë dhe Muller kundër Francës, 17 Mars 1997.
57. 8 Qershor 1995.
58. Shih Punzelt kundër Republikës Çeke, 25 Prill 2000, ku aplikuesi u fsheh nga proceset penale përkatëse në RFJG.
59. Kjo u identifikua si domethënëse në çështjen Stögmüller kundër Austrisë, 10 Nëntor 1969.
60. Matznetter kundër Austrisë, 10 Nëntor 1969, në llogari të të cilit u bënë transferime fondesh jashtë shtetit dhe një vizitë jashtë vendit, bashkë me lidhjet që kishte vendosur atje. Shih gjithashtu Česká kundër Republikës Çeke, 6 Qershor 2000, ku aplikuesi i kishte besuar një shumë të madhe parash një të njohuri, kishte blerë një makinë duke përdorur kartën e identitetit të një personi tjetër dhe kishte blerë një pashaportë të rreme.
61. W kundër Zvicrës, 26 Janar 1993, ku aplikuesi ishte një burrë beqar i cili kishte transferuar rezidencën e tij në Monte Karlo dhe shpesh

herë vizitonte Anguilën – ku supozohet të ishte pronari i një banke – Mbretërinë e Bashkuar, RFCJ-në dhe Shtetet e Bashkuara, mesa duket kishte në përdorim fonde të konsiderueshme jashtë Zvicrës dhe kishte disa pashaporta të ndryshme; Punzelt kundër Republikës Çeke, ku aplikuesi kishte takime të shumta biznesi jashtë vendit; Barfuss kundër Republikës Çeke, 1 Gusht 2000, ku aplikuesi mund të kishte marrë qytetarinë Gjermane nëse ai do të ishte arratisur në Gjermani, gjë e cila do të bënte të pamundur ekstradimin mbrapsht në Republikën Çeke.

62. Në çështjen Stögmuller kundër Austrisë, 10 Nëntor 1969, ku aplikuesi (i cili zotëronte një liçencë piloti) kishte fluturuar jashtë vendit disa herë gjatë një periudhe lirimi me kusht dhe gjithmonë ishte kthyer; një vonesë e vogël në një rast të tillë u shpjegua bindshëm. Ngjashëm, në çështjen Letellier kundër Francës nuk u bënë përpjekje për të fshehur rastin kur aplikuesi ishte liruuar më parë për një periudhë katërjavore.
63. Shih Letellier kundër Francës, ku aplikuesi ishte nëna e një fëmije minorene.
64. Shih Letellier kundër Francës, ku aplikuesi ishte manaxheri i një biznesi duke përfaqësuar burimin e tij të vetëm të të ardhurave;

të largimit me marrjen në shqyrtim të të gjithë faktorëve përkatës, si pro edhe kundër largimit. Sigurisht që një vendim i bazuar në formën stereotipe të fjalëve pa ndonjë shpjegim se pse ekziston risku i largimit të personit të dyshuar nuk do të konsiderohet asnjëherë i prranueshëm nga Gjykata<sup>67</sup>.

Gjithashtu, nëse risku i largimit është i vetmi justifikim i ngritur për vazhdimin e masës së heqjes së lirisë, Gjykata ka theksuar se efekti i vendimit përfundimtar të Nenit 5 (3) është që

të kërkojë lirim të personit në fjalë nëse është e mundur që të përftohen garancitë nga ai ose ajo që do të siguronin paraqitjen e tij ose të saj në gjyq<sup>68</sup>.

Megjithatë, edhe nëse nuk përftohen garanci të tilla ose nuk konsiderohen të besueshme duhet të jepen mendime në të gjitha rastet më shumë mbi përshtatshmërinë e masave të tjera sesa mbi heqjen e lirisë për të siguruar që arratisja e personit të dyshuar të mos ndodhë: p.sh. kërkesat që një person i dyshuar të banojë në një vend të caktuar, të dorëzojnë dokumentet e tyre të udhëtimit, ose të bëjnë raportime të shpeshta në polici<sup>69</sup>.



## Risku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë

Risku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë është një shqetësim i ligjshëm për të gjithë njerëzit e përfshirë në ushtrimin e drejtësisë dhe nuk është i paditur fakti se megjithatë kjo është njohur si një arsye e mundshme për të vazhduar masën e heqjes së lirisë së dikujt. Një person i akuzuar shumë mirë mund të shfrytëzojë mundësinë e lirimit të tij ose saj për të dëmtuar përgatitjen e çështjes kundër tij ose saj duke i bërë presion dëshmitarëve për të mos dëshmuar<sup>70</sup>, duke paralajmëruar të tjerë që gjithashtu mund të jenë nën hetim, duke bërë plane me cilindo të përfshirë në çështje për mënyrën sesi duhet të përgjigjen në procesin penal<sup>71</sup> dhe madje edhe duke shkatërruar dokumentet dhe format e tjera materiale të provave<sup>72</sup> ose në disa raste të tjera duke sjellë pengesa në fazën e hetimit<sup>73</sup>.

Megjithatë, mundësitë nuk duhet të bazohen *in abstracto*; duhet të ekzistojnë edhe rrethana faktike konkrete që të mbështesin ato në lidhje me personin që i është hequr liria<sup>74</sup>. Gjithashtu, në shumicën e çështjeve kjo përbën bazën për të vazhduar masën e heqjes së lirisë që do të bëhen gjithmonë e më pak të detyrueshme me përfundimin e fazave të ndryshme të hetimit – si për shembull marrja e deklaratave dhe kryerja e verifikimeve përkatëse, dhe nuk do të konsiderohet si një justifikim i pranueshëm me përfundimin e të gjithë procesit<sup>75</sup>.

Matznetter kundër Austrisë, ku nuk u besua në sëmundjen e rëndë të aplikuesit që në një rast tjetër mund të bëhej një arsye për të dyshuar në aftësinë e dikujt për tu arratisur, dhe; Yağci dhe Sargin kundër Francës, ku aplikuesit u kthyen në vendin e tyre me dëshirën e tyre edhe pse ata u paralajmëruan mbi rrezikun e ndjekjes penale.

65. Shih W kundër Zvicrës.
66. Në çështjen Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë, aplikuesi kishte dhënë vazhdimisht përshtypjen se ai nuk ishte i përgatitur për të ofruar garanci për një shumë të madhe për të siguruar lirimin por në çështjen Letellier kundër Francës, gjykatat kombëtare kishin dështuar të përcaktonin nëse garancitë e mjaftueshme nuk ishin të disponueshme. Përveç kësaj në çështjen Stögmüller kundër Austrisë, Gjykata vuri re se aplikanti, megjithëse ishte liruar me kusht, kishte ofruar që në fillim të siguronte garancitë shumë përpara se një gjë e tillë të vendosej.
67. Shih Yağci dhe Sargin kundër Turqisë.
68. Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë, 27 Qershor 1968.
69. Në çështjen Stögmüller kundër Austrisë Gjykata konstatoi se për të parandaluar kalimin e kufirit nga ana e

- aplikuesit, mund t'i kërkohej të dorëzonte pashaportën.
70. Në çështjen Letellier kundër Francës u pranua se kishte ekzistuar rrezik i vërtet presioni duke sjellë dëshmitarët për të dëshmuar qysh në fillim të pregatitjes të akuzës, por rreziku me kalimin e kohës ishte paksaur deri sa ishte zhdukur tërësisht. Dështimi i gjitha gjykatave franceze në lidhje me këtë rrezik, pas refuzimeve fillestare për lirinë e aplikuesit, kishte dobësuar qartasi çdo motivim që mund të lidhet me privimin e lirisë. Rreziku i presionit mbi dëshmitarët u konsiderua gjithashtu ekzistues në çështjen I.A kundër Francës, por vetëm në fazat fillestare të hetimit.
  71. Në çështjen W kundër Zvicrës u konstatua se ekzistonte rreziku që aplikuesi do të mund të influenconte punëtorët e tij për të sjellë prova të rreme ose të komplotonte me dëshmitarët.
  72. Shqetësimi i gjykatave përsa i përket zhdukjes së provave u konsiderua i justifikuar në çështjen Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë, për shkak të llojit të veprave penale (shkelje e besimit të përveçësimit i fondeve të marra prej një banke) dhe të ndërlikimit të çështjes. Sidoqoftë, Gjykata vërejtë se edhe Gjykata vendase e Apelit kishte dyshuar nëse ky rrezik kishte marrë fund dhe fakti nëse është i paparashikueshëm fakti se ky shqetësim do të mbetet i domosdoshëm sa më afër përfundimit të pregatitjes së çështjes hetimore.
  73. Shih Clooth kundër Belgjikës, ku Gjykata konstatoi se fillimisht aplikuesi kishte ndërlikuar hetimet duke ndryshuar natyrën e deklaratave por gjykata nënvizoi se në përgjithësi nevojat e hetimit mund të mos justifikojnë vazhdimësinë e ndalimit. Ku është dëshmuar që masat specifike hetimore janë kërçënuar, vazhdimësia e ndalimit pas përbushjes së tyre nuk do të ishte e përshtatshme; dështimi në bërjen e kësaj në çështjen Clooth ishte domethënëse në konstatimin e një shkeljeje të Nenit 5(3).
  74. Në çështjen Trzaska kundër Polonisë nuk u konstatuan rrethana të tilla të cilave t'u besohet.
  75. Shih Muller kundër Francës, ku për hetimin dhe zotimin e aplikuesit për të nisur procesin gjyqësor u desh pothuaj një vit përpara dënimit; dhe I.A kundër Francës, ku mundësia që aplikuesi të kishte vepruar i vetëm në vrasjen e graus së tij ishte parë si e arsyeshme fillimisht, por kjo dështoi kur u duk që provat nuk përkrahën hipotezën dhe kështu rreziku i bashkëfajësisë në kryerjen e veprës penale nuk ekzistonte më.
  76. Një rrezik i qëndrueshëm bashkëfajësie pas procesit gjyqësor u konsiderua ekzistues në çështjen W kundër Zvicrës për shkak të shtrirjes së jashtëzakonshme të çështjes (një mashtrim që përfshinte administrimin e gjashtëdhjetë shoqërive), sasisë së jashtëzakonshme të përmasave të dokumentave dhe gjendja e tyre qëllimisht e parregullt, numri i madh i dëshmitarëve për t'u marrë në pyetje (disa jashtë shtetit), sjelljes së aplikueses, e cila përpara dhe pas lirimit reflektonte një synim në zhdukjen sistematike të provave të borxhit (p.sh. duke fallifikuar ose duke zhdukur llogaritë), dhe frikës së mos do të mund të zhdukte pjesë nga provat ende të fshehta, do të sillte prova të rreme dhe do të komplotonte me dëshmitarët gjatë shtrirjes së hetimit mbi veprën penale në Gjermani. Ishte padyshim domethënëse për sa i përket kësaj fakti se dosja e çështjes tregonte se në procese të tjera gjyqësore aplikuesja kishte sjellë prova shfaqësie, kishte paraprirë dokumentat dhe kishte manipuluar dëshmitarët. Sidoqoftë duhet përmendur se ky nuk ishte arsyeimi i vetëm për të vazhduar privimin e lirisë gjithashtu ekzistonte rreziku i arratisjes së aplikueses; Zvicra ishte bazuar gjithashtu në kërkesën për të parandaluar kryerjen e veprave të tjera penale, por kjo nuk ishte marrë në shqyrtim nga gjykatat e apelit, dhe ashtu si rreziku i bashkëfajësisë, edhe ai i arratisjes u konsideruan si arsyeime të masës së ndalimit dhe Gjykata ndau të njëjtën pikëpamje.
  77. Ashtu si në çështjen Assenov kundër Bullgarisë.
  78. Clooth kundër Belgjikës, ku në një çështje me akuzën vrasje dhe zjarrvënje me qëllim, aplikuesi kishte dënime të mëparshme për tentativë për vjedhje të paramenduar dhe dezertim; Muller kundër Francës, ku paraardhës të pidentifikuar u thirrën përsa i përket çështjes së një aplikuesi i cili ishte akuzuar për disa grabitje të armatosura.

Megjithatë, Gjykata gjithmonë do të bëjë vlerësimin përkatës duke iu referuar fakteve të çështjes specifike që me raste do të jenë përjashtuese për të justifikuar heqjen e lirisë së një personi që është nën proces gjyqësor<sup>76</sup>.

## Nevoja për parandalimin e krimit

Nevoja për të parandaluar krimin është njohur si bazë legjitime për të vazhduar heqjen e lirisë së një individi kur kemi të bëjmë me një akuzë të rëndë, por duhet të vërtetohet që çdo shqetësim për kryerjen në të ardhmen të veprave të tjera penale do të jetë i besueshëm në mënyrë që masa në çështjen specifike të jetë e përshtatshme. Në bërjen e vlerësimit të këtyre rasteve duhen marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e çështjes veçanërisht historiku i jetës në të kaluarën dhe personaliteti i personit të përfshirë. Fakti që personi i përfshirë ka pasur dënime të mëparshme për të njëjtat vepra penale ose të ngjashme me atë që është nën shqyrtim do të ishte i rëndësishëm përsa i përket veprave penale që duket se janë kryer midis fillimit të hetimeve dhe personit të akuazuar me qëllim ndalimin e tij<sup>77</sup>. Megjithatë vazhdimi i paraburgimit të personit në raste të tilla mund të jetë jo i duhuri kur veprat penale në fjalë nuk mund të krahasoheshin me ato të mëparshmet as nga natyra, as nga shkalla e rëndësisë së tyre<sup>78</sup>. Gjithashtu, syjerimet se janë kryer vepra të tjera penale gjatë kohës së liritimit të përkohshëm të të

akuzuarit – që mund të ngrenë pretendimin për të justifikuar vazhdimin e masës së paraburgimit – sigurisht që do të nevojiten të verifikohen<sup>79</sup> dhe mund të bëhet bindës argumenti që vështirësitë ekonomike do të përbënin një nxitje për të kryer vepra të tjera penale<sup>80</sup>. Gjithashtu do të ishte me vend që të bëhej një vlerësim psikologjik i kërkuesit por duhet patur parasysh që kjo mund të nxjerrë konkluzionin se është i rëndësishëm kujdesi terapeutik për kërkuesin dhe si rrjedhim do të ishte i pëpërshtatshëm vazhdimi i mbajtjes së tij në paraburgim<sup>81</sup>. Përveç kësaj nuk do të ishte e përshatshme që të kërkohet justifikimi për vazhdimin e mbajtjes në paraburgim duke iu referuar frikës së përsëritjes së një veprë penale që vetë nga natyra e saj përbën një ngjarje unike<sup>82</sup>.

## Nevoja për të ruajtur rendin publik

Nevoja për të ruajtur rendin publik, duke përfshirë edhe çështjen e mbrojtjes së një personi të akuzuar, u njoh në *Letellier kundër Francës* si fakt që mund të përbëjë bazën për vazhdimin e masës së heqjes së lirisë. Megjithatë, Gjykata theksoi se i ishte referuar rrethanave përjashtuese, përkatësisht, që do të ishin të zbatueshme kur të vërtetohej fakti se lirimi i personit më të vërtetë përbënte shqetësim për rendin publik në atë periudhë kohore të caktuar. Kështu nuk mund të konsiderohej si mënyrë për të paraprirë një vendim dënimi që është me të vërtetë mënyra tjetër për të marrë në konsideratë rëndësinë e

vendimit. Ajo nuk mund të mbështetet as thjesht për shkak të natyrës së veprës penale në fjalë<sup>83</sup>.

Megjithëse mundësia e reagimit ndaj një krimi të rëndë si për shembull vrasja – qoftë nga ana e të afërmeve të viktimës apo publikut në përgjithësi – mund të jetë e mjaftueshme për të justifikuar frikën e përsëritjes së veprave të tilla të ngjashme, Gjykata deklaroi në *Letellier* se nuk ishte cituar asnjë manifestim konkret mbi shenja të prishjes së rendit dhe në fakt e ëma dhe motra e të ndjerit nuk kishin kundërshtuar masën e lirimit të tij. Çështja për shqetësimin në lidhje me hakmarrjen nga ana e të afërmeve të viktimës së vvarë nuk ishte me vend të *I.A. kundër Francës* sepse ato ishin të paqarta por edhe të pabaza duke pasur parasysh faktin se shumica e tyre jetonin në Liban. Gjithashtu, Gjykata theksoi kjo bazë do të mund të pretendohet përsa kohë që rendi publik do të vazhdonte të ishte i kërcënuar nga vepra të tilla. Ka shumë mundësi që ndërmarrrja e akteve hakmarrëse nga ana e publikut do të minimizohet ose nuk do të ndodhë kur të jetë zbutur tronditja në fillim për një krim të kryer.

## Kushtet për pagesën e lirimimit më kusht

Neni 5 (3) garanton të drejtën për pagesën për lirimimin me kusht dhe përmban një prezumim të fortë në favor të lirimimit me kusht në pritje të gjykimimit. Prezumimi bëhet edhe më i fortë nëse gjyqi shtyhet. Refuzimi i lirimimit me kusht

79. Në çështjen *Stögmüller kundër Austrisë* Gjykata theksoi se vetëm disa nga ankesat e cituara si arsye time kishin çuar në një proces gjyqësor.
80. Kjo ishte e veçantë, kështu që në çështjen *Stögmüller kundër Austrisë*, ku aplikuesi kishte ndryshuar vëndin e tij të punës nga hua-dhënës, me aktivitetin e së cilës kishte lidhje procesi gjyqësor, në pilot.
81. Në çështjen *Clooth kundër Belgjikës* mjekët psikiatër raportuan se aplikuesi nevojitej të mbahej në kujdes me kohë të gjatë sepse ai vuante nga shqetësime serioze mendore të cilat bënin të pamundur që ai të kontrollonte veprimet e tij.
82. Shih çështjen *I.A. kundër Francës*, e cila kishte të bënte me vrasjen e supozuar të gruas së aplikuesit. Në këtë çështje nuk kishte gjithësi prova të shqetësimit të aplikuesit.
83. Shih në çështjen *I.A. kundër Francës*, ku Gjykata nuk ishte e bindur në lidhje me vendimet e gjykatës vendase përsa i përket natyrës së krimimit (vrasja e gruas së aplikuesit) ose rrethanat në të cilat u krye ky krim.

gjithashtu mund të justifikohet në bazë të katër arsyeve të identifikuar nga Gjykata – rreziku i largimit, ndërhyrja me procesin e drejtësisë, parandalimi i krimit dhe ruajtja e rendit publik – sipas rrethanave të diskutuara në paragrafet e mësipërme.

Duke qënë se pagesa për lirimin me kusht është bërë për të siguruar prezencën e të akuzuarit në seancë, shuma përkatëse duhet t'i korrespondojë edhe synimit për vënien e pagesës. Në *Neumeister kundër Austrisë*<sup>84</sup>, ku autoritetet vendase llogaritën shumën për pagesën e lirimit me kusht vetëm duke iu referuar dëmit për të cilën akuzohej kërkuesi, Gjykata konstatoi se ajo binte në kundërshtim me Nenin 5 (3) duke deklaruar se garantimi i lirimit me kusht duhet të sigurojë prezencën e personit të akuzuar në seancë dhe jo riparimin e dëmit të shkaktuar nga i akuzuari. Garantimi kërkon që kushtet e lirimit të mos rëndojnë kërkuesin për një masë të arsyeshme sigurie. Natyra dhe shkalla e masës së sigurisë të hartuara për të siguruar që i akuzuari të ndjekë procesin gjyqësor duhet të kenë lidhje dhe të vijojnë në bazë të justifikimit të dhënë për marrjen e masës së paraburgimit. Ndërsa në këtë kuadër duhet të përcaktohen garancitë financiare<sup>85</sup>, shuma duhet të llogaritet duke marrë parasysh statusin e të akuzuarit, pasurisë së tij ose të saj dhe marrëdhënies me personin që ka marrë përgjegjësinë e sigurimit të tij. I akuzuari duhet të vërë në dispozicion informacion në lidhje me pasuritë e tij ose të saj kurse autoritetet vendase kanë detyrën që të bëjnë një vlerësim

të kujdesshëm të informacionit për një sigurim të saktë në lidhje me llogaritjen e shumës që duhet paguar. Përcaktimi i shumës që është mëse e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin e sigurimit të një “kufizimi të mjaftueshëm për të shmangur ndonjë dëshirë nga ana e të akuzuarit për arratisje” do të shkelte të drejtën për lirim me kusht<sup>86</sup>. Garancitë, përveç atyre monetare, si për shembull dorëzimi i pashaportës, mund të kërkohen për të njëjtin qëllim për të siguruar prezencën e të akuzuarit në gjyq<sup>87</sup>.

Disa rrethana specifike që justifikojnë një rrezikshmëri të lartë të arratisjes gjithsesi mund të bëjnë të pamjaftueshëm lirimin me kusht. Në *Punzelt kundër Republikës Çeke*, gjykatat vendase refuzuan lirimin e kërkuesit me pagesë (ai kishte ofruar të paguante 15 000 000 CZK) dhe në një rast shprehën gadishmërinë për të marrë në konsideratë lirimin e kërkuesit për shkak të problemeve të tij shëndetësore nëse ai do të paguante lirimin me kusht për një shumë prej 30.000 000 CZK. Gjykata Evropiane vërejtë si duke pasur parasysh shkallën e transaksioneve të kërkuesit (ai kishte lëshuar dy çeqe të pambuluara që çonin në shumën prej 28 400 000 CZK; përpara arrestimit të tij ai kishte pasur si qëllim të blinte dy dyqane për 338 856 000 CZK dhe ishte angazhuar për ti paguar ato me këste prej 150 000 000 CZK), refuzimi i pagesës për lirimin me kusht dhe vënia e një interesi më të lartë seç mund të mbulonte ai nuk përbënin shkelje të Nenin 5 (3)<sup>88</sup>.

84. 27 Qershor 1968.

85. Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë.

86. Neumeister kundër Austrisë.

87. Stögmüller kundër Ausrisë.

88. 25 Prill 2000; Gjykata theksoi gjithashtu se aplikuesi nuk do të ndalohej përsëri për shkak të procedurës së ekstradimit

## Kohëzgjatja e ndalimit para gjykimit

Neni 5 (3) kërkon që heqja e lirisë në pritje të gjykimit të mos kalojë asnjëherë afatin e arsyeshëm kohor. Gjykata Evropiane është shprehur vazhdimisht se

*Vazhdimësia e ndalimit mund të justifikohet në një çështje të caktuar vetëm kur ka indikatorë të qartë se ekziston një interes i vërtetë publik i cili, panvarësisht nga prezumimi i pafajsisë, vlen më shumë se e drejta për lirinë e personit<sup>89</sup>.*

Gjithashtu, Gjykata argumentoi se vazhdimësia e mbajtjes së një dyshimi të arsyeshëm që një person i arrestuar ka kryer një vepër të jashtëligjshme është kusht *sine qua non* për ligjshmërinë e vazhdimësisë së ndalimit, por kalimit të një periudhe kohore të caktuar, nuk është më e mjaftueshme. Gjykata më tej duhet të përcaktojë nëse motivet e tjera të dhëna nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë heqjen e lirisë. Kur ekzistojnë motive të tilla dhe kur ato janë “të rëndësishme dhe të mjaftueshme” Gjykata vijon me ndërmarritjen e hapave të tjerë si sigurimi që autoritetet kompentente kanë treguar kujdes në drejtimin e procesit gjyqësor<sup>90</sup>.

Periudha e ndalimit që parashikohet nga Gjykata nis nga momenti i arrestimit deri në momentin kur personi lirohet. Nëse personi nuk lirohet gjatë procesit gjyqësor, periudha në fjalë përfundon kur gjykata e shkallës së parë nxjerr një vendim (për lirim ose dënim). Periudha e ndalimit pas dënimit të dhënë nga gjykata – për

shembull gjatë seancës së apelit – nuk merret në konsideratë. Gjykata është shprehur se Neni 5 (3) pushon së zbatuari masën e ndalimit pas dënimit të dhënë nga gjykata që duhet të bazohet në Nenin 5 (1)<sup>91</sup>. Megjithatë, nëse një gjykatë apeli anulon gjykimin e parë dhe urdhërohet mbajtja e një gjyqi të ri, ndalimi gjatë periudhës midis anulimit të vendimit dhe gjykimit të ri merret gjithashtu në konsideratë<sup>92</sup>. Kjo nuk nënkupton se periudha e vendimit të dhënë derisa u anulua vendimi i parë do të konsiderohet si ndalim para gjykimit për qëllimet e Nenit 5 (3)<sup>93</sup>.

Duhet vërejtur gjithashtu se Gjykata ka kompetencë për të marrë në shqyrtim vetëm periudhat e ndalimit pas ratifikimit të Konventës Evropiane nga Shteti i akuzuar, megjithëse do të konsiderojë shtrirjen e një heqjeje lirie përpara këtij momenti duke vlerësuar nëse ajo që vijon është e arsyeshme apo jo<sup>94</sup>.

Duke përcaktuar se çfarë përbën termin e “arsyeshme”, Gjykata asnjëherë nuk ka pranuar idenë se ekziston një kohëzgjatje maksimale e ndalimit para gjykimit që asnjëherë nuk duhet tejkaluar pasi kjo do të përfshinte vlerësimin *in abstracto*, dhe gjykimi gjithnjë duhet të ketë parasysh të gjitha tiparet specifike të çdo çështjeje<sup>95</sup>. Panvarësisht nga sa zgjat, çdo periudhë ndalimi duhet të justifikohet. Jurisprudenca e Gjykatës ka vërtetuar rëndësinë e rrethanave specifike të një çështjeje.

89. Shih përveç të tjerave çështjen Punzelt kundër Republikës Çeke.
90. Shih çështjen kundër Zvicrës, Assenov kundër Bullgarisë dhe Punzelt kundër Republikës Çeke.
91. B kundër Austrisë, 28 Mars 1990.
92. Punzelt kundër Republikës Çeke.
93. I.A. kundër Francës.
94. Mansur kundër Turqisë, Trzaska kundër Polonisë, ~ëfJush kundër Lituaniës dhe Kudla kundër Polonisë.
95. Stogmuller kundër Austrisë, W kundër Zvicrës, Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë. Është e vlefshme të mbahen mend përgjithësimet e përtuara prej studimeve krahasuese të cilat u cituan nga Gjykatësi Pettiti në kundërshtimin e tij në çështjen W kundër Zvicrës. Këto ishin përgjithësisht më pak se dy ose tre muaj dhe më pak se një vit për sa i përket kundravajtjeve ekonomike dhe falimentimeve. Ndoshta këto shifra nuk janë të përpikta për Këshillin e Evropës, por megjithatë ato mund të jenë një pikënisje për të gjykuar nëse ekzistojnë faktorë në një çështje të cilët bëjnë të pakundërshtueshme një periudhë shumë të gjatë ndalimi para gjykimit. Përveç kësaj, ashtu si garancia e një afati të arsyeshëm, Neni 5(3) aplikohet vetëm për individët që privohen nga liria e tyre

dhe është e rëndësishme të mbahen mend ato rregulla të Gjykatës përsa i përket afatit të arsyeshëm të proceseve penale nën Nenin 6(1) - i cili i aplikohet të gjitha proceseve gjyqësore - të cilat nuk duhet të merren si një udhëzues për çka është e pranueshme përderisa aplikuesit nuk do të mbaheshin nën arrest përgjithmonë dhe kështu do të rezultonte në shtyrje të procesit për shkak të vonesave. Në çështjen I.A. kundër Francës dhe B. kundër Austrisë, Gjykata konstatoi një shkelje të Nenit 5(3) por jo të Nenit 6(1).

96. ~ëfjush kundër Litanisë (14 muaj dhe 26 ditë).
97. Letellier kundër Francës (2 vjet dhe 9 muaj); Punzelt kundër Republikës Çeke (2 vjet dhe 6 muaj), Stogmuller kundër Austrisë (2 vjet dhe 1 ditë), Kudla kundër Polonisë (2 vjet, 4 muaj dhe 3 ditë).
98. Një periudhë e tillë u konstatua e pranueshme në çështjen W kundër Zvicrës (4 vjet dhe 3 ditë), por u kundërshtua në çështjen Clooth kundër Belgjikës (3 vjet, 2 muaj dhe 4 ditë), Muller kundër Francës (3vjet, 11 muaj dhe 27 ditë), Çeszk kundër Republikës Çeke (3 vjet, 3 muaj dhe 7 ditë), Trzaska kundër Polonisë (3 vjet, 6 muaj), Barfuss kundër Republikës Çeke (3 vjet, 5 muaj dhe 19 ditë).
99. Birou kundër Francës, 27 Shkurt 1992 (5 vjet, 2 muaj dhe 27 ditë) (një marrëveshje miqësore); I.A. kundër Francës (5 vjet, 3 muaj), (në këtë çështje arsyetimet kishin pushuar së vepruari shumë para përfundimit të kësaj periudhe).
100. Kjo do të ishte e vërtetë për veprat penale që përfshijnë mashtrimin, por kjo do t'i aplikohet vetëm atyre që do të sillnin një vëllim të gjerë dokumentacioni dhe shumë dëshmitarë. Për shembull, W kundër Zvicrës, 26 Janar 1993 (një mashtrim që përfshinte administrimin e gjashhtëdhjet shoqërive).
101. Edhe pse kjo kërkohet në të gjitha çështjet, Gjykata e konsideroi si të një rëndësie të veçantë çështjen Assenov kundër Bullgarisë, 28 Tetor 1998, ku përfshihej një i mitur.
102. Assenov kundër Bullgarisë, ku për një vit nuk kishte pothuaj plotësisht asnjë aktivitet; Punzelt kundër Republikës Çeke, ku trupi gjyqësor mori vendimin e dytë vetëm pas dhjetë muajsh nga anulimi i vendimit të parë; Barfuss kundër Republikës Çeke, në të cilën nuk kishte shpjegim tjetër - veç atij që çështja ishte e ndërlikuar - për një periudhë prej 11- muajsh nga ndalimi tek akuza, bashkë me një periudhë prej 8- muajsh shtyrje nga anulimi i vendimit i cili urdhëronte hetime të mëtejshme tek dëgjimi i parë i çështjes.
103. Përgjithësisht dështimi për të paraqitur një raport brenda përfundimit të afatit të caktuar; shih çështjen Clooth kundër Belgjikës.
104. Assenov kundër Bullgarisë, ku Gjykata konstatoi se koha ishte harxhuar në mënyrë të panevojshme si rezultat i pezullimit të hetimeve çdo herë që aplikuesi paraqitej në apel për lirim për shkak të praktikës së të çuarit të dosjes originale në vend të një kopjeje të saj organeve përkatëse.

Ndërsa periudhat me zgjatjen prej një viti konsiderohen si të tepërta<sup>96</sup>, periudhat midis dy ose tre viteve janë konsideruar si të pranueshme, ashtu edhe të kundërshtueshme<sup>97</sup>. Një ndryshim i tillë i ngjashëm në këtë pikëpamje mund të shihet edhe në periudha midis tre dhe katër viteve<sup>98</sup>. Periudhat mbi pesë vjet nuk konsiderohen si të justifikueshme<sup>99</sup>.

Një ligj vendas që parashikon një periudhë maksimale prej tre vjetësh për ndalimin në pritje të gjykimit nuk do të krijonte probleme për pajtueshmëri me Konventën. Megjithatë, do të ishte pa dyshim gabim që të udhëhiqemi nga një afat i tillë pasi rrethanat specifike të një çështjeje përcaktojnë faktin nëse është tejkaluar apo jo afati kohor në fjalë.

Çështjet në të cilat periudhat më të gjata të ndalimit janë konstatuar si të kundërshtueshme kanë qënë ato në të cilat ka pasur vështirësi të shkaktuara nga kompleksiteti i çështjes si rezultat i natyrës së veprës së jashtëligjshme<sup>100</sup> dhe/ose i numrit të të dyshuarve të mundshëm të përfshirë ose të sjelljes së personit të akuzuar. Megjithatë, faktorët që e bëjnë një çështje veçanërisht komplekse mund të justifikojnë zgjatjen e heqjes së lirisë vetëm kur autoritetet përkatëse kanë dhënë prova të “kujdesit të veçantë” në trajtimin e procesit gjyqësor<sup>101</sup>. Shumë shkelje të Nenit 5 (3) ndodhin si rezultat i periudhave të gjata të pasivitetit në trajtimin e një çështjeje përpara mbajtjes së procesit gjyqësor<sup>102</sup> ose i vonesave të shkaktuara nga ekspertët<sup>103</sup>, mjetet e papërshtatshme ose praktikata e punës<sup>104</sup>,



vështirësitë me personelin<sup>105</sup> dhe problemet që lindin nga nevoja për të mbrojtur identitetin e një dëshmitari<sup>106</sup>.

Shkeljet e Nenit 5 (3) patjetër që do të konstatohen në çështjet kur gjykatat e zgjasin ndalimin para gjykimit për periudha të gjata kohore sipas argumentit të rëndësës së dënimit duke e përballur atë me mosmarrjen në konsideratë absolutisht të fakteve të rëndësishme si: fakti që personi i arrestuar ka një familje dhe një mënyrë të qëndrueshme jetese dhe kur është tërhequr pas kalimit të kohës së caktuar çdo rrezik i mundshëm për komplicitet dhe arratisje. Kjo ndodhi në çështjen *Ilijkov kundër Bullgarisë* ku kërkuesi kaloi tre vjet e katër muaj nën masën e ndalimit në pritje të gjykimit<sup>107</sup>. Gjithashtu, në këtë rast, Gjykata deklaroi se konstatimet vendase – se nuk ekzistonin rrethana përjashtuese për të garantuar lirin e kërkuesit – ishin të papranueshme dhe iu kalonin barrën e provës të ndaluarit. Detyrimi për të vërtetuar bazat për zgjatjen e masës së ndalimit në pritje të gjykimit i takon autoriteteve dhe jo personit të ndaluar.

Në çështjet e komplikuarat periudhat e gjata kohore u konstatuan si të pakundërshtueshme nëse Gjykata do të shihte se hetuesit e kishin kryer hetimin e tyre me shpejtësinë e duhur dhe se nuk ishte shkaktur asnjë vonesë nga shkurtimi i personelit ose pajisjeve<sup>108</sup>. Në çështje të tilla mund të jetë e rëndësishme që të ngrihet një njësi e veçantë për t'u marrë me çështjen ose të sigurohen burime shtesë për ato ekzistueset ku pritet që një çështje të trajtohet si

me karakter përjashtues; por mbi të gjitha do të jetë thelbësore që tregohet se kohëzgjatja totale e procesit gjyqësor është mbajtur nën vëzhgim dhe se janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të përshpejtuar atë. Ushtrimi i një vëzhgimi të tillë dhe nxitja e përshpejtimit të procesit do të jetë përgjegjësi e veçantë e gjykatës kur merr në shqyrtim aplikimet për lirim.

Një i dyshuar nuk konsiderohet nga Gjykata se ka ndonjë detyrim që të bashkëpunojë por sjellja e tij nëse e bën këtë do të njihet si faktor në progresin total të hetimeve. Mungesa e bashkëpunimit si dhe pengesat përkatëse do të konsiderohen gjithashtu në vlerësimin nëse periudha totale e ndalimit në pritje të gjykimit është e tepërt apo jo<sup>109</sup>. Gjithsesi nuk mund të mbështetemi në sjelljen penguese të pretenduar për të justifikuar zgjatjen e masës së ndalimit në pritje të gjykimit që është bërë tashmë e paarsyeshme<sup>110</sup>. Në *Jablonski kundër Polonisë*<sup>111</sup>, gjykatat vendase zgjatën masën e ndalimit të kërkuesit përtej kufirit të lejueshëm statutor kohor (tre vjet) për shkak se ai kishte shkaktuar plagë vetes dhe si rrjedhojë kishte penguar progresin e gjyqit. Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të Nenit 5 (3) duke argumentuar se gjykatat vendase – kur morën vendimin që kërkuesi të qëndronte nën masën e ndalimit me qëllim që të sigurohej ecuria e duhur e gjyqit – nuk ia dolën mbanë të merrnin në shqyrtim ndonjë “masë parandaluese” alternativë si për shembull pagesë për lirin e kusht ose mbikqyrjen nga ana e policisë.

105. Stogmuller kundër Austrisë, në termat e nivelit të duhur; Clooth kundër Belgjikës dhe Muller kundër Francës, ndërrimi i individëve përgjegjës për një çështje rrjedhojë e promoconeve, rriaktimeve dhe daljeve në pension; Trzaska kundër Polonisë, ku proceset gjyqësore arritën në një mosveprim për nëntë muaj kur përbërja e trupit gjyqës duhej ndryshuar pasi gjykatësi raportues u sëmur.
106. Clooth kundër Belgjikës.
107. 26 Korrik 2001.
108. Për shembull, W kundër Zvicrës.
109. W kundër Zvicrës, ku aplikuesi refuzoi t'i lëshonte deklaratat atyre që po hetonin një mashtrim si rrjedhojë e administrimit nga ana e tij e gjashtëdhjet shoqëriëve.
110. Stogmuller kundër Austrisë.
111. 21 Dhjetor 2000.

### 3. Shkelësit e ligjit që kanë marrë dënimin

Neni 5 (1) (a) lejon “ndalimin e ligjshëm të një personi pas dënimit të tij nga një gjykatë kompetente”. Për qëllime të kësaj dispozite, *dënimi* nënkupton shpalljen e fajit për një vepër penale të kryer. Ai sigurisht që nuk mbulojë ndalimin në pritje të gjykimit ose masat e tjera parandaluese të sigurisë. Neni 5 (1) (a), bashkë me situatat tipike të vuajtjes së dënimit me burgim pas një dënimi mbi një vepër penale, gjithashtu do të mbulojë ndalimin në një institut për të meta mendore për trajtim duke qënë se një person me të çrregullime mendore u shpall fajtor për kryerjen e një veprë penale. Dënimet mund të ndjekin procedimet që shpallin fajin për vepra penale si dhe ato disiplinore. Në kuptimin e Konventës, një dënim vendoset nga gjykata (gjykata e shkallës së parë); dhe si rrjedhim ndalimi në pritje të gjykimit në apel i përket kësaj dispozite. Në çështjen *Ëemhoff* Gjykata deklaroi se

*Një person që merr dënimin në gjykatën e shkallës së parë, edhe nëse ka qëndruar në ndalim deri në atë moment, ndodhet në pozicionin që parashikohet nga Neni 5 (1) (a) që autorizon heqjen e lirisë “pas dhënies së dënimit”. Kjo frazë e fundit nuk mund të interpretohet që mund të kufizohet në rastin e dhënies së dënimit përfundimtar.*

Me tej, në *B.kundër Austrisë* Gjykata u shpreh se  
Nuk duhet neglizhuar fakti se fajësia e një

personi që është mbajtur në masën e ndalimit gjatë apelimit ose procedurave të rishqyrtimit përcaktohet gjatë procesit gjyqësor të drejtuar në përputhje me kushtet e Nenit 6.

Masa e dënimit duhet të vendoset nga një “gjykatë kompetente”, ku nënkuptohet një organ që do të ketë juridiksionin për të dëgjuar çështjen dhe një organ që është i pavarur nga ekzekutivi dhe palët dhe që parashikon garanci të duhura gjyqësore – megjithëse nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij organi të jenë juristë<sup>112</sup>. Vendimet e zbatuara nga policia, nga një prokuror publik, nga një komandant ushtrie ose nga një organ administrativ nuk do të përmbushë këto kushte. Dënimi mund të nxirret edhe nga një gjykatë e huaj, panvarësisht nga fakti nëse ai shtet është palë e Konventës apo jo. E rëndësishme në zbatimin e Nenit 5 (1) (a) është që personi i dënuar të vuajë dënimin në një shtet palë të Konventës<sup>113</sup>. Problemi i “garancive të duhura gjyqësore” në rastet kur dënimi urdhërohet nga gjykatat e huaja u ngrit në çështjen *Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës*, ku Gjykata u shpreh se vetëm nëse dënimi i urdhëruar nga gjykatat e një shteti që nuk është palë do të ishte si “rezultat i një mohimi flagrant të drejtësisë” vuajtja e këtij dënimi në një shtet palë të Konventës i përket Nenit 5 (1) (a)<sup>114</sup>.

“Ligjshmëria” e ndalimit nuk kërkon një dënim të ligjshëm por vetëm një ndalim të ligjshëm, në kuptimin që ndalimi duhet të jetë në përputhje me ligjin vendas dhe Konventën. Kushti i ligjshmërisë nënkupton që një vendim

112. X kundër Austrisë (1968 dhe 1969); De Wilde, OOMS dhe Versyp kundër Belgjikës; Engel kundër Vendeve të Ulta; Eggs kundër Zvicrës; Neumeister kundër Austrisë.
113. X kundër Republikës Federale të Gjermanisë; Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës, 26 Qershor 1992.
114. Në këtë çështje aplikuesi trajtoi në Francë një vendim dënimi për një dënim të caktuar nga gjykatat në Andorra. Gjithashtu shih çështjen Perez kundër Francës, 24 Tetor 1995.



i caktuar me burgim duhet të ketë një bazë në dhënien e dënimit nga një “gjykatë kompetente” dhe se faktet me të cilat lidhet marrja e vendimit përbën një vepër të jashtëligjshme duke lejuar imponimin e burgimit në përputje me ligjin vendas në kohën kur është kryer ajo vepër. Në bazë të Nenit 5 (1) (a), Gjykata Evropiane nuk mund të rishqyrtojë ligjshmërinë e një dënimi ose të një vendimi<sup>115</sup>. Po kështu, një person nuk mund të kundërshtojë kohëzgjatjen dhe korrektesinë e një vendimi me burgim sipas kësaj dispozite<sup>116</sup>, apo kushtet e ndalimit<sup>117</sup>.

Neni 5 (1) (a) kërkon një lidhje kontribuese – jo vetëm kronologjike – midis dënimit dhe ndalimit. Kështu, nëse një person dënohet nga një gjykatë me burgim dhe si rrjedhim me ridërgim në ndalim si rezultat i një vendimi administrativ, Neni 5 (1) (a) gjithashtu do të mbulojë masën e fundit të ndalimit kur ka një lidhje të mjaftueshme midis ndalimit administrativ dhe dënimit fillestar të gjykatës<sup>118</sup>. Me qëllim që të jetë në përputhje me këtë dispozitë, një ndalim duhet të vijohet nga marrje e vendimit përsa i përket afatit kohor, por gjithashtu duhet “të rezultojë, të vijojë e të varet ose të ndodhë në funksion të vendimit”<sup>119</sup>. Në çështjen *Ēeeks kundër Mbretërisë së Bashkuar* Gjykata u shpreh se lidhja kontribuese mund edhe të thyhet nëse “një vendim për të mos liruar apo për të ridërguar në ndalim bazohet në motivin kur ajo është në mospërputhje me objektivat e dënimit”. Në rrethana të tilla “një ndalim që ishte i ligjshëm në fillim, mund të transformohet në heqje arbitrare të lirisë, dhe

kështu i papajtueshëm me Nenin 5”.

## 4. Ekstradimi

Neni 5 (1) (f) lejon “arrestimin e ligjshëm ose ndalimin e një personi...kundrejt të cilit është marrë masa për dëbim ose ekstradim”. Ndalimi do të ketë lidhje me këtë dispozitë edhe nëse dëbimi ose ekstradimi në fakt nuk ndodh ose edhe në mungesë të një kërkeje formale ose urdhri për ekstradim duke pasur parasysh se janë kryer hetimet e duhura. Hetimet mund të çojnë në ndërmarrjen e “akteve” brenda kuptimit të Nenit 5 (1) (f).

Kjo klauzolë përmban disa garanci kur autoritetet arrestojnë ose ndalojnë një person (kryesisht më shpesh në rastet me të huaj) në pritje të vendimit për dëbimin ose ekstradimin e tij. Kështu arrestimi ose ndalimi duhet të jenë të “ligjshëm” në kuptimin që duhet të jenë në përputhje me ligjin vendas dhe Konventën dhe nuk duhet të jenë arbitrare.

Megjithëse organet e Strasburgut bëjnë dallimin midis ligjshmërisë së ndalimit dhe ligjshmërisë së ekstradimit<sup>120</sup>, ato konstatuan gjithashtu se në rishqyrtrimin e ligjshmërisë së ndalimit, ligjshmëria e ekstradimit shpesh do të ngrihet si çështje në veçanti kur vetë ligji vendas parashikon varësinë midis ligjshmërisë së ndalimit dhe atij të ekstradimit.

115. Krzycki kundër Republikës Federale të Gjermanisë; Weeks kundër Mbretërisë së Bashkuar.
116. Në çështjen Weeks kundër Mbretërisë së Bashkuar, ku aplikuesi ishte dënuar me burgim të ashpër përjetë, Gjykata iu referua ndalimit të ndëshkimeve çnjerëzore në Nenin 3 dhe jo Nenin 5.
117. Bizzoto kundër Greqisë, 15 Nëntor 1996, ku aplikuesi u ankuu mbi vendin dhe kushtet e ndalimit. Gjykata konstatoi se duhet të ketë lidhje midis trajtimit të privimit të lirisë të lejuar dhe vendit dhe kushteve të qendrës së ndalimit; konstatoi gjithashtu se ndalimi i aplikuesit ishte pasojë e një dënimi penal dhe bie si rezultat i Nenit 5(1)(a). Shih gjithashtu çështjen Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar. Në çështjen Bizzoto, Gjykata vuri në dukje se vendi dhe kushtet e qendrës së ndalimit mund të ngrejnë një çështje të pazgjidhur nën Nenin 3.
118. Van Droogenbroeck kundër Belgjikës, 24 Qershor 1982. Aplikuesi u dënua nga një gjykatë penale me dy vjet burgim dhe iu urdhërua të vendosej në dispozicion të Qeverisë për dhjetë vjet. Pasi i kreu dy vitet e dënimit me burg, aplikuesit iu privua liria në dy raste të tjera prej vendimeve të Qeverisë si pasojë e zhdukjeve të tij. Gjykata konstatoi se dënimi

me burg dhe urdhëri i vendosjes në dispozicion të Qeverisë përbënin një “të tërë të pandashme”.

119. X kundër Mbretërisë së Bashkuar, 5 Nëntor 1981; Van Droogenbroeck kundër Belgjikës; Weeks kundër Mbretërisë së Bashkuar.
120. Caprino kundër Mbretërisë së Bashkuar (1975), ku Komisioni konstatoi se përfundimi i proceseve internuese është i pavend për arsyetimin e ndalimit, nëse një procedurë internimi të ligjshëm është nisur dhe ka vazhduar me seriozitet.

Për këtë arsye është e rëndësishme që të shtyhet ekstradimi ose dëbimi derisa të kryhet rishqyrtimi i ligjshmërisë së ndalimit, duke qënë se rezultati do të mund të ndikojë në vetë ligjshmërinë e ekstradimit apo dëbimit. Gjithashtu, duke pasur parasysh garancitë e dhëna në Nenin 5 (4), ekstradimi apo dëbimi gjithnjë duhet të shtyhet derisa gjykata të ketë mundësinë për të rishqyrtuar ligjshmërinë e ndalimit dhe, nëse është e përshtatshme, të urdhërojë lirin e personit.

Ligjshmëria e një ndalimi në lidhje me ekstradimin u shqyrtua në *Bozano kundër Francës* ku Gjykata konstatoi se ndalimi i kërkuesit ishte i paligjshëm dhe si rrjedhojë, në kundërshtim me Nenin 5 (1) (f). Gjykata vendosi që dëbimi i kërkuesit nga Franca në Zvicër ishte arbitrar: megjithëse një gjykatë franceze refuzoi kërkesën e Italisë për ekstradimin e kërkuesit, qeveria franceze e lëshoi urdhrin e dëbimit kundër tij; autoritetet priten për rreth një muaj përpara se të vinin në zbatim urdhrin e dëbimit duke ndaluar kërkuesin që të përdorte ndonjë rrugë gjyqësore për të kontaktuar me gruan e tij dhe avokatin ose për të caktuar një shtet për dëbimin e tij; kërkuesi u dërgua forcërisht nga policia nga Franca për në kufirin zvicerian ku iu dorëzua autoriteteve të shtetit zvicerian dhe më pas u ekstradua për në Itali. Gjykata konstatoi se rrethanat e çështjes provuan se ndalimi i kërkuesit përbënte një formë të fshehtë të ekstradimit që nuk do të mund të justifikohet në bazë të Konventës.

Ligjshmëria e ndalimit në lidhje me

dëbimin u shqyrtua kohët e fundit në *Dougoz kundër Greqisë* ku Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 5 (1) (f). Megjithëse ekzistonte baza ligjore për dëbimin në ligjin vendas, Gjykata vërejti se dëbimi u urdhërua nga një organ tjetër dhe jo nga ai që parashikohet nga ligji vendas – të ndjekur nga opinioni i një prokurori publik mbi zbatueshmërinë me analogji të një vendimi ministror mbi ndalimin e personave që ndeshen me dëbimin administrativ – dhe se kushti për “rrezikun për publikun” në ligjin vendas nuk përmbushet. Gjithashtu, Gjykata deklaroi se opinioni i një prokurori publik në lidhje me zbatueshmërinë me analogji të një vendimi ministror mbi ndalimin e personave që ndeshen me dëbimin administrativ nuk përbënte një të “drejtë” me “cilësi” të mjaftueshme për të qënë brenda kuptimit të Konventës<sup>121</sup>.

Megjithëse Neni 5 (1) (f) nuk vendos afate kohore përsa i përket kohëzgjatjes së ndalimit, Komisioni deklaroi se procedurat e ekstradimit ose dëbimit duhet të drejtohen me “kujdesin e duhur”. Në *Lynas kundër Zvicrës* Komisioni bëri të qartë fakti se nëse

*Procedimet nuk drejtohen me kujdesin e duhur ose nëse ndalimi vjen si rezultat i keqpërdorimit të pushtetit, ai pushon së qëni i justifikueshëm në bazë të Nenit 5 (1) (f). Brenda këtyre afateve Komisioni si rrjedhojë mund të marrë në shqyrtim kohën e kaluar në ndalim në pritje të ekstradimit...<sup>122</sup>.*

Megjithatë, nëse ndalimi në pritje të ekstradimit zgjatet në interes ose me kërkesë

të personit të interesuar, ky i fundit nuk mund të pretendojë që është viktimë e ndalimit të tejzgjatur. Për shembull, në *X kundër Republikës Federale të Gjermanisë*<sup>123</sup>, të 22 muajt e ndalimit në pritje të ekstradimit u konstatuan si të justifikuar duke qënë se autoritetet gjermane e përdorën këtë kohë për të bërë përpjekje për të përfutur garancitë e qeverisë turke që kërkuesi të mos i nënshtrohej dënimit me vdekje kur të ekstradohej. Ose në *Kolompar kundër Belgjikës*<sup>124</sup>, gati tre vitet e ndalimit në pritje të ekstradimit u konstatuan gjithashtu të justifikuar duke qënë se vetë kërkuesi në mënyra të ndryshme kishte vonuar ose kontribuar në shtyrjen e procedimeve.

Kushti i ligjshmërisë përfshin cilësinë e ligjit vendas, në kuptimin që ai të jetë i aksesueshëm dhe i parashikueshëm dhe i formuluar në saktësinë e duhur. Megjithatë, panvarësisht se këto pretendime u deklaruan si të pabazuara<sup>125</sup>, kjo çështje mund të ngrihet përpara Gjykatës me sukses.

121. 6 Mars 2001.

122. Aplik. Nr. 7317/76.

123. Aplik. Nr. 9706/83. Aplikuesi nuk ishte ekstraduar në mungesë të garancisë.

124. 24 Shtator 1992.

125. Zamir kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplik. Nr. 9174/80.

## Pjesa III: Justifikime të tjera për heqjen e lirisë së një personi

Arrestimi dhe ndalimi mund të bëhet në rrethana të tjera përveç atyre ku përfshihen procese penale. Ata janë renditur në mënyrë të gjerë në Nenin 5 (1) ku duhet t'u bëhet një interpretim i ngushtë. Kushti i "ligjshmërisë" i diskutuar si më sipër<sup>126</sup> është i zbatueshëm njësoj për të gjitha situatat ku lejohet heqja e lirisë. Arrestimi dhe ndalimi duhet të jenë në përputhje me ligjin vendas dhe me Konventën dhe nuk duhet të jenë arbitrare.

### 1. Urdhri i Gjykatës dhe zbatimi i detyrimit të parashikuar me ligj

Neni 5 (1) (b) lejon arrestimin ose ndalimin e një personi për "mospërbushjen e urdhërit të ligjshëm të një gjykate ose për të garantuar zbatimin e ndonjë detyrimi të parashikuar me ligj". Çështja e parë kur lejohet arrestimi dhe ndalimi i personit mund të vijojë nga pamundësia e personit për të paguar një gjobë të vënë nga gjykata ose për t'iu nënshtruar një kontrolli mjekësor ose për tu paraqitur si dëshmitar ose për t'iu nënshtruar kufizimeve për banim të caktuar ose për të bërë deklarinimin e pasurive<sup>127</sup>. Në të gjitha rastet detyrimi duhet të lindë domosdoshmërisht nga një urdhër ligjor

i gjykatës. Në *Slavomir Berlinski kundër Polonisë*, Gjykata konstatoi se vendosja e detyruar e kërkuesit në një spital për të sëmurë mendorë u kryer në kuadrin e ndjekjes penale kundër tij me qëllim që të garantohej me anë të urdhrorit të gjykatës që të kontrollohej gjendja e tij mendore për të përcaktuar përgjegjësinë e tij penale. Pasi është përmbushur kushti që ndalimi të bëhej në bazë të urdhrorit të gjykatës, Gjykata Evropiane verifikoi kushtin e ligjshmërisë dhe konstatoi se ndalimi ishte në përputhje me një procedurë të parashikuar me ligj dhe nuk ishte arbitrar<sup>128</sup>.

Kategoritë e dyta të situatave të mbuluara nga kjo klauzolë duket se janë më pak të qarta. Megjithatë, organet e Strasburgut deklaruan se shprehja "çdo detyrim të parashikuar me ligj" lidhet me një detyrim specifik ose konkret<sup>129</sup>. Kur autoritetet ngrenë pretendimin vetëm për ndalimin e shkeljes së normave në përgjithësi kushti i specifikimit nuk përmbushet. Një detyrim i tillë specifik mund të jetë për të kryer shërbimin ushtarak ose civil, për të mbajtur me vete një kartë identiteti, për pagesat doganore ose të taksave, ose për të jetuar në një zonë të caktuar<sup>130</sup>. Në *Engel kundër Vendeve të Ulta*, ku autoritetet ngritën si pretendim këtë klauzolë me qëllim që të justifikonin "arrestimin e rreptë" si masë të përkohshme, Gjykata konstatoi se detyrimi i përgjithshëm për të qënë në pajtim me disiplinën ushtarake nuk ishte mjaftueshmërisht specifik. Në *Giulia kundër Italisë*, ndalimi i kërkuesit u justifikua me pamundësinë e tij për të përmbushur detyrimin për të "ndryshuar

126. Paragrafi 1,2.

127. Airey kundër Irlandës; X kundër Austrisë; Freda kundër Italisë; X kundër Republikës Federale të Gjermanisë.

128. 18 Janar 2001.

129. Lawless kundër Irlandës, 1 Korrik 1961; Ciulla kundër Italisë.

130. Johansen kundër Norvegjisë; B. kundër Francës; Ciulla kundër Italisë; McVeigh, O'Neill dhe Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar.

qëndrimin e tij” dhe ky nuk u konsiderua si një detyrim specifik e konkret. Në çështjen *McVeigh*, Komisioni konstatoi se detyrimi i një personi kur hyn në Mbretërinë e Bashkuar për t’u nënshtruar kontrollit nga një polic përbën një detyrim specifik dhe konkret dhe si rrjedhojë, ndalimi për të garantuar përmbushjen e tij lejohet në parim nga Neni 5 (1) (b). Në këtë çështje, Komisioni krijoi testin për t’u zbatuar për faktet që ngrenë çështje sipas kësaj klauzole të Konventës:

*në marrjen në shqyrtim të faktit nëse këto rrethana ekzistojnë duhet marrë parasysh...e natyrës së detyrimit. Është e nevojshme që të shqyrtohet nëse përmbushja e këtij detyrimi është çështje e nevojës imediate dhe nëse rrethanat janë të tilla që nuk bëjnë të mundur që mjetet e tjera për të garantuar përmbushjen të jenë mjaftueshmërisht praktike...kohëzgjatja e periudhës së ndalimit përbën gjithashtu një faktor të rëndësishëm në vendosjen e një ekuilibri të tillë.*

Refuzimi për të vënë në zbatim një detyrim kontraktual, edhe kur jepet nga një vendim civil, nuk i përket Nenit 5 (1) (b). Sipas Nenit 1 të Protokollit Nr.4, ndalohej heqja e lirisë për pamundësi në përmbushje të një detyrimi kontraktual.

## 2. Ndalimi i të miturve

Neni 5 (1) (d) lejon “ndalimin e një të mituri me urdhër të ligjshëm me qëllim mbikqyrjen edukative” ose “ndalimin e tij të ligjshëm për t’a

sjellë atë para një autoriteti ligjor kompetent”. Sipas Konventës, termi “i mitur” mbulon të gjithë personat që janë nën moshën 18 vjeç. Motivi i parë për ndalim në këtë kontekst zbatohet në çështjet kur një gjykatë ose organ administrativ vendos me urdhër të ligjshëm për mbikqyrjen e të miturit të kombinuar me një kufizim lirie si për shembull, një qëndrim i detyruar në një shkollë riedukimi ose në burg përpara se të autorizohet sipas Nenit 5 (1) (d) transferimi i tij i shpejtë në një shkollë riedukimi. Megjithatë, Gjykata konstatoi shkelje të kësaj klauzole duke qënë se i mituri – një djalë me shqetësim të thella psikike dhe kriminel – u izolua për nëntë herë në burg në pritje të gjyqit për një total prej 119 ditësh në më pak se një vit. Gjykata u shpreh se autoritetet kishin detyrimin që të siguronin mjetet e duhura për të përmbushur objektivat edukative; ndalimi i një të mituri

*në kushtet e izolimit në fjalë dhe pa asistencë personeli me trainim edukativ nuk mund të konsiderohet se është në kërkim të përmbushjes së ndonjë synimi edukativ.*

Në *Nielsen kundër Danimarkës* Gjykata u shpreh se ndalimi i një fëmije në spitalin psikiatrik kundër vullnetit të tij, por sipas kërkesës së nënës së tij, nuk përbënte heqje të lirisë por një “ushtrim të mundshëm nga ana e nënës së tij të drejtave të saj mbi kujdestarinë e fëmijës në interes të fëmijës së saj”<sup>132</sup>. Në *Suzie Koniarska kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ku urdhërat për të çuar të miturin në një qëndër sigurie ishin lëshuar nga gjykatat, Gjykata konstatoi se kërkuesit i ishte

131. 29 Shkurt 1988.

132. 28 Nëntor 1988.

hequr liria e saj duke qënë se gjykatat nuk kishin të drejta kujdestarie mbi të. Megjithatë, Gjykata konstatoi se ndalimi ishte urdhëruar “për qëllime të mbikqyrjes edukative” dhe si rrjedhojë ishte në përputhje me Nenin 5 (1) (d) pasi aplikantja – një e mitur që vuante nga çrregullime psikopatike – u dërgua në një qëndër residenciale të specializuar për të rinjtë me shqetësimë të rënda psiqike për t’iu nënshtruar një programi serioz edukimi<sup>133</sup>.

Motivi i dytë ka lidhje me ndalimin e të miturve me qëllim që t’i sjellin ata para një gjyqi “për të garantuar largimin e tyre nga mjedise të dëmshme”. Kjo situatë nuk mbulon ndalimin e një të mituri të dyshuar ose të akuzuar për kryerjen e një vepre penale. Megjithatë, do të mbulohet ndalimi i një të mituri të akuzuar për një krim gjatë kontrollit psikiatrik dhe përgatitjes së një raporti ku rekomandohet vendimi në lidhje me të miturin ose ndalimin gjatë procesit gjyqësor kur i mituri dërgohet në qëndrat e përkujdesit të fëmijëve<sup>134</sup>.

### **3. Ndalimi i personave të sëmurë mendërisht, të alkolizuarve, toksikomanëve, rrugaçëve, ose ndalimi për qëllime të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve ngjitëse**

*Neni 5 (1) (e) lejon ndalimin e ligjshëm të*

*“personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, të alkolizuarve ose toksikomanëve apo rrugaçëve”.*

Përsa i përket arsyes pse personat që bëjnë pjesë në disa nga këto kategori mund të ndalohen Gjykata u shpreh se

*“jo vetëm që ata duhet të konsiderohen me raste si të rrezikshëm për sigurinë publike, por gjithashtu se vetë interesat e tyre mund të kërkojnë ndalimin përkatës”<sup>135</sup>.*

Përsa i përket kuptimit të “personave të sëmurë mendërisht” Gjykata u shpreh se këtij termi mund të mos i jepet një “interpretim përfundimtar” sipas zhvillimit të vazhdueshëm të kontrollit mjekësor për kuptimin e çrregullimit mendor<sup>136</sup>. Sigurisht që një person mund të mos ndalohet sipas kësaj klauzole

*“thjesht për shkak se sjellja e tij ose pikëpamjet e tij devijonë nga normat që mbizotërojnë në një shoqëri të caktuar”<sup>137</sup>.*

Fakti nëse një person është i sëmurë mendërisht apo jo do të përcaktohet në përputhje me ligjin vendas, zbatimin e tij në një çështje specifike dhe njohuritë aktuale mbi psikiatrinë.

Megjithatë, ndalimi duhet të jetë “i ligjshëm” ku kuptohet se duhet të jetë në përputhje me ligjin, duke përfshirë si normat substantive, ashtu edhe ato procedurale me Konventën dhe nuk duhet të jetë arbitrar. Në çështjen *Einterëerp* Gjykata parashtroi kriteret që duhen përmbushur me qëllim që të përcaktohet ndalimi i një personi të sëmurë mendërisht si “jo arbitrar”:

133. 12 Tetor 2000.

134. X kundër Zvicrës (1979) dhe përkatësisht Bouamar kundër Belgjikës.

135. Guzzardi kundër Italisë (individë të sëmurë mendor, të alkolizuar dhe vartës droge).

136. Winterwerp kundër Vendeve të Ulta, 24 Tetor 1979.

137. Idem.

- i. çrregullimi mendor duhet të përcaktohet nga ekspertiza mjekësore objektive;
- ii. natyra ose shkalla e çrregullimit duhet të jetë mjaftueshmërisht ekstreme për të justifikuar ndalimin;
- iii. ndalimi duhet të zgjatë përse kohë që vazhdon çrregullimi mendor dhe rëndësa përkate;
- iv. në çështjet kur ndalimi është mjaft i papërcaktuar rishikimet periodike duhet të ndodhin në një gjykatë që ka pushtetin për të liruar personin e përfshirë;
- v. ndalimi duhet të ndodhë në një spital, klinikë ose institucion tjetër të autorizuar për të ndaluar persona të tillë<sup>138</sup>.

Kushti i parë nuk zbatohet në raste emergjence. Për shembull, kërkuesi në *Ëinterëerp* u dërgua në një spital psikiatrik nga një kryetar komune, pa këshillim paraprak mjekësor, pasi ishte gjetur i shtrirë lakuriq në një qeli policie<sup>139</sup>. Megjithatë, mendohet se ndërsa disa rrethana mund të lejojnë ndalimin në raste emergjence, duhet të merret një konfirmim mjekësor, të paktën i përkohshëm, në një kohë të shkurtër pas ndalimit. Në *Varbanov kundër Bullgarisë* kërkuesi u ndalua pasi ishte lëshuar urdhri nga prokurori pa konsultuar ekspertin mjekësor. Gjykata konstatoi se ndalimi ishte i paligjshëm duke qënë se kërkuesi “nuk ishte konstatuar nga burime të besueshme se mund të ishte i sëmurë mendërisht”. Gjykata mbërriti në këtë konkluzion pasi vërejti se në çështjen në fjalë “një vlerësim paraprak nga psikiatri, të paktën në bazë

të provave dokumente të disponueshme ishte i domosdoshëm dhe dhe i mundshëm”. Gjykata vërejti se nuk kishte patur pretendime mbi emergjencën e çështjes, se kërkuesi nuk kishte pasur më parë histori të sëmundjes mendore dhe se kishte paraqitur një vlerësim mjekësor ku thuhej se ishte mendërisht i shëndëtshëm. Sipas këtyre rrethanave, Gjykata konstatoi si të paranueshëm arrestimin dhe ndalimin e kërkuesit bazuar në pikëpamjet e prokurorit dhe një polici mbi gjendjen shëndetësore të kërkuesit në mungesë të vlerësimit që duhej bërë nga psikiatri<sup>140</sup>.

Është gjithashtu e rëndësishme që të vërehet se Neni 5 (1) (e) nuk mbart një “të drejtë për trajtim” të nënkuptuar siç u pretendua nga kërkuesi në çështjen *Ëinterëerp*, i cili kishte argumentuar se trajtimi i duhur nënkuptohej “me qëllim që garantohej që ai të mos mbahej në masë ndalimi më shumë se absolutisht të ishte e nevojshme”. Në çështjen *Ashingdane*, gjithsesi, Gjykata u shpreh se duhet të ekzistojë “një marrëdhënie midis motivit ku u mbështet lejimi i heqjes së lirisë dhe vendi e kushtet e ndalimit”, në kuptimin që ekzekutimi i urdhrat që i heq personit të sëmurë mendërisht lirinë e tij ose të saj është gjithashtu pjesë e kushtit të ligjshmërisë. Megjithatë, pamundësia për t’i siguruar trajtim mjekësor një personi të sëmurë mendërisht mund të ngrejë çështjen e ndalimit të “trajtitimit çnjerëzor” në Nenin 3.

Problemi i endacakëve u paraqit përpara Gjykatës në çështjen *De Eilde, Ooms dhe Versyp*

138. Gjithashtu shih çështjen X kundër Mbretërisë së Bashkuar (1981); *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1985).
139. Edhe pse Gjykata e quajti këtë ndalim urgjencë “të ligjshëm”, ligji hollandez ishte duke u ndryshuar deri diku se këshillimi paraprak mjekësor nevojitet.
140. 5 Tetor 2000.



*kundër Belgjikës*. Gjykata pranoi në parim, për kuptimin e Nenit 5 (1) (e) përkufizimin e termit endacakë në Kodin Penal Belg: “persona që nuk kanë një banesë të caktuar, nuk kanë mjete për të jetuar dhe asnjë punë apo profesion të rregullt”. Në *Guzzardi kundër Italisë* Gjykata refuzoi pretendimin e qeverisë se anëtarët e dyshuar të mafias të cilët nuk kishin burime të identifikueshme të të ardhurave i përkisnin termit “endacakë”. Në rastin belg ku kërkuesit ishin ndaluar në bazë të vullnetit të tyre të lirë, Gjykata u shpreh se e drejta për lirinë nuk duhet të jepet dhe në këtë rast lindi nevoja për një vendim gjyqësor kur i ndaluarit pranoi heqjen e lirisë së tij.

Megjithëse ka patur pak ankime në lidhje me ndalimin e toksikomanëve, të alkolizuarve ose për qëllime të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, nënkuptohet që Gjykata duhet të miratojë një mënyrë të ngjashme me atë që ndjek në rastet me personat e sëmurë mendërisht kur bën vlerësimin e vlefshmërisë së ndalimit. Gjykata u shpreh në përkufizimin e kuptimit të “të alkolizuarve” për qëllimet e Nenit 5 (1) (e) në çështjen e *Witold Litëa kundër Polonisë*:

*Personat që nuk janë diagnostikuar nga pikëpamja mjekësore si “të alkolizuar”, por që sjellja e qëndrimi i tyre nën ndikimin e alkolit përbëjnë kërcënim për rendin publik ose ata vetë, mund të mbahen nën mbikqyrje për mbrojtjen e publikut ose vetë interesat e tyre, si për shembull sigurinë e tyre të shëndetit dhe atë personale.*

Megjithatë, Gjykata u shpreh gjithashtu se kjo nuk nënkupton se “ndalimi i një individi thjesht për shkak të masës së alkolit të marrë” do të lejohet sipas Nenit 5 (1) (e). Gjithashtu, Gjykata konstatoi se ndalimi i kërkuesit në një qendër kundër alkolizimit ishte arbitrar pasi sjellja e tij nuk dukej se përbënte kërcënim për publikun apo për veten dhe se nuk ishin marrë në konsideratë masat alternative të parashikuara nga ligji vendas për personat e intoksikuar. Gjykata vërejti se në përputhje me ligjin vendas

*“një personi të intoksikuar nuk duhet t’i hiqet domosdoshmërisht liria pasi mund të çohet nga policia në një qendër të kujdesit publik ose në banesën e tij”.*

Përfundimisht, Gjykata konstatoi se ndalimi i kërkuesit në një qendër kundër alkolizimit ishte i paligjshëm<sup>141</sup>.

## Pjesa IV: Detyrimi për të dhënë brenda një afati sa më të shkurtër arsytet e arrestimit

Paragrafi 2 i Nenit 5 përmban një garaci thelbësore kundrejt abuzimit të pushtetit për të hequr lirinë e dikujt: çdo njeri që arrestohet informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton, për arsytet e arrestimit të tij dhe për çdo akuzë kundër tij. Kjo do të mundësojë që personi i përfshirë të kuptojë se çfarë po i ndodh atij ose asaj dhe të mendojnë për kundërshtimin më të mirë që mund t'i bëjnë një mase të tillë. Në shumë çështje ku është justifikuar heqja e lirisë, një shpjegim përkatës do të kishte efektet përfutuese të qartësimit të faktit se nuk është e përshtatshme që të bëhet rezistencë ndaj arrestimit dhe kështu të lehtësohet detyra e zyrtarëve që vënë në zbatim urdhrin. Gjithashtu, nevoja për të shpjeguar përse merret një masë e tillë do të mund të nxisë zyrtarët publikë që të marrin në konsideratë faktin nëse po veprojnë brenda kufijve që i lejon pushteti i tyre dhe të shmangin veprimet për të cilat nuk është dhënë një justifikim i mjaftueshëm. Sigurisht që arsytet e dhëna – ose mungesa e tyre – përfundimisht do të jenë faktorë të rëndësishëm për organin gjyqësor të cilit i kërkohet të vendosë mbi pranueshmërinë e heqjes së lirisë. Në përmbushjen e detyrimit për të dhënë arsye, ato që duhen marrë në konsideratë janë rrethanat në të cilat lindin detyrimet, natyra

e shpjegimit që duhet dhënë, shkalla në të cilën shpjegimi duhet të jetë i kuptueshëm për personin e përfshirë dhe kohën që do të kalojë përpara se të jepet një shpjegim i tillë.

### 1. Kur lindin detyrimet

Neni 5 (2) i referohet një personi që është “arrestuar” dhe ekzistencës së një “akuze” kur përcakton detyrimin për të dhënë arsye. Kjo renditje fjalësh nuk duhet të çojë në konkluzionin se nevoja për të dhënë arsye lind vetëm në kontekstin e procesit penal. Tashmë është përcaktuar qartë që duhen dhënë arsytet për çdo situatë kur dikujt i është hequr liria e tij ose e saj. Një person nuk mund të ushtrojë të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndonjë ose çdo heqje lirie pa qnënë në dijeni të arsyeve për një privim të tillë. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se detyrimi është i zbatueshëm për secilën dhe çdo heqje lirie në mënyrë që rivënia në zbatim e një mase të tillë pas një forme të përkohshme lirimimi – qoftë në formën e pagesës për lirimimin me kusht ose lirimimin e një të akuzuari të dënuar me garanci – të kërkojë një shpjegim, panvarësisht nga fakti se është dhënë shpjegimi për heqjen fillestare të lirisë.<sup>142</sup>

### 2. Natyra e shpjegimit

Në *Fox, Campbell dhe Hartley* Gjykata theksoi

142. Shih Aplik. Nr.4741/71, X kundër Belgjikës, 43 CD 14 (1973). Gjykata nuk e pa të nevojshme të përmbahej në këtë pikë në çështjen X kundër Mbretërisë së Bashkuar, 5 Nëntor 1981, por ajo theksoi rëndësinë e një shpjegimi për ushtrimin efektiv të së drejtës nën Nenin 5(4) për të shpallur ligjshmërinë e çdo privimi të lirisë.

se shpjegimi duhet t'i ofrojë personit të interesuar motivet thelbësore ligjore e faktike për heqjen e lirisë që më pas të mundësojë që personi të aplikojë në një gjykatë për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit apo ndalimit. Kështu, do të ishte e pamjaftueshme që thjesht t'i referohej dispozitës formale statutoe për të autorizuar heqjen e lirisë siç ndodhi fillimisht në *Fox, Campbell dhe Hartley*. Ka nevojë që të jepen të dhëna për bazat substantive për të vënë në përdorim këtë dispozitë duke qënë se kjo do të tregojë nëse rrethanat specifike i përkasin fushës përkatëse dhe nëse është apo jo arbitrar përdorimi në kontekstin specifik. Në *Fox, Campbell dhe Hartley* kushtet e Nenit 5 (2) ishin përmbushur totalisht përsa i përket Gjykatës sepse arsyet ishin konsideruar se ishin të qarta nëpërmjet pyetjeve që i ishin drejtuar kërkuesit mbi disa akte kriminale specifike dhe mbi anëtarësimin e dyshuar në një organizatë të paligjshme. Marrja e vendimit në këtë çështje i vuri një theksim të veçantë faktit se kërkohet një shkallë specifikimi për të përmbushur Nenin 5 (2). Personi i përfshirë nuk do të mund të jetë në gjendje të përcaktojë nëse pretendimi për ndalimin e tij përbën përdorim të justifikuar të pushtetet pa pasur ndonjë tregues për sa më sipër që formon bazën për heqjen e lirisë së dikujt<sup>143</sup>. Në shumë raste shpjegimi ndoshta jepet më mirë nëpërmjet një deklarate të drejtpërdrejtë për personin e përfshirë nga ana a zyrtarit ku ai privohet nga liria e tij ose e saj. Për shembull, kur i tregohet personit se ai ose ajo është i/e dyshuar për vjedhjen e diçkaje nga një shtëpi në një ditë

të dhënë.

Detyrimi për të dhënë arsyet në çështjet penale mund të përfshijë informacion që jepet si për veprën penale për të cilën dyshohet personi dhe për mënyrën në të cilën ai ose ajo është përfshirë në kryerjen e kësaj vepre. Po kështu, kur privimi i lirisë bazohet në sëmundjen mendore të një personi, duhet të ketë tregues që të japin prova se sjellja e tij/saj mund të konsiderohet se mund të çojë në një shqetësim të madh dhe se diagnoza konsiderohet se justifikon kohën kur është kryer veprimi. Në të njëjtën mënyrë, në çështjen e ndalimit përpara ekstradimit, personi i përfshirë do të duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit për veprën e kryer dhe për ekzistencën e një kërkesë për të bërë këtë gjë nga një shtet i caktuar.

Detyrimi sipas Nenit 5 (2) është më i kufizuar se detyrimi i imponuar nga Neni 6 (3) (a) për të njoftur personin e akuzuar mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij; kërkohen më shumë detaje në situatën e fundit sepse kjo do të jetë thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes në gjyqin përkatës që do të vijojë.

### **3. Qartësia në dhënien e arsyeve për masën e ndalimit**

Është e rëndësishme që arsyetimi të formulohet në një gjuhë jo-teknike. Shumë njerëzve që kanë përjetuar heqjen e lirisë së tyre nuk do të mund të kenë as kapacitetin intelektual

143. Cf Raiselis kundër Lituaniës, ku u dëshmuua se për më tepër nuk ishte dhënë asnjë arsye, apo nuk ishte bërë asnjë aluzion mbi një numër masash paraprake të caktuara me ligj, por nuk ekzistonte asnjë veprë penale konkrete; 2 Mars 1999 (vendim i pranueshmërisë) dhe 29 Shkurt 2000 (marrëveshje miqësore).

ose eksperiencën profesionale për të kuptuar kompleksitetin e së drejtës. Ideja e përgjithshme është që personi i përfshirë të kuptojë se çfarë po ndodh me të dhe më pas do të lindë gjithmonë nevoja për të marrë parasysh kapacitetet specifike të individit. Një objektiv i tillë mund të përmbushet kur dokumentet zyrtare – si për shembull një padi ose urdhër gjykate – që autorizojnë heqjen e lirisë të jenë të shprehura në një gjuhë që të jetë e qartë në përgjithësi. Megjithatë, kjo nuk është gjithnjë e mundur, dhe duke qënë se nuk kërkohet një formë e saktë e komunikimit për sa më sipër nga Neni 5 (2), qartësimet që bëjnë zyrtarët kur mbështeten në dokumentet zyrtare mund të jenë plotësisht të pranueshme. Sigurisht që kjo mund të kërkojë përpjekje më të mëdha nga ana e tyre për t’ia komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në një gjuhë të thjeshtuar shpegimin për arsyen e ndalimit një individi. Në rastet kur nuk është i mundur komunikimi për shkak të moshës së personit apo gjendjes së tij mendore, arsyeja duhet t’i jepet personit që e ka në ngarkim atë – si në rastin e një fëmije shumë të vogël në moshë – ose dikujt që është i autorizuar për të përfaqësuar interesat e personit në fjalë.

Kur personi që i hiqet liria nuk e kupton gjuhën zyrtare, arsyeja për masën e ndalimit duhet të jepet në një gjuhë që ai e kupton (kjo mund të përfshijë edhe sistemin Braille ose gjuhën e shenjave). Gjithsesi kjo nuk përbën problem në shumicën e çështjeve duke qënë se dhënia e arsyes nuk ka pse jepet në momentin fillestar të ndalimit dhe kështu do të ketë mundësi që të

gjendet dikush që të mund të japë arsyet e ndalimit në një gjuhë që personi i përfshirë e kupton<sup>144</sup>.

## 4. Afati kohor

Neni 5 (2) specifikon më shumë që arsyet të jepen “brenda një afati sa më të shkurtër” sesa “menjëherë”. Pamundësia për të dhënë arsyet e duhura mund të jetë në vetvete e mjaftueshme për të konsideruar si arbitrare heqjen e lirisë së dikujt dhe si rrjedhin të jetë e paligjshme për qëllimet e Nenit 5.

Pranueshmëria e intervalit midis arrestimit fillestar dhe momentit kur jepen arsyet e duhura do të varet shumë nga rrethanat e çështjes specifike. Në çështjet kur marrja në pyetje në vijim të arrestimit e një të dyshuari konstatohet që të jetë e mjaftueshme që ai person të kuptojë arsyet e heqjes së lirisë së tij, Gjykata nuk ka kundërshtuar intervalet që zgjasin midis dy dhe nëntëmbëdhjetë orëve. Rasti i parë u ndesh në *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe i dyti në *Dikmer kundër Turqisë*<sup>145</sup>. Megjithatë, në këto çështje të sipërpërmendura Gjykata ka theksuar se intervali ka qënë vetëm për disa orë<sup>146</sup>. Nuk ka të ngjarë që intervalet e më shumë se një dite të konsiderohen tashmë si të pranueshme në shumicën e rasteve. Gjithsesi, është e kuptueshme që një periudhë më e gjatë mund të pranohet kur hasen vështirësi praktike për të kryer komunikimin e arsyes për arrestim si për shembull kur nuk mund të gjendet menjëherë një

144. Shih Aplik. Nr. 2689/6, Delcourt kundër Belgjikës, 10 YB 238(1967), ku urdhër arresti me të cilin u arrestua një individ i cili fliste frëngjisht ishte e shkruar në gjuhën hollandeze, por marrja në pyetje më pas u krye në gjuhën franceze.
145. 11 Korrik 2000.
146. Shih çështjen Fox, Campell dhe Hartley (shtatë orë e gjysëm) dhe Kerr kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendim i pranueshmërisë)

përkthyes. Gjithsesi, nuk ka arsye për të supozuar se jashtë procesit penal do të lihet hapësurë për më tepër liri në interpretimin e “brenda një afati sa më të shkurtër”; sigurisht në *Van der Leer kundër Vendeve të Ulta* një vonesë prej dhjetë ditësh për të informuar individin mbi arsyet se përse u izolua në një spital për të sëmurë mendorë u konsiderua menjëherë si e papranueshme. Patjetër që arsyet për t’i bërë të ditur dikujt përse i është hequr liria janë mjaft të ngutshme, madje edhe kur nuk përfshihet çështja në një proces penal dhe e drejta për të kundërshtuar ligjshmërinë e një mase të tillë është njësoj e zbatueshme.

Megjithatë, nuk do të kërkohet ndonjë përpjekje e madhe për të komunikuar arsyet e ndalimit kur personi të cilit i është hequr liria – për çfardollos arsyetjeje – e ka bërë të pamundur dhënien e arsyeve për ndalimin e tij; kështu në *Keus kundër Vendeve të Ulta*<sup>147</sup> nuk u përcaktua asnjë shkelje e Nenit 5 (2) kur një person me çrregullime mendore ishte arratisur përpara se t’i komunikohet vendimi për izolimin e tij në një spital. Arsyet e izolimit u konsideruan se ishin komunikuar në mënyrën e duhur kur ai telefoni në spital dhe autoritetet nuk kishin ndonjë detyrim tjetër që të njoftonin avokatin e tij paraprakisht mbi vendimin që ishte marrë.

## Pjesa V: Detyrimi për të sjellë personat e ndaluar para një autoriteti gjyqësor që ka të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ose të lirimit në pritje të gjykimit

Paragrafi 3 i Nenit 5 përfshin një sërë garancish thelbësore me qëllim që të kosnderojë heqjen e lirisë si përjashtim nga rregulli i lirisë dhe të sigurojë që mbikqyrja gjyqësore mbi arrestimin dhe ndalimin të jetë gati. Ky paragraf merret vetëm me ndalimin në vijim të Nenit 5 (1) (c).

Detyrimi në Nenin 5 (3) për të siguruar që mbikqyrja gjyqësore ushtrohet për masën e arrestit dhe ndalimit do të përfshijë tre elementë: karakterin e personit që ushtron mbikqyrjen; autoritetin për të përfunduar masën e ndalimit, me fjalë të tjera për të liruar personin e përfshirë; dhe afatin kohor brenda të cilit ndodh mbikqyrja.

### 1. Karakteri i autoritetit ligjor kompetent

Neni 5 (3) kërkon së pari që personi i arrestuar apo ndaluar në përputhje me klauzolën e paragrafit 1 (c) duhet të sillt para një gjyqtari ose nëpunësi tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar kompetenca gjyqësore brenda një afati sa më të shkurtër. Ndërsa termi “gjyqtar” nuk ngre çështje për diskutim, shprehja “nëpunësi i autorizuar me ligj për të ushtruar kompetenca gjyqësore” e detyron Gjykatën që të identifikojë një “nëpunës” të tillë që nuk është gjyqtar.

Nuk ka dyshim që shumë njerëz kur u miratua fillimisht Konventa menduan se ky “nëpunës” mund të ishte prokurori. Gjithsesi kjo ishte praktika në një numër shtetesh të Këshillit të Evropës dhe iu kushtua vëmendje sigurimit që pozicioni i prokurorit të përmbushte kriterin e specifikuar në Nenin 5 (3), përkatësisht që prokurori të jetë një individ “i autorizuar për të ushtruar kompetenca gjyqësore”. Iu vu një theks i veçantë faktit që zyra e prokurorit të kishte të njëjtën lloj pavarësie nga ekzekutivi ashtu si dhe pavarësia që gëzon një gjyqtar.

Megjithatë, në praktikë është provuar e pamundur që prokurorët të jenë në gjendje të luajnë këtë rol në pajtueshmëri me kushtet e Konventës. Kushti që një “nëpunës” duhet të jenë në gjendje të ushtrojë kompetencë gjyqësore nënkupton që “nëpunësi” përkatës të jetë i pavarur nga ekzekutivi si dhe i paanshëm. Kjo

mënyrë ka bërë që Gjykata të konstatojë që dhënia e kompetencës prokurorit për të vendosur nëse duhet të vazhdojë masa e ndalimit të një të dyshuari deri në një moment përpara gjykimit nuk ishte e pajtueshme me Nenin 5 (3). Problemet kanë dalë gjithnjë kur diskutohet për mundësinë e prokurorit që do të vendosë mbi çështjen e ndalimit – duke pasur parasysh se do të ketë rolin e tij në procesin gjyqësor kundër personit të përfshirë. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, të dy funksionet e hetimit dhe ndjekjes penale nuk mund të kryhen nga i njëjti person. Problemi kryesor është që prokurori është palë në ndjekjen penale dhe personi që merr këto kompetenca si rrjedhim nuk do të mund të mendohet se do të jenë i paanshëm kur të kryejë një funksion gjyqësor në të njëjtën çështje. Problemi më madhor lind nëse ekziston apo jo mundësia që më vonë prokurori të përfshihet në ndjekjen penale në fjalë të çështjes. Kjo mjaftonte për Gjykatën që të nxirrte konkluzionin në çështjen *Hyber kundër Zvicrës* që prokurori i rrethit në Zyrih nuk përmbushte kushtet e Nenit 5 (3). Po kështu u konstatua një shkelje e Nenit 5 (3) në *Brincat kundër Italisë*<sup>148</sup> ku ndalimi i të akuzuarit ishte konfirmuar nga një prokuror i cili më pas nxorri konkluzionin se nuk kishte juridiksion territorial mbi çështjen dhe ajo iu dorëzua një prokurori në një rajon tjetër.

Gjykata vërejti se meqë objektivi i prokurorit të parë qëkonfirmoi masën e ndalimit ishte që ai të mund të ndërhynte në procesin penal vijues, ishin të justifikuar dyshimet mbi paanshmërinë e tij dhe nuk kishte rëndësi fakti që më vonë

u qartësua se ai nuk kishte juridiksion mbi çështjen. Fakti që prokurori nuk u bë një nga palët ishte thjesht rastësi dhe drejtimi i çështjes rezultoi në heqjen nga kodi italian i procedurës të kompetencës së prokurorëve për të konfirmuar apo urdhëruar masën e ndalimit.

Duhet theksuar që problemi i paanshmërisë mund të ndikojë gjithashtu pozicionin e gjyqtarëve; ekziston një shtrirje e gjerë e jurisprudencës në lidhje me faktin nëse pëfshirja e një gjyqtari në vendimet para gjykimit është e tillë që ai ose ajo të mos ketë paanshmërinë objektive për të drejtuar seancën gjyqësore; dhe ky është problemi kur duhet të nxirren konkluzionet nëse personi i ndaluar shpallet apo jo fajtor.

Megjithatë, problemi i paanshmërisë objektive ka mundësi që të jetë më i ndjeshëm në strukturat e sistemeve të gjykimit dhe nuk është i çuditshëm fakti që shumë vende kanë ndjekur shembullin e Italisë pasi është e vështirë që të garantohet paraprakisht që autoriteti që ka dhënë masën e ndalimit të mos përfshihet më pas në ndjekjen penale. Nëse sigurisht kjo nuk përbën problem, atëherë do të lindë patjetër nevoja për të siguruar që prokurori është vërtetë i pavarur dhe kjo nënkupton jo vetëm nga presionet politike, por gjithashtu edhe nga eprorët e tij. Në disa rrethana, vartësit priten që të ndjekin udhëzimet e eprorëve të tyre në lidhje me një çështje të një individi dhe si pasojë ata nuk do të kenë pavarësinë e duhur në ndjekjen e çështjes.

Në *Assenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë* kërkuesi u soll para një hetuesi që e mori



në pyetje, ngriti padinë formalisht dhe mori vendimin që të ndalonte atë në pritje të gjykimit. Vendimi i hetuesit u miratua nga një prokuror dhe prokurorë të tjerë vendosën vazhdimin e masës së ndalimit. Gjykata u shpreh se duke marrë parasysh se të gjithë këta prokurorë në vijim do të mund të vepronin kundër kërkuesit në ndjekjen penale, ata nuk ishin mjaftueshmërisht të pavarur ose të paanshëm për qëllimet e Nenit 5 (3)<sup>149</sup>.

Gjykata shqyrtoi dhe diskutoi gjerësisht mbi kompetencat e prokurorit në çështjen *Niedbala kundër Polonisë*. Gjykata si fillim vërejti që në bazë të ligjit polak në kohën ekratëse detyrat e ndjekjes penale gjatë procesit u kryen nga prokurorët. Këta të fundit ia parashtruan çështjen Prokurorit të Përgjithshëm i cili në atë kohë kryente funksionin e Ministrisë të Drejtësisë. Kjo e bënte të pashmangshëm faktin që prokurorët, në ushtrimin e funksioneve të tyre do të vareshin nga mbiqkyrja e një autoriteti që i përket departamentit të ekzekutivit. Gjykata u shpreh gjithashtu se roli i tyre si vigjil të interesit të publikut – të pretenduar nga qeveria polake – nuk mund të konsiderohej se i jepte atyre një status gjyqësor. Duke qënë se prokurorët kryenin si funksione hetimi ashtu edhe ndjekjeje penale ata duhet të konsiderohen si palë në procesin penal. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se prokurori – në sistemin ligjor polak – nuk ishte një “nëpunës i autorizuar me ligj për të ushtruar kompetenca gjyqësore”. Fakti që personat e arrestuar dhe të ndaluar me urdhër të prokurorëve mund

të parashtronin një aplikim në gjykatë kundër ndalimit nuk mund të shihej si zgjidhje e problemit për faktin se urdhrat e ndalimit ishin lëshuar nga prokurorët. Gjykata argumentoi se rishikimi gjyqësor nuk ishte automatik pasi varej nga aplikimi që do të bëhej nga kërkuesi në gjykatë. Gjithashtu, Gjykatë vërejti se ligji polak nuk ofronte ndonjë garanci kundrejt riskut që i njëjti prokuror që vendosi për ndalimin e kërkuesit në pritje të gjykimit më vonë mund të merrte pjesë në procesin penal<sup>150</sup>.

## 2. Roli i autoritetit ligjor kompetent

Gjyqtari para të cilit sillet individi duhet të jetë i përgjegjshëm për të përcaktuar masa e ndalimit duhet vazhduar (që i nënshtrohet kushtit që për cilindo që ndalohet duhet të merret vendimi “brenda një kohe të arsyeshme”) ose përfunduar. Çdo urdhër mbi këtë çështje duhet të ketë efekt detyrues. Kjo përbën një çështje kritike: Neni 5 (3) përcakton një zgjedhje midis lirimit ose gjykimit të personit brenda një afati të arsyeshëm, por edhe zgjatjen e masës së ndalimit do të justifikohet vetëm do të jepen arsye të pranueshme e të mjaftueshme për të (si për shembull, rreziku i largimit, ndërhyrja në procesin e drejtësisë, kryerjen përsëri të veprave penale ose prishjen e qetësisë publike). Megjithëse një ose më shumë nga këto arsye mund të ekzistojnë kur personi

149. 28 Tetor 1998.

150. 4 Korrik 2000.

ndalohet fillimisht, ato mund të bëhen më pak të rëndësishme me kalimin e kohës dhe në rrethana të tilla personi në fjalë duhet të lirohet<sup>151</sup>.

Gjithashtu, edhe kur ka një arsye të justifikueshme për të vazhduar masën e ndalimit të personit, gjithsesi mbetet një kusht i përgjithshëm që periudha e ndalimit para gjykimit nuk duhet të mbetet e pajustificuar. Kjo duhet gjykuar nga kompleksiteti i proceseve penale, por gjithashtu edhe nga shkalla e përgatitjes së çështjes. Pasiviteti i zgjatur, si në çështjen e *Toth kundër Austrisë*, pashmangshmërisht që do të çojë në konstatimin e një shkeljeje; i njëjti gjykim ndiqet në përgjegjësinë gjyqësore për të siguruar që një çështje të silltet para gjyqit pa vonesa. Gjyqtari duhet të përgatitet që të analizojë mjaft ngushtë si bazat në dhënien e masës së ndalimit fillestar – pasi mund të dalë që ka qenë plotësisht i papërshtatshëm – dhe arsyet e parashtruara për vazhdimin e masës së ndalimit me qëllim që të përmushë përgjegjësitë e tij. Shqetësimi mbi mbikqyrjen gjyqësore shpesh lind nga një besim i gabuar se domosmërisht ajo do të çojë në lirimin e kriminelëve përpara fillimit të gjyqit dhe si rrjedhojë ata do të jenë të lirë të pengojnë procesin gjyqësor, do të arratisen apo do të kryejnë krime të tjera. Megjithatë, nuk duhet të jetë i prerë vendimi mbi lirimin e një personi dhe roli i gjyqtarit është që të provojë çështjen e ndalimit e të autorizojë atë nëse është e vlefshme dhe kur janë paraqitur arsye me baza të forta. Nuk është e mjaftueshme që të pretendohet si arsye frika se mos personi i akuzuar arratiset ose ndërhyjnë tek dëshmitarët;

provat e kësaj mundësie duhet të parashtrihen dhe si të gjitha provat e tjera duhet të shqyrtohet logjika e këtyre provave. Kështu edhe ndërhyrja në dhënien e dëshmimeve nga dëshmitarët nuk përbën ndonjë arsye të besueshme kur janë marrë tashmë deklaratat e betuara. Gjithashtu arsyetimi i dhënë nga gjyqtari duhet të jetë real dhe jo një citim ritual i formulës së përhershme<sup>152</sup> duke treguar se nuk u morën në konsideratë deklaratat e aplikimit për lirim. Refuzimi i menjëhershëm si dhe vendimet e pabazuara janë gjithashtu të papranueshme.

### 3. Kuadri kohor për mbikqyrje

Një pjesë kyçe e kushtit për mbikqyrje gjyqësore është fakti që ushtrimi fillestar i kësaj mbikqyrjeje duhet të ndodhë “brenda një afati të shkurtër”. Ky term vjen nga ndalimi i shumëfolur i arbitraritetit në lidhje me ndalimin e një personi. Kushti i shqyrtimit cakton një afat tjetër për intervalin midis aktin fillestar të ndalimit dhe momentit kur për herë të parë i nënshtrohet mbikqyrjes. Ai sygjeron gjithashtu se standartet ndërkombëtare kërkojnë që autoritetet që kryejnë ndalimin t’u japin mundësi gjykatave për të ushtruar mbikqyrjen sa më shpejt të jetë e mundur brenda intervalit të kohës së lejueshme. Më pak fjalë, afati tjetër kohor duhet të zbatohet duke pasur parasysh rrethanat e çdo çështjeje individuale.

Në disa çështje masa e ndalimit ka zgjatur

151. Letellier kundër Francës; Tomasi kundër Francës.

152. Ashtu si në çështjen Mansur kundër Turqisë, 8 Qershor 1995.

shumë më tepër seç mund të konsiderohej në mënyrë të arsyeshme e pranueshme. Kështu në këto raste nuk ka patur hezimi nga ana e Gjykatës Evropiane për të konstatuar shkelje si në rastin e *McGoff kundër Suedisë*, ku kishin kaluar pesëmbëdhjetë ditë ndërmjet afatit kur i akuzuari ishin mbajtur nën arrest dhe herës së parë që ai ishte çuar para një gjykate. Kalimi prej tre muajsh kohë nga dita e ndalimit në atë të gjykimit në çështjen *Assenov dhe të Tjerë kundër Bullgarisë* dhe në *Jecius kundër Lituanisë* u deklarua se përbënte shkelje në lidhje me kushtin e gjykimit brenda një kohe të shkurtër. Në *Van der Sluis, Zuiderveld dhe Klappe kundër Vendeve të Ulta* u konstatua shkelje kur vonesa që shkonte nga njëmbëdhjetë në katëmbëdhjetë ditë (këtu çështja lidhej me thyerjen e urdhërave ushtarake ku ishin bërë lëshime për ekzistencën e jetës ushtarake dhe të drejtësisë). Megjithatë, shkelja e detyrimit do të lindë kur intervalet nuk janë aq ekstreme. Kështu që ka qenë e pamundur të bindej Gjykata Evropiane që vonesat prej pesë dhe gjashtë ditësh do të mund të konsideroheshin si të pranueshme<sup>153</sup> dhe vihet re që ekzistonte një marrëveshje miqësore pas një ankese për një vonesë gjashtë ditore për të sjellë dikë para gjyqit në çështjen *Skoogstrom kundër Suedisë*.

Çështja mbi përcaktimin e një afati kohor mbi mbikqyrjen gjyqësore është ajo e *Brogan kundër Mbretërisë së Bashkuar* që jo vetëm konstatoi periudhën prej katër dhe gjashtë ditësh si shumë të gjatë, por gjithashtu edhe hodhi dritë mbi objektivin që theksonte detyrimin që një person

duhet të sillej para një gjykate pas ndalimit fillestar të tij apo asaj. Arrestimi në *Brogan* kishte të bënte me një të dyshuar terrorist dhe megjithëse Gjykata pranoi që rrethanat specifike të luftës kundër terrorizmit mund të kishin një impakt në kohëzgjatjen e ndalimit përpara se ti nënshtrohej gjykimit, ajo konstatoi në bazë të rrethanave të veçanta të çështjes një shkelje përse i përket kushtit të gjykimit brenda një afati të shkurtër. Gjykata ishte e përgatitur për të treguar njëfarë vlerësimi në lidhje me nevojën për t'iu përgjigjur disa problemeve, si për shembull në vështirësitë që ndeshen për të mbledhur proa të pranueshme dhe të përdorshme, për kohën që nevojitet për disa lloj testesh ligjore dhe informacionit delikat të përfshirë; por ajo shprehu vullnetin për të vepruar kështu deri në njëfarë mase për shkak se e njihte si nocionin e “kohës së më të shkurtër”, ashtu edhe rëndësinë e një kushti të tillë. Gjykata u shpreh se

*Dhënia e rëndësisë tek tiparet e veçanta të kësaj çështjeje për të justifikuar një periudhë kaq të gjatë ndalimi përpara se individi të sillet para një gjyqtari apo nëpunësi tjetër gjyqësor do të përbënte një interpretim gjerësisht të papranueshëm të kuptimit të saktë të termit ‘afati sa më i shkurtër’.*

Një interpretim për këtë arsye

Do t'i bashkëngjiste Nenit 5(3) një dobësim të rëndë të një garancie procedurale në dëm të individit dhe do të përfshinte pasoja që rrezikojnë tamam thelbin e së drejtës që garantohet në këtë klauzolë.

153. Koster kundër Vendeve të Ulta dhe De Jong, Bajlet dhe Van den Brink kundër Vendeve të Ulta, përkatësisht.

Kështu nuk ishte e pazakontë që në një çështje tjetër në lidhje me problemet e shkaktuara nga terroristët Gjykata konstatoi se ndalimi për dymbëdhjetë deri katërbëdhjetë orë pa iu nënshtruar gjykimit ishte i papranueshëm<sup>154</sup>.

Në çështjet në lidhje me ndalimin e ushtarëve për kundravajtje ushtarake, megjithëse Gjykata kishte bërë disa lëshime për kërkesat në lidhje me jetën ushtarake<sup>155</sup>, ajo përsëri u mbështet në kushtin e afatit të shkurtër kohor për të dhënë gjykimin.

Heqja e lirisë përpara autorizimit gjyqësor për vazhdimin e masës së ndalimit nuk duhet të zgjasë më shumë se nevojitet për qëllimet e ndjekjes penale të një të dyshuari. Elementet kryesore të ndjekjeve të tilla penale do të përfshijnë nevojën për të: sjellë personin në rajonin e policisë kur ai ose ajo është ndaluar në një vend tjetër; mbledhur ndonjë provë ligjore përkatëse nga ai person; bërë një intervistë për të konfirmuar identitetin e tij ose të saj dhe për të parë nëse dyshimet fillestare mund të lehtësojnë masën e ndalimit për më vonë si dhe për të përcaktuar vendndodhjen e provave që janë në rrezik pasi në të kundërtën mund të zhduken; parandaluar që të dyshuarit e tjerë që do të ndalohen të vihen në dijeni dhe të arratisen; sjellë personin e dyshuar në gjykatë nga stacioni i policisë. Megjithëse koha e saktë që duhet për këto masa paraprake (në kundërshtim me hetimin e plotë) do të variojë në bazë të rrethanave të çështjeve individuale, duhet të jetë e kuptueshme kur merret parasysh i tërë drejtimi i çështjeve që ato të shqyrtohen

që të gjitha brenda një ose dy ditësh dhe kjo reflektohet në përdorimin e një periudhe të tillë kohore në afatet e përcaktuara për çështjet penale si dhe nga Komisioni Evropian duke konsideruar nxjerrjen e të ndaluarit para një gjykate brenda kësaj periudhe si joproblematike<sup>156</sup>.

Fakti se intervali në një çështje të caktuar midis ndalimit dhe gjykimit e ka tejkaluar këtë periudhë nuk do të rezultojë direkt në shkelje të standartit ndërkombëtar, por duhet të tregohet se ka qënë një pasojë e nevojshme e rrethanave specifike afati kohor i tejzgjatuar me qëllim që të konsiderohet i pranueshëm. Një situatë e tillë mund të konsiderohet se është hasur kur ndalimi ka ndodhur në disa vende që kanë qënë më shumë se një ditë larg nga stacioni i më i afërt i policisë<sup>157</sup> ose kur ka ndodhur një arrestim veçanërisht i komplikuar që përfshin shumë të dyshuar ose kur marrja e provave jetësore nga një i dyshuar kërkon një kohë të konsiderueshme (si për shembull kur është gëlltitur) ose kur sëmundja e të pandehurit e ka bërë të pamundur paraqitjen e tij në gjyq gjatë kohës kur ai ka qënë në spital<sup>158</sup>. Gjithsesi, ideja e marrjes së shpejtë të vendimit mbi ndalimin që njihet si kritike nga Gjykata Evropiane do të kishte humbur në shumicën zotëruese të çështjeve nëse vonesa në sjelljen e dikujt para gjyqtarit ka kaluar dyzet e tetë orët e lejuara me më shumë se disa orë të tjera dhe nëse periudha kohore që është tejkaluar do të konsiderohet si normë nga e cila duhet të përcaktohet nevojja për fleksibilitet.

E rëndësishme është që të merret parasysh

154. Sakik dhe të tjerë kundër Turqisë, 26 Nëntor 1997.
155. Ashtu si në çështjet De Jong, Baljet dhe Van den Brink, Koster, Van der Sluijs, Zuiderveld dhe Klappe kundër Vendeve të Ulta.
156. X kundër Mbretërisë së Bashkuar, X kundër Belgjikës.
157. Shih çështjen Rigopoulos kundër Spanjës.
158. X kundër Belgjikës.

se praktikat e ndjekjes penale të një çështjeje nuk do të konsiderohen se janë zgjatur në mënyrë të justifikueshme për shkak të pengesave institucionale ose procedurale të cilat janë kapërcyer me planifikimin dhe riorganizimin e duhur. Kështu në çështjen *Koster kundër Vendeve të Ullta* u konstatua shkelje e Nenit 5 (3) megjithëse ishte pretenduar se manovrat ushtarake kishin ndaluar që i ndaluar të sillej para një gjykate ushtarake për pesë ditë. Gjykata u tregua e prerë sepse manovrat ushtarake nuk ishin të papritura por ndodhën

*në intervale periodike dhe si rrjedhim ishin të parashikueshme dhe ato në asnjë mënyrë nuk ndaluan autoritetet ushtarake që të siguronin faktin që Gjykata Ushtarake të kishte mundësi të mblidhej me shpejtësinë e mjaftueshme për të përmbushur kushtet e Konventës, nëse ishte e nevojshme edhe ditën e shtunë ose të djelë.*

E njëjta përgjigje pa dyshim që lind nëse shkurtimet në radhët e gjyqtarëve do të ngriheshin si pretendim, përveç kur kjo ishte një problem i përkohshëm shkaktuar nga sëmundjet (si për shembull epidemi gripi). Kjo nënkupton gjithashtu se kur hasen pushime publike, ato nuk mund të përdoren për të zgjatur periudhën e kohës përparas se një i ndaluar të sillej para një gjyqtari. Gjykata iu referua në mënyrë të qartë mbajtjes së seancave gjyqësore në fundjavë që nënkuptonte mjaft qartë për një Shtet se ai ka përgjegjësinë për të siguruar që mund të jetë një gjyqtar në dispozicion për atë kohë që të ushtrojë kompetenca gjyqësore mbi ndalimin e një personi

kur gjykatat janë përgjithësisht të mbyllura. Arsyejimi në këtë kuadër është i zbatueshëm nëseoj përsa i përket afatit kohor të një ndalimi; fakti që fillon pas mbylljes së zakonshme të orarit të punës në gjykata nuk përbën në vetvete një justifikim për të shtyrë sjelljen e një personi të caktuar para gjyqtarit në ditën pasardhëse të punës. Në një rast të tillë duhet të ketë në dispozicion gjyqtarë për të gjykuar mbi masën e ndalimit mbrëmjen ose natën pasuese. Cilido vështrim buxhetor nuk mund të japë ndonjë justifikim për mungesën e gjyqtarëve të mjaftueshëm për të ushtruar masën e gjykimit mbi ndalimin.

#### 4. Rastet e emergjencës

Situata në të cilën ndodhi ndalimi në çështjen *Brogan* ishte një emergjencë e padeklaruar dhe si e tillë nuk mund të argumentohet se mund të justifikoheshin pamundësitë për të qenë në përputhje me Nenin 5 (3) duke iu referuar një cënimi sipas Nenit 15 të Konventës Evropiane. Megjithatë, vendimi në *Brogan* rezultoi në faktin që Mbretëria e Bashkuar kishte kryer një shkelje dhe efektiviteti i kësaj shkeljeje më pas u hetua nga Gjykata Evropiane në *Brannigan dhe McBride kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>159</sup>. Intervallet midis ndalimit dhe gjykimit në këtë çështje është radhitur nga katër ditë, gjashtë orë e njëzetë e pesë minuta deri në gjashtë ditë e katërmbëdhjetë orë e gjysëm. Gjykata në fakt i pranoi të dyja dhe se ekzistonte një emergjencë e qartë e

ndalimi për deri në shtatë ditë pa gjykim do të përmbushte kufijtë e lejueshëm të një shkelleje. Në këtë kuadër, ajo u ndikua veçanërisht nga shqetësimet e Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me natyën e ndjeshme të informacionit që mund të duhej të zbulohet në një gjykim të dhënë për masën e ndalimit dhe riskut që përfshirja në gjykim në zgjatjen e masës së ndalimit mund të dëmtojë në besimin e publikut në pavarësinë e sistemit gjyqësor, aq më pak se ish-in të paktë në numër dhe të ndjeshëm ndaj sulmeve terroriste. Pranueshmëria e kufizimit në këtë çështje u justifikua gjithashtu nga disponueshmëria e vazhdueshme e *habaes corpus* (që nuk kërkon zbulimin e të njëjtave detaje për bazën mbi të cilën është ndaluar një individ) dhe e drejta absolute për të pasur një avokat pas dyzet e tetë orësh mase ndalimi. Megjithëse ky qëndrim u kundërshtua nga oponenti rigoroze e katër prej gjyqtarëve të Gjykatës, tregoi se ka rrethana në të cilën mund të shtyhet gjykimi i menjëhershëm mbi masën e ndalimit për një periudhë të konsiderueshme. Panvarësisht se natyra përjashtuese e një hapi të tillë theksohet si nga nevoja për të provuar që ekziston me të vërtetë një rast emergjence - që në vetvete duhet t'i nënshtrohet gjykimit - dhe rëndësisë që i bashkëngjitet ekzistencës së garancive të tjera kundrejt abuzimit të mundshëm me ndjeshmërinë e atyre personave që ndalohen. Gjithashtu gjykimi i çështjes nuk autorizoi një pezullim të pakufizuar të gjykimit; shtatë ditë ishte maksimumi i lejueshëm. Rëndësia e një afati të tillë u tregua në çështjet vijuese ku natyra

dhe shkalla e rrezikut të një kërcënimi terrorist nuk ishin të mjaftueshme për të justifikuar ndalimin pa kontroll gjyqësor për periudhat nga katërmëdhjetë në njëzet e tre ditë<sup>160</sup> panvarësisht nga kufizimi që i bëhet sipas Nenit 15. Në të dyja rastet qeveria turke parashitroi se hetimi për aktivitetet terroriste parashikonte probleme të veçanta për autoritetet, por Gjykata konstatoi se nuk ishte ofruar asnjë arsyetim në fjalë për shkakun pse hetimi duhet të paragykohej nga mbikqyrja gjyqësore e masës së ndalimeve. Një bazë tjetër në të dyja çështjet për moslejimin e Turqisë që të pretendonte kufizimin si justifikim për të mos qenë në pajtim me Nenin 5 (3) ishte mungesa e garancive të duhura alternative; të ndaluarit nuk kishin akses për avokat dhe doktor (përveçse në baza mjaft të kufizuara në *Demir*) ose për të afërmit dhe miqtë dhe nuk kishte mundësi reale për të testuar ligshmërinë e ndalimit të tyre në gjykatë. Megjithëse në *Demir* ekzistonte mundësia e ankimi që do të parashitrohej nga avokati i kërkuesit, kjo refuzohej pa dyshim si garanci kundrejt trajtimit arbitrar pasi personat e ndaluar ishin mbajtur pa mundur të komunikonin me të tjerë dhe si rrjedhim ishin privuar nga të gjitha llojet e kontaktimit. Gjithsesi nuk ka gjasa për të mbështetur faktin se edhe prezenca e garancive si ato që u konstatuan në *Brannigan dhe McBride* mund të kishte justifikuar ndalimin pa gjykim për periudhat e zgjatura që përfshihen në këto dy çështje; sa më shumë zgjat mungesa e hetimit, aq më i lartë është risku i arbitraritetit dhe ka më pak mundësi që një ndalim i tillë

160. Aksoy kundër Turqisë, 18 Dhjetor 1996 dhe *Demir* dhe të tjerë kundër Turqisë, 23 Shtator 1998.

në vetvete do të ishte si pasojë e gjendjes së emergjencës panvarësisht sesa i rëndë mund të ishte ai.

Hetimi gjyqësor luan një rol të rëndësishëm në sigurimin që risku i ndalimit arbitrar të minimizohet. Arbitrariteti është një karakteristikë e domosdoshme e çdo mase ndalimi që nuk mund të justifikohet në mënyrë objektive dhe kjo nuk do të ishte e mundur kur autoritetet që merren me ndalimin e personit do të kenë përfunduar të gjitha masat e duhura paraprake në mënyrë që të jenë në pozitë të tillë që të parashtrajnë çështjen për vazhdim tek një gjyqtar, por që nuk ia dalin ta bëjnë këtë gjë për një periudhë kohore. Ky përfundim do të ishte njësoj i zbatueshëm kur trajtimi i një çështjeje do të ishte qartësisht ngadalësues dhe si rrjedhojë koha që duhet për të sjellë çështjen para gjyqtarit do të jetë më e gjatë sesa nevojitet për çështje të tjera të krahasueshme që trajtohen në të njëjtën mënyrë.

Kjo pikëpamje u përforcua nga njohja që i bëri Gjykata Evropiane faktit që nevoja për gjykim do të lindë vetëm kur ekziston një vullnet nga ana e autoriteteve për të vazhduar masën e ndalimit. Ashtu si u bë e qartë në çështjen *De Jong, Bajlet dhe Van den Brink kundër Vendeve të Ullta*, nuk do të ketë shkelje të Nenit 5 (3)

*nëse personi i ndaluar do të lirohet “brenda një afati sa më të shkurtër” përpara se të bëhet i zbatueshëm kontrolli gjyqësor i ndalimit të tij.*

Po kështu, në *Brogan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata vuri theksin mbi faktin se Shteti kishte detyrimin që ose

*“të siguronte një lirim brenda një afati sa më të shkurtër ose një paraqitje sa më të shpejtë përpara një gjyqtari të personit të ndaluar”.*

Nuk ka nevojë që lirimi të marrë aprovimin gjyqësor. Kjo do të nënkuptojë qartë që ka një detyrim të vazhdueshëm mbi autoritetet që zbatojnë masën e ndalimit gjatë gjithë periudhës së ndalimit që të vendosin nëse vazhdimi i masës së ndalimit është vërtet i justifikuar dhe nëse jo, të lirojnë personin e përfshirë. Gjithashtu, kjo mënyrë i përgjigjet arsyetimit të vazhdimit të mbajtjes së një personi në masën e ndalimit në pritje të gjykimit, d.m.th. pas gjykimit fillestar. Siç është vërejtur edhe më parë, zgjatja e masës së ndalimit përpara gjykimit mund të justifikohet vetëm përsa kohë që ekzistojnë arsytet e duhura e të mjaftueshme për të bërë një gjë të tillë. Duke qënë se kërkesa kryesore është që të parandalohet masa e ndalimit të panevojshëm, ajo vijon se do të ketë shkelje të detyrimit specifik për të sjellë dikë “brenda një afati të arsyeshëm” para një gjyqtari kur autoritetet që zbatojnë ndalimin sillen në mënyrë të tillë që bëjnë të mundur që kjo të ndodhë më vonë sesa duhej duke pasur parasysh rrethanat specifike të çështjes. Ashtu si çështja që është veçanërisht e komplikuar ose që përfshin sistemin ushtarak do të kërkojë pak më shumë kohë sesa një çështje e zakonshme, ashtu edhe do të nevojitet më pak kohë kur çështja është jashtëzakonisht e thjeshtë dhe nuk ekzistojnë praktika që do të ndalojnë personin e përfshirë që të paraqitet direkt e një gjykatë.

Vëzhgimi i kërkesës së “sjelljes në gjykatë



brenda një afati sa më të shkurtër të personit” mbetet një garanci jetësore kundrejt ndalimit që është ose arbitrar nga pikëpamja e përgjithshme, ose bëhet i tillë me kalimin e kohës dhe me ndryshimin e rrethanave të çështjes. Nuk ka asnjë kusht që autoritetet e zbatimit të ndalimit të përshpejtojnë një çështje nëpërmjet masave paraprake përpara se i ndaluarit të sillet para një gjyqtari, por ka padyshim një detyrim për të qenë të kujdesshëm, përkatësisht për të siguruar që të ndodhë sa më shpejt që të jetë praktikisht mundur dhe sigurisht jo më vonë se afati që është diskutuar edhe më sipër.

## 5. Mbikqyrja e vazhdueshme

Një këndvështrim përfundimtar në këtë aspekt të mbikqyrjes gjyqësore (gjykimit) është rishikimi periodik ku gjyqtari vendos që vazhdimi i ndalimit është i justifikuar. Kjo domosdoshmërisht që ndiqet nga çështja e diskutuar më sipër që rrethanat mund të ndryshojnë dhe, ndërsa motivet për ndalimi mund të ekzistojnë në fazat e hershme të një hetimi, mund të mos mbështetet më çështja në to në një fazë të mëvonshme. Kështu është përgjegjësia e autoriteteve zbatuese të ndalimit që të parashtrajnë çështjen për ndalim mbikqyrjes gjyqësore në intervale të përhershëm dhe këto intervale nuk duhet të kalojnë një muaj apo dy. Pa këtë mbikqyrje të vazhdueshme – e cila duhet të jetë rigorozë sa në fillim të shqyrtimit të çështjes –

një person mund të mbahen në masën e ndalimit kur kjo nuk do të jetë në pajtim me Konventën. Në *Jecius kundër Lituanisë* arsyet e vetme që u dhanë për ndalimin e kërkuesit në pritje të gjykimit ishin rëndesa e veprës penale dhe forca e provave kundër tij në arkivin e çështjes. Gjykata u shpreh se dyshimi kundër kërkuesit se kishte kryer vrasje mund të kishte justifikuar ndalimin e tij fillimisht, por jo ndalimin e tij për gati pesëmbëdhjetë muaj, veçanërisht kur dyshimi u verifikua u provua jo i bindshëm nga gjykata që e nxorri kërkuesin të pafajshëm dhe si rrjedhojë konstatoi ndalimin e tij si të tepruar.

## Pjesa VI: Ndërmarrja e procedurave kundër ligjshmërisë së ndalimit

Përveç mbikqyrjes gjyqësore sipas Nenit 5 (3) që duhet të dalë nga autoritetet zbatuese të masës së ndalimit, Neni 5 (4) garanton mundësinë e të ndaluarit për të ndërmarrë procedura për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit para një gjyqtari, që duhet të vendosë me shpejtësi dhe të urdhërojë lirim nëse ndalimi konstatohet i paligjshëm. Kërkesa në Nenin 5 (4) është që të ketë gjendet diçka e krahasueshme me *habeas corpus* në mënyrë që të testohet ligjshmëria e ndalimit të një personi. Elementët bazë të detyrimit në këtë klauzolë janë që mbikqyrja duhet të kryhet nga një gjykatë, duhet të përfshijë një seancë gojore me asistencë ligjore në vënien në dijeni të palëve mbi provat dhe dëshmitë reciprokisht, duhet t'i drejtohet ligjshmërisë së ndalimit në kuptimin më të gjerë dhe duhet të kryhet me shpejtësi.

Detyrimi në Nenin 5 (4) zbatohet kurdo që jepen motivet për ndalim. Autoritetet vendase duhet të sigurojnë rekursin në gjyq për të gjitha çështjet duke përfshirë edhe ato që justifikohen sipas Nenit 5 (1) <sup>161</sup>.

### 1. Nevoja për t'iu drejtuar një gjykatë

Referimi i qartë që i bëhet gjykatës në Nenin 5 (4) përjashton çdo debat në lidhje me faktin nëse ky është një problem që mund të përcaktohet nga një prokuror. Në *Vodenicarov kundër Sllovakisë*, Gjykata u shpreh se mundësia e hapur për kërkuesin që të kërkonte zhdëmtin përpara prokurorit publik nuk mbushte kërkesat e Nenin 5 (4) pasi "procedurës së ndjekur nga një prokuror i mungon karakteri gjyqësor"<sup>162</sup>. Në *Varbanov kundër Bullgarisë*, ndalimi i kërkuesit u urdhërua nga një prokuror rrethi i cili më pas u bë palë në ndjekjen penale kundër tij duke kërkuar mbylljen në çmëndinë të kërkuesit. Urdhri i prokurorit të rrethit iu nënshtrua apelimit vetëm tek prokuroria e lartë. Këtu Gjykata konstatoi se kërkuesi ishte privuar nga e drejta e tij për të rishikuar ligjshmërinë e ndalimit të tij nga një gjykatë në kundërshtim me Nenin 5 (4) <sup>163</sup>.

Është thelbësor që procesi gjyqësor të bëhet para një gjyqtari dhe të përmbushë të gjitha kërkesat për një proces të drejtë gjyqësor të Nenit 6, por veçanërisht ato që kanë lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Kushti i pavarësisë sigurisht që nuk do të përmbushet nëse rishqyrtimi i ndalimit kryhet nga një autoritet që në njëfarë mënyrë i përgjigjet ekzekutivit. Kushti i paanshmërisë do të jetë i dyshueshëm nëse gjyqtari në njëfarë mënyrë ka qenë i përfshirë në çështje, për shembull, duke

161. Sidoqoftë, aplikimi i tij sipas Nenit 5(1) (f) dhe (a) është i kufizuar.

162. 21 Dhjetor 2000.

163. 5 Tetor 2000.

rënë dakort që të kërkohet ndalimi para gjykimit i personit në fjalë pas arrestimit të tij fillestar. Kjo nuk ka bërë që Gjykata të konstatojë si të papranueshëm kryerjen e këtij funksioni nga një gjyqtar hetues megjithëse mund të duket se ka konflikt midis interesit të një gjyqtari të tillë për të kryer me efikasitet hetimin dhe të qënurit të hapur ndaj ngritjes së një pretendimi se i akuzuari duhet të lirohet. Në çdo rast, cilado qoftë natyra e gjykatës, ajo duhet të jetë e tillë që të ketë kompetencën për të urdhëruar lirimin e një personi të ndaluar; nëse kufizohet vetëm me nxjerrjen e rekomandimeve ose sigurimin e mjeteve të tjera për ndalimin e paligjshëm (si për shembull në *Van Droogenbroeck kundër Belgjikës* ku një dënim penal mund të imponohej tek nëpunësi përgjegjës), atëherë ajo nuk do të përmbushë kërkesat e Nenit 5 (4). I gjithë këndvështrimi i kësaj dispozite është që një person duhet të jetë në gjendje të sigurojë lirimin e tij apo të saj nëse ndalimi provohet se është i paligjshëm.

## **2. Paraqitja personalisht para një gjykate**

Ashtu siç është treguar edhe më sipër, një nga përfitimet e mbikqyrjes gjyqësore është që abuzimet, përveç ndalimit të paligjshëm, mund të zbulohen dhe kjo vjen në veçanti nga kërkesa që një person i ndaluar normalisht duhet të sillt para një gjykate me qëllim që të përcaktohet nëse

ndalimi është i ligjshëm. Kështu u konstatua një shkelje e Nenit 5 (4) në çështjen *Kompanis kundër Greqisë*, kur një person i ndaluar i mbajtur nën arrest në lidhje me një mashtrim të supozuar nuk ishte lejuar që të paraqitej para një gjykate kur kjo ishte e mundur në bazë të kodit të procedurës penale. Gjykata theksoi rëndësinë e faktit që i ndaluari ishte në gjendje t'u rezistonte pretendimeve të prokurorit në lidhje me ndalimin e tij sepse ai ngriti pretendimin se ndalimi ishte në mospërputhje me ligjin dhe sepse paraqitja personalisht para një gjykate ul mundësinë për abuzim në vendimin mbi ndalimin.

## **3. Aksesi për këshillim ligjor, për vënien në dijeni të provave të palëve reciprokisht dhe për barazi në mjete**

Ka shumë mundësi që në çështjen e liritimit bazat për këtë pretendim të përfshijnë probleme të vështira ligjore dhe shumica e të ndaluarve nuk janë në gjendje të jenë në një pozicion të tillë që të përgatisin të gjitha argumentet e nevojshme. Kështu lind një pasojë e pashmangshme që një të ndaluar duhet t'i garantohet aksesi për asistencë ligjore me qëllim që të kundërshtojë një vendim. Në rastet kur i ndaluari nuk e përballon dot një avokat shpenzimet për një të tillë duhet t'i takojnë Shtetit. Në *Ëoukam Moudefo kundër Francës* Gjykata konstatoi një shkelje të Nenit 5 (4) sepse

të akuzuarit nuk i ishte akorduar një avokat për apelim për lirimin e tij në Gjykatën e Kasacionit kur apelimi përfshinte çështje ligjore për diskutim. Po kështu në *Megyeri kundër Gjermanisë* Gjykata u shpreh se një person i ndaluar që ishte me çrregullime mendore kishte të drejtën e përfaqësimit ligjor në seancat gjyqësore, përveç kur rrethanat specifike sygjerojnë për të kundërtën. Gjithashtu, Gjykata u shpreh se personit në fjalë nuk duhet t'i kërkohet që të marrë inisiativën për të gjetur asistencë ligjore.

Nevoja për asistencë shkon përtej përgatitjes për një pretendim dhe përfshin përfaqësimin në procedurat para gjykatës. Këto procedura gjithashtu duhet të jenë të hapura dhe t'i referohen kërkesave të barazisë në mjete që Gjykata e ka analizuar kur është vënë në zbatim Neni 6: kjo do të thotë që personi që kërkon lirimin e tij duhet të jetë në dijeni të pretendimeve të bëra për të justifikuar ndalimin e tij, duke përfshirë provat mbështetëse dhe duhet të ketë mundësinë për t'u përgjigjur atyre. Është tërësisht e papranueshme që siç ndodhi në *Toth kundër Austrisë* gjykata të dëgjonte vetëm palën akuzuese në mungesë të të ndaluarit. Po kështu u konstatua shkelje e Nenit 5 (4) në *Lamy kundër Belgjikës* ku avokati i Shtetit kishte akses në dosjen zyrtare në përgatitjen e çështjes por i ndaluarit nuk e kishte këtë akses. Një mundësi e drejtë për përgatitjen e një çështjeje do të nënkuptojë gjithashtu se i ndaluarit duhet të ketë kohën e mjaftueshme në dispozicion për këtë qëllim; nëse mundësia e kundërshtimit të vendimit është shumë e shpejtuar, atëherë

rregullimi i vendimit do të jetë më shumë i dukshëm se i vërtetë. Gjithashtu, të ndaluarit duhet t'i lejohet aksesi për mjetet e nevojshme që i duhen për të përgatitur çështjen e tij apo të saj; kjo mund të nënkuptojë sigurimin e librave ligjorë, mundësinë për të përgatitur parashtrimin e një çështjeje (që mund të ndikojë në mëyrën sesi zbatohet regjimi i burgut) dhe sigurisht mundësinë për të diskutuar mbi çështjen me avokatin e tij pa prezencën e autoriteteve zbatuese të ndalimit.

Në *Niedbala kundër Polonisë*, Gjykata u shpreh se megjithëse nuk ishte gjithmonë e nevojshme që procedura e bazuar në Nenin 5 (4) të ndiqej nga një njëjtat garanci si ato të kërkuara nga Neni 6 (1), gjithsesi duhet që të "ketë një karakter gjyqësor dhe të parashikojë garancitë e duhura për heqjen e lirisë në fjalë". Gjykata më tej u shpreh se

*në veçanti, në proceset gjyqësore në të cilat merret në shqyrtim apelimi kundër urdhrin të ndalimit duhet të sigurohet "barazia në mjete" midis palëve, palës akuzuese dhe personit të ndaluar.<sup>164</sup>*

Në çështjen e *Niedbala*, Gjykata konstatoi se ligji në fuqi në atë kohë nuk i jepte të drejtën kërkuesit ose avokatit të tij për të ndjekur seancën gjyqësore dhe nuk kërkonte që parashtrimi i pretendimit të dhënë nga pala akuzuese që mbështeste ndalimin e kërkuesit t'i komunikohet kërkuesit ose avokatit të tij. Rrjedhimisht, kërkuesi nuk kishte mundësinë që të bënte komente mbi argumentet e akuzës. Gjithashtu, ndërsa kërkuesi ose avokati i tij nuk kishin të drejtën e ndjekjes së

164. Shih gjithashtu çështjen *Nikolova kundër Bullgarisë*, 25 Mars 1999.

seancave gjyqësore në të cilat gjykata shqyrtonte ligjshmërinë e ndalimit, ligji në fuqi në atë kohë lejonte që akuzat të kishte këtë të drejtë. Kështu, Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 5 (4)<sup>165</sup>.

Në *Ilijkov kundër Bullgarisë*, Gjykata rikujtoi procesin gjyqësor nga i cili shqyrtohet apeli kundër ndalimit “që duhet të jetë i hapur për palët dhe duhet të sigurojë në mënyrën e duhur ‘barazinë në mjete’ midis palëve, palës akuzuese dhe personit të ndaluar”. Duke qënë se në procesin gjyqësor para Gjykatës së Lartë autoritetet e akuzës kishin privilegjin që t’i drejtoheshin gjyqtarit me argumente të cilat nuk i ishin komunikuar kërkuarit, këto seanca nuk ishin të hapura reciprokisht dhe shkelnin Nenin 5 (4)<sup>166</sup>.

#### 4. Përcaktimi i ligjshmërisë së një vendimi

Kur gjykohet nëse janë përmbushur kërkesat e Nenit 5 (4), koncepti i ligjshmërisë është gjithnjë i lidhur me pajtueshmërinë me standartet e Konventës. Personi i ndaluar duhet të ketë mundësinë që të kërkojë nëse ndalimi i tij është në pajtim me ligjin vendas dhe Konventën e nëse nuk është arbitrar. Kështu nëse dikush ndalohet se ka bërë një deklaratë që thuhet se është me qëllim shpifës, duhet të jetë e hapur ngritja e pretendimit me argumentin se, duke qënë se vepra është e papajtueshme me të drejtën

165. 4 Korrik 2000. Konstatime të ngjashme në çështjen *Trzaska kundër Polonisë*, 11 Korrik 2000; *Kawka kundër Polonisë*, 9 Janar 2001.

166. 26 Qershor 2001.

për lirinë e shprehjes sipas Konventës, ndalimi përpara gjykimit për këtë veprë nuk do të mund të justifikohet. Kjo shkon më tej se supozimi që nuk ka urdhër ndalimi ose që ai urdhër është ushtruar në mënyrën e gabuar. Më tej, është thelbësore gjithashtu që procedura të mundësojë të ndaluarin që të kundërshtojë arsyetimin e çdo lloj dyshimi mbi supozimin e kryerjes nga ana e tij së veprës në fjalë.

Në *Jecius kundër Lituanisë* Gjykata rikujtoi se *Neni 5 (4)*

*u jep të drejtën personave të ndaluar apo arrestuar për të rishqyrtuar vendimin duke u bazuar në kushtin procedural e substantiv që është thelbësor për “ligjshmërinë”, në kuptimin e Konventës, të heqjes së lirisë së tyre. Kjo do të thotë që gjykata kompetente duhet të shqyrtojë jo vetëm pajtueshmërinë me kërkesat procedurale të ligjit vendas, por gjithashtu edhe arsyetimin e dyshimit që mbështet arrestimin dhe ligjshmërinë e qëllimit që ndiqet nga arrestimi si dhe ndalimin që rrjedh nga ajo.*

Në këtë çështje Gjykata vërejt se gjykatat që autorizuan ndalimin në pritje të gjykimit të kërkuarit nuk iu referuan ankimit të kërkuarit mbi paligjshmërinë e ndalimit të tij. Gjithashtu, gjykatat e shkallëve më të larta, megjithëse njohën faktin se ligjshmëria e ndalimit të kërkuarit ishte e hapur për diskutim, nuk arritën të shqyrtonin ankesën e tij duke iu referuar përjashtimeve statutoare që ishin atëherë në fuqi.

Në një çështje të fundit të *Ilijkov kundër Bullgarisë*, Gjykata deklaroi se ndërsa *Neni 5*

(4) nuk kërkon që gjyqtarët t'i drejtohet çdo argumenti në parashtrimin e deklaratës së kërkuesit kur të marrin në shqyrtim ligjshmërinë e një ndalimi, e drejta sipas Nenit 5 (4) do të privohet nga thelbi i saj nëse gjyqtari nuk merr në konsideratë ose trajton si të parëndësishme fakte konkrete që pretendohen nga i ndaluari, të cilat do të mund të hedhin dyshimin mbi ekzistencën e kushteve bazë për "ligjshmërinë" në kuptimin e Konventës. Në çështjen në fjalë, gjykatat kishin refuzuar që të merrnin në konsideratë argumentet e kërkuesit dhe provave mbështetëse në lidhje me vazhdimin e një dyshimi të arsyetuar kundër tij, duke argumentuar se nëse ato do të bënin komente mbi këto çështje, ata do të paragjykonin meritat e çështjes penale e si rrjedhojë do të bëheshin të njëanshëm. Sipas ligjit bullgar, vendimet mbi ndalimin e të akuzuarit i besohen të njëjtit gjyqtar që do të shqyrtojë meritat e çështjes. Gjykata deklaroi se

*Fakti i thjeshtë se një gjyqtar ka marrë vendime mbi ndalimin në pritje të gjykimit nuk mund të konsiderohet se ka justifikuar shqetësimin se ai nuk është i paanshëm. Zakonisht pyetjet që gjyqtari duhet t'u përgjigjet kur vendos mbi ndalimin në pritje të gjykimit nuk janë të njëjta me ato që janë vendimtare për marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e tij. Kur merr një vendim të tillë dhe vendime të tilla para gjykimit gjyqtari në përgjithësi bën vlerësimin e të dhënave që janë në dispozicion për të siguruar nëse pala akuzuese ka motive prima facie për dyshimin që mbështet; kur shpall vendimin në përfundim të*

*gjyqit, ai duhet të shqyrtojë nëse prova e dhënë dhe e debatuar në gjyq është e mjaftueshme për të shpallur fajtor të akuzuarin.*

Në vijim të këtij argumenti Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 5 (4) pasi qëllimi i autoriteteve për të respektuar parimin e paanshmërisë nuk mund të justifikonte kufizimin e imponuar mbi të drejtën e kërkuesit sipas kësaj dispozite.

## **5. Vendimet duhet të merren me shpejtësi**

Duke pasur parasysh prezumimin kundër heqjes së lirisë që është diskutuar tashmë, nuk është e habitshme që Neni 5 (4) kërkon gjithashtu që çdo vendim përsa i përket faktit nëse ndalimi është i ligjshëm duhet të ndodhë "me shpejtësi". Kjo pa dyshim që nuk ka si qëllim që të jetë aq i prerë sa kushti i "afatit sa më i shkurtër kohor" në Nenin 5 (3) dhe kjo nuk është e habitshme pasi çështjet ligjore mund të komplikohen më shumë kur ngriten për t'u trajtuar në bazë të Nenit 5 (4). Kështu nuk ka dyshim se një interval prej një ose dy javësh midis aplikimit dhe vendimit për të do të konsiderohet si i pranueshëm në shumë çështje. Megjithatë, ekziston një shqetësim në lidhje me kohëzgjatjen e intervalit kur ngrihet pretendimi kundër ligjshmërisë së ndalimit nga kërkuesi dhe kur një autoritet gjyqësor nuk ia ka dalë mbanë të jetë në pajtim me kushtin e gjykimit brenda një afati sa më të shkurtër të Nenit 5 (3).

Megjithëse ka liri të gjerë veprimi për të

vendosur secili është intervali i pranueshëm midis ndalimit fillestar dhe gjykimit sipas Nenit 5 (4), është e qartë nga një gamë e gjerë çështjesh se, panvarësisht nga lëshimet që duhen bërë për çështje veçanërisht të komplikuar, afati kohor nuk duhet të jetë më i gjatë se disa javë. Periudhat që kalojnë muajin janë dënuar janë deklarur të pavlefshme në një sërë çështjesh si për shembull në *Bezicheri kundër Italisë* dhe *Sanchez-Reisse kundër Zvicrës*. Vonesat që i atribuohen faktorëve të tillë si pushimet e gjyqtarit ose mbingarkesa e punës së tij nuk do të jenë të pranueshme. Nga ana tjetër, vonesat që i atribuohen personit të ndaluar nuk do të konsiderohen: shembuj këtu janë *Navarra kundër Francës*, ku kërkuesii iu nevojiti një kohë e konsiderueshme për të paraqitur apelin, dhe *Luberti kundër Italisë*, ku personi i ndaluar aktualisht u zhduk. Është e rëndësishme që të vihet re se nëse do të nevojitet një vendim mbi dhënien e asistencës ligjore një personi të ndaluar, ai vendim duhet të merret me shpejtësi; shtatë javë u konsideruan si mjaft të gjata në çështjen *Zamir kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

Për qëllimet e Nenit 5 (4) afati kohor fillon kur ngrihen pretendimet e procesit kundër ligjshmërisë së ndalimit dhe përfundon kur është marrë vendimi përfundimtar mbi masën e ndalimit. Gjithsesi, mund të konstatohet shkelje e Nenit 5 (4) kur një person i ndaluar duhet të presë për një periudhë kohore përpara se të merret një masë e të vihet në dispozicion të tij.

Ashtu si u shpjegua më lart, vendimi mbi procedimin e shpejtë varet nga rrethanat specifike

të një çështjeje. Në *Iloëiecki kundër Polonisë*, Gjykata deklaroi se komplikimi i problemeve mjekësore e të tjera që përfshiheshin në përcaktimin e ligjshmërisë së ndalimit mund të jenë faktorë që duhen marrë parasysh. Gjykata deklaroi më tej se

*Kjo nuk do të thotë se gjithsesi komplikimi i dosjes së dhënë, dhe në raste përjashtuese, i çliron nga detyrimi i tyre thelbësor autoritetet vendase në bazë të kësaj dispozite.*

Në këtë çështje Gjykata konstatoi se dhe nevoja e padiskutueshme për të marrë prova mjekësor gjatë procesit gjyqësor për të vlerësuar ligjshmërinë e ndalimit nuk do të mund të arsyetojë të gjithë kohëzgjatjen e ndalimit që ishte rreth nga tre deri në shtatë muaj për secilin pretendim të kërkuesit për lirim<sup>167</sup>.

Komplikimi i problemeve mjekësore të përfshirë në marrjen e vendimit mbi vazhdimin e masës së ndalimit u ngrit edhe në çështjen *Baranoëski kundër Polonisë*. Ndërsa Gjykata pranoi që ky mund të ishte një faktor që duhej marrë në konsideratë kur vendoset mbi shpejtësinë e vendimit, ajo vërejt se gjykatave i nevojiten rreth gjashtë javë për të marrë një raport mjekësor nga kardiologu, edhe një muaj tjetër për të marrë prova nga një neurolog dhe psikiatër dhe një muaj tjetër për të marrë të dhëna të tjera të paspecifikuara. Sipas këndvështrimit të Gjykatës këto intervale të gjata kohore nuk dukeshin se ishin në pajtim me kërkesën e “kujdesit të veçantë” që i duhej kushtuar çështjes dhe nxori përfundimin se ka pasur shkelje të Nenit 5 (4)<sup>168</sup>.

167. 4 Tetor 2001.



Kompleksiteti i një çështjeje nuk është ndeshur vetëm në rastin e *Jablonski kundër Polonisë* ku Gjykata konstatoi se një periudhë prej dyzetë e tre ditësh që u nevojiti për të marrë vendimin mbi ligjshmërinë e ndalimit ishte në kundërshtim me kërkesën e shpejtësisë në marrjen e një vendimi të tillë, duke pasur parasysh rrethanat specifike të çështjes. Argumenti i qeverisë polake se Gjykata e Lartë (që kërkohej të merrte vendim mbi çështjen në fjalë) kishte mbi mbingarkesë të madhe pune nuk u pranua nga Gjykata<sup>169</sup>. Gjithashtu, në çështjen *Rehbock kundër Sllovenisë*, Gjykata konstatoi se dy periudhat prej njëzet e tre ditësh që u deshëm për të marrë vendimin mbi kërkesat për lirim të parashtruara nga i ndaluar në fakt shkëlqin kushtin e marrjes së një vendimi me shpejtësi<sup>170</sup>.

## 6. Lidhja me Nenin 5 (3)

Siç u pa më lart, kërkesat e Nenit 5 (4) janë më të rëndësishme se ato të Nenit 5 (3), përkatësisht në lidhje me përfaqësimin ligjor dhe procedurën e vënies së ndërsjelltë në dijeni të provave të palëve, por nëse gjykimi që jepet nga Shteti përmbush këto kërkesa, atëherë gjykimi do të konsiderohet se përmbush detyrimin e parashtruar në Nenin 5 (4) të paktën për një periudhë kohore. Problemi qëndron përsa i përket mundësisë së ngritjes së pretendimit kundër ligjshmërisë së një ndalimi që nuk është një mundësi që jepet njëherë e përgjithmonë; me ndryshimin e rrethanave

të një çështjeje, mundësitë e një justifikimi të mëparshëm ligjor mbi ndalimin mund të bëhen të pazbatueshme. Kështu vijohet me faktin se duhet të ekzistojë një mundësi e vazhdueshme për ngritjen e pretendimeve kundër ligjshmërisë së një ndalimi përsa kohë që një person i nënshtohet masës së ndalimit. Kjo nuk do të thotë gjithsesi se i ndaluar duhet të jetë në gjendje të ngrëjë pretendimet e tij në çdo kohë; kjo do të çonte në paralizimin e sistemit së drejtësisë penale. Gjykata si rrjedhojë ka nxjerrë konkluzionin se mundësia e një kundërshtimi për masën e ndalimit duhet të bëhet në intervale që konsiderohen të arsyeshëm. Kjo në vetvete është një kontekst i ndryshueshëm dhe periudhat deri në një vit janë konsideruar të pranueshme kur një person u ndalua për shkak se ishte i sëmur mendor. Megjithatë kjo nuk duhet marrë si udhëzim për situata kur dikush është ndaluar në pritje të gjykimit dhe kur jurisprudenca parashikon periudha më të shkurtra kohore të përshtatshme për një situatë të tillë. Kështu nuk ka patur kundërshtime për një interval një muajor në çështjen *Bezicheri* dhe për periudha më të shkurtra kohore në çështje të tjera të cilat do të konsiderohen si të pranueshme. Problemi qëndron në faktin se gjykata vihet në pozicionin e testimit për të justifikuar ndalimin e një personi kur ai ka të ngjarë që të ketë motive për të argumentuar se ndalimi është i padrejtë dhe përpara dënimit kjo e rrit mundësinë me kalimin e javëve.

Të dy format e mbikqyrjes gjyqësore janë plotësuese të njëra tjetrës dhe përbëjnë kushtet

168. 28 Mars 2000.

169. 21 Dhjetor 2000.

170. 28 Nëntor 2000.

themelore të garantimit të lirisë personale të Konventës.

Abuzimi do të ishte i madh pa qënien e tyre. Ato nuk janë të dëmshme për një sistem drejtësie penale efektive pasi ai do të funksiononte mjaft mirë kur respektohet shteti ligjor.

## Pjesa VII: E drejta për kompensim

Neni 5 (5) kërkon që ata që kanë qënë viktime të arrestimit ose ndalimit në kundërshtim me dispozitat e tjera të këtij neni, do të kenë një të drejtë të zbatueshme për kompensim. Mungesa e një të drejte të tillë do të rezultojë në mënyrë të pashmangshme në detyrime për të nisur procesin gjyqësor për një pretendim të tillë në Gjykatën Evropiane. Kjo dispozitë, ashtu si edhe Neni 5 (4) është një tregues specifik i një detyrimi më të gjerë në Nenin 13 të Konventës për të siguruar një dëmshpërblim efektiv kur është shkelur ndonjë nga të drejtat e liritë themelore të individit.

Kushtet e Nenit 5 (5) nuk i lënë shtetit lirinë për të vendosur se cili autoritet do të merret me dhënien e dëmshpërblimit. Neni 5 (5) kërkon një dëmshpërblim para një gjykate në kuptimin që asaj t'i bashkëngjitet një vendim ligjor detyrues. Përsa i përket formës së procedurës civile me anë të të cilës mund të pretendohet e drejta për kompensim, autoritetet vendase gëzojnë një shkallë të drejtë lirie veprimi. Një dëmshpërblim i dhënë nga organe të tjera si për shembull Avokati i Popullit, ose një pagesë *ex gratia* nga qeveria nuk do të jetë i mjaftueshëm për qëllimet e Nenit 5 (5).

Në praktikë dëmshpërblimi do të konsistojë zakonisht në kompensim financiar. Ekziston një liri përcaktimi për shtete të ndryshme në lidhje me shumën e komensimit të pagueshëm por jo

përsa i përket elementeve të humbjes që duhen njohur në përcaktimin e një dëmshpërblimi. Përpara se të merret vendimi mbi kompensimin, autoritetet vendase mund të kërkojnë prova të dëmeve të shkaktuara që kanë rezultuar në shkelje të Nenit 5. Gjykata është shprehur se megjithëse një person mund të jetë viktimë e një shkeljeje të Nenit 5 “nuk mund të vihet në diskutim ‘kompensimi’ kur nuk ka dëme financiare apo jo-financiare për të kompensuar”.<sup>171</sup>

Dëmshpërblimi sipas Nenit 5 (5) do të kërkohej vetëm kur një viktimë e supozuar është arrestuar apo ndaluar në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e Nenit 5, paragrafi 1 deri në 4. Një pretendim vetëm në bazë të Nenit 5 (5) do të jetë përjashtues në mungesë të një vendimi paraprak ku është konstatuar mospërputhje me Nenin 5 në nivel kombëtar ose të Konventës. Shpesh Gjykata do të konsiderojë një pretendim sipas Nenit 5 (5) vetëm nëse konstaton se është shkelur<sup>172</sup> një tjetër paragraf i Nenit 5. Gjithashtu, Gjykata nuk do të kërkojë viktimës të ezaurojë të gjitha instancat gjyqësore vendase me qëllim që të zbulojë nëse ai mund të dëmshpërblehet nga autoritetet vendase. Gjithsesi, nëse një shtet tregon “me një shkallë të mjaftueshme sigurie” se është i disponueshëm një dëmshpërblim i tipit të kërkuar nga Neni 5 (5) për viktimën, Gjykata nuk do të konstatojë shkelje të kësaj dispozite<sup>173</sup>. Në *Rehbock kundër Sllovenisë*, ku ligji vendas rezervonte të drejtën për kompensim në çështjet ku heqja e lirisë ishte e paligjshme ose rezultonte nga një gabim i bërë, Gjykata konstatoi shkelje të

171. Wassink kundër Vendeve të Ulta.

172. Ciulla kundër Italisë.

173. Idem.

Nenit 5 (5) pasi e drejta e kërkuesit për kompesim që rrjedh nga shkelja e Nenit 5 (4) – e drejta e të ndaluarit për të ngritur pretendimet për të kundërshtuar ligjshmërinë e një ndalimi para një gjykate – që duhet të vendoset me shpejtësi e të urdhërohet lirimi nëse ndalimi konstatohet i paligjshëm – nuk u siguroa me një shkallë të mjaftueshme sigurie<sup>174</sup>.

Në shtetet ku Konventa është inkorporuar në ligjin vendas, gjykatave duhet t'u jepet e drejta për të siguruar një kompensim të tillë kur konstatohet një shkelje e Nenit 5 dhe ato duhet të jenë të përgatitur për të ushtruar kompetencën e tyre; çdo dështim nga ana e tyre vetëm do të rëndojë më tepër shkeljen e Nenit 5.

174. 28 Nëntor 2000.